



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

BULETINI ZYRTAR

NR.6, 2010

TIRANË 2011



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS**

BULETINI ZYRTAR

NR.6, 2010

TIRANË, 2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Përgatitur nga:

Autoriteti i Konkurrencës

Përpunimi grafik dhe printimi:

Erald Lamja

(Vignette Marketing Agency)

Botuar nga:

Autoriteti i Konkurrencës, 2011

Përmbajtja

- Fq.7 Vendimi Nr. 136, Datë 14.01.2010, Për përcaktimin e hapave të hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja
- Fq.9 Vendimi Nr. 137, Datë 05.02.2010, Për miratimin e udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”
- Fq.42 Vendimi Nr. 138, Datë 17.02.2010, Për “Miratimi i Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009 dhe synimet kryesore për vitin 2010”
- Fq.43 Vendimi Nr. 139, Datë 24.02.2010, Mbi Autorizimin e përqendrimit për përfitim të plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së 100% aseteve të shoqërisë target Sara Lee Air Care.
- Fq.46 Vendimi Nr. 139/1, Datë 01.04.2010, “Për disa korrigjime e saktësime në Vendimin Nr. 139 datë 24.02.2010”
- Fq.48 Vendimi Nr. 140, Datë 10.03.2010, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”
- Fq.53 Vendimi Nr. 141, Datë 18.03.2010, “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” për revokimin e Vendimit Nr 140, datë 10.03.2010 të Komisionit të Konkurrencës”
- Fq.55 Vendimi Nr. 142, Datë 15.03.2010, “Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj “Raiffeisen Bank” Sh.a për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit dhe përcaktimi i kushteve dhe detyrimeve për “Raiffeisen Bank” Sh.a”
- Fq.62 Vendimi Nr. 143, Datë 15.03.2010, “Mbi disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”
- Fq.68 Vendimi Nr. 144, Datë 23.03.2010, Rekomandim për Entin Rregullator të Energjisë për liçencimin e dy shoqërive Cable Sistem” Sh.p.k dhe 400 KV” Sh.p.k.
- Fq.70 Vendimi Nr. 145, Datë 15.04.2010, Për miratimin e Udhezimit “Per vleresimin e Marreveshjeve Vertikale”
- Fq.71 Vendimi Nr. 146, Datë 17.06.2010, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës”

- Fq.77 Vendimi Nr. 147, Datë 23.06.2010, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”
- Fq.84 Vendimi Nr. 148, Datë 24.06.2010, “Për përcaktimi i hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm të naftës.”
- Fq.86 Vendimi Nr. 149, Datë 24.06.2010, “Për kërkim të dhënash nga Shoqëria “ARMO” SHA”
- Fq.88 Vendimi Nr. 150, Datë 20.07.2010, “Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “ARMO” SHA në tregun e prodhimit të produktit lëndë djegëse diesel D2”
- Fq.99 Vendimi Nr. 151, Datë 21.07.2010, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve mbi shoqërinë CapRock Holdings, Inc. nga shoqëria Harris Corporation”.
- Fq.103 Vendimi Nr. 152, Datë 21.07.2010, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit - blerjes së 50% të Kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k, nga VERBUND International GbmH tek EVN AG”
- Fq.107 Vendimi Nr. 153, Datë 21.07.2010, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve mbi shoqërinë Astra Albania Sh.a nga shoqëria Eagle Investment Sh.a”.
- Fq.111 Vendimi Nr. 154, Datë 01.10.2010, “Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.pk, “Noti” sh.p.k dhe “Ultra Motors” sh.p.k. dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”
- Fq.130 Vendimi Nr. 155, Datë 28.10.2010, “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”
- Fq.132 Vendimi Nr. 156, Datë 28.10.2010, “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”
- Fq.134 Vendimi Nr. 157, Datë 28.10.2010, “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”
- Fq.136 Vendimi Nr. 158, Datë 12.11.2010, “Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve në oferta në Prokurimet Publike”
- Fq.139 Vendimi Nr. 159, Datë 19.11.2010, “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike”
- Fq.145 Vendimi Nr. 160, Datë 23.11.2010, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Interalbanian Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG”

- Fq.151 Vendimi Nr. 161, Datë 02.12.2010, “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë “3G””
- Fq.156 Vendimi Nr. 162, Datë 14.12.2010, “Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA” për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare”
- Fq.167 Vendimi Nr. 163, Datë 14.12.2010, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë ‘Premium’ ndaj Digitalb sh.a ”
- Fq.171 Vendimi Nr. 164, Datë 14.12.2010, Për një ndryshim në Rregulloren “Për Marrëveshjet me Rëndësi të Vogël”
- Fq.173 Vendimi Nr. 165, Datë 14.12.2010, Për disa ndryshime në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”
- Fq.176 Vendimi Nr. 166, Datë 21.12.2010, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aktivitetit të shoqërisë Global Connectivity Services nga shoqëria Harris Corporation”.
- Fq.180 Vendimi Nr. 167, Datë 21.12.2010, Për një ndryshim në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.181 Vendimi Nr. 168, Datë 21.12.2010, Për një ndryshim në rregulloren “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 136, Datë 14.01.2010

Për përcaktimin e hapave të hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përcaktimi i hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të Vendimit Nr. 135 datë 21.12.2009, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”:

VENDOSI:

- I. Përcaktimin e fazave të kryerjes së hetimit të thelluar si vijon:
 - a) Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - b) Inspektime në ndërmarrjen nën hetim, nëse del e nevojshme gjatë hetimit;
 - c) Përpunimi dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
 - ç) Hartimi i raportit përfundimtar të hetimit të thelluar
- II. Afati i fundit për kryerjen e këtij hetimi është data 28.02.2010.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 137, Datë 05.02.2010

PËR
MIRATIMIN E UDHËZIMIT
“PËR VLERËSIMIN E MARRËVESHJEVE HORIZONTALE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.02.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Udhëzimit “Për Vlerësimin e marrëveshjeve horizontale” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, neni 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt Udhëzimit ”Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”:

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

Udhëzim

“Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”¹

I. Objekti

1. Udhëzimi paraqet parimet për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit horizontal. Marrëveshja e bashkëpunimit ka “natyre horizontale”, nëse një marrëveshje ose praktikë e bashkërenduar është përfunduar ndërmjet ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtat nivele në treg. Në shumicën e rasteve bashkëpunimi horizontal i referohet bashkëpunimit midis konkurruesve. Ai mbulon apo përfshin aspekte të tilla si kërkime dhe zhvillime, prodhimin, blerjen apo tregtimin.
2. Bashkëpunimi horizontal mund të shkaktojë efekte negative për konkurrencën. Këto probleme kjoohen kur palët në një bashkëpunim pranojnë të fiksojnë çmimet ose prodhimin, të ndajnë tregjet ose kur bashkëpunimi mundëson palët që të mbajnë, të ruajnë ose të rrisin fuqinë në treg, duke shkaktuar kështu efekte negative në treg lidhur me çmimet, prodhimin, novacionet², ose llojshmërinë dhe cilësinë e prodhimit.
3. Por nga ana tjetër, bashkëpunimi horizontal mund të çojë në përfitime ekonomike të ndjeshme. Ndërmarrjet kërkojnë t’i përgjigjen rritjes së presionit konkurrues dhe një tregu të ndryshueshëm drejt globalizimit, shpejtësisë së progresit teknologjik dhe në përgjithësi natyrës së tregjeve më dinamike. Bashkëpunimi mund të jetë një mjet për të ndarë riskun, për të ruajtur kostot, për të bashkuar njohuritë dhe për të hedhur në treg shumë më shpejt novacionet. Në veçanti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, bashkëpunimi është një mjet i rëndësishëm për tju përshtatur ndryshimeve në treg.
4. Qëllimi i këtij udhëzimi është sigurimi i një kuadri analitik për shumicën e llojeve të zakonshme të bashkëpunimit horizontal. Kriteri ekonomik i tillë si fuqia e tregut të palëve dhe faktorë të tjerë që lidhen me strukturën e tregut, formojnë një element kyç për vlerësimin e ndikimit të mundshëm të tregut të shkaktuar nga një marrëveshje bashkëpunimi dhe si rrjedhim për vlerësim në bazë të ligjit.

II. Klasifikimi i marrëveshjeve

1. Ky udhëzim mbulon marrëveshjet ose praktikatat e bashkërenduara (këtu e më poshtë “marrëveshje”) të lidhura ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që veprojnë në të njëjtin nivel (e) të tregut për shembull, në të njëjtin nivel prodhimi ose shpërndarje, duke përcaktuar dhe kriteret për vlerësimin e marrëveshjeve të Kërkim & Zhvillimit, prodhimit, blerjes, tregtimit, standardizimit dhe marrëveshje mjedisore.
2. Marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në nivele të ndryshme të zinxhirit të prodhimit apo shpërndarjes, që quhen marrëveshje vertikale, në parim përjashtohen nga ky udhëzim.
3. Marrëveshjet mund të vlerësohen në faza të ndryshme të zbatimit të tyre p.sh marrëveshjet e K&Zh dhe të rezultateve të tyre. Në këtë përcaktim mbahen parasysh dy faktorë:

¹ 32001 Y 0106 (01); Njoftimi i Komisionit; Udhëzues mbi zbatimin e nenit 81 të Traktatit të KE për marrëveshjet e bashkëpunimit horizontal”, (OJ C3, 6.1.2001; P. 2 – 30)

² Inovacionet (Shpikjet)

- a) Së pari, pika fillestare e bashkëpunimit dhe
- b) Së dyti, shkalla e integritit të funksioneve të ndryshme.

Një marrëveshje bashkëpunimi, që përfshin si marrëveshjet e K&Zh, ashtu edhe të prodhimit të përbashkët të rezultateve, do të trajtohet në seksionin mbi “Marrëveshjet e Kërkimit dhe Zhvillimit”, pasi prodhimi i përbashkët, realizohet vetëm atëherë kur marrëveshja K&Zh e përbashkët është e suksesshme. Kjo nënkupton që rezultatet e marrëveshjeve të K&Zh të përbashkët janë vendimtare për prodhimin. Marrëveshjet e K&Zh mund të shihen në këtë mënyrë si pika e fillimit të bashkëpunimit. Ky vlerësim do të ndryshonte nëse marrëveshja parashikonte një integrim të plotë në fushën e prodhimit dhe një integrim të pjesshëm të disa veprimtarive të K&Zh. Në këtë rast, efektet e mundshme anti konkurruese dhe përfitimet ekonomike të bashkëpunimit do të lidhen në masë të madhe me prodhimin e përbashkët dhe prandaj marrëveshja duhet të shqyrtohet në përputhje me parimet e vendosura në seksionin “Marrëveshjet e Prodhimit”.

4. Neni 4 i Ligjit nuk zbatohet për marrëveshjet, të cilat kanë një rëndësi të vogël (Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”, miratuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 121, datë 10.09.2009), pasi nuk janë të afta të kufizojnë ndjeshëm konkurrencën nga shkakut ose pasoja. Prandaj ky udhëzues nuk paragjykon aplikimin aktual apo të ardhshëm të Rregullores “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”.

III. Parimet bazë për vlerësim

1. Neni 4 i Ligjit zbatohet për marrëveshjet e bashkëpunimit horizontal, të cilat kanë si objekt apo pasojë, pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës. Këto marrëveshje janë të ndaluara në vetvete (perse). Ky është rasti i marrëveshjeve që caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e blerjes apo shitjes, kufizimin e prodhimit apo ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit. Këto marrëveshje prezumohen që të kenë efekte negative në treg, prandaj nuk është e nevojshme që të studiohen efektet e tyre aktuale në konkurrencë ose në treg me qëllim që të vërtetohet që ato janë në kundërshtim me nenin 4/1 të Ligjit.
2. Sidoqoftë, shumë marrëveshje bashkëpunimi horizontal nuk kanë si objekt të tyre kufizimin e konkurrencës. Megjithatë, është e nevojshme një analizë e efekteve të këtyre marrëveshjeve. Për realizimin e kësaj analize nuk është i mjaftueshëm fakti që marrëveshja kufizon konkurrencën midis palëve. Ajo duhet gjithashtu të ndikojë konkurrencën në treg në një shkallë të tillë që të priten efektet negative në treg mbi çmimet, prodhimin, novacionin apo shumëllojshmërinë ose cilësinë e produkteve dhe shërbimeve. Në këtë rast analizohet marrëveshje e cila mund të ndikojë mbi konkurrencën në treg, në një masë të tillë që mund të priten efekte negative të tregut si në çmimet, produktet, novacionet ose llojshmërinë, apo cilësinë e mallrave dhe shërbimeve.
3. Efektet negative të shkaktuara nga një marrëveshje analizohen duke pasur parasysh:
 - natyrën e marrëveshjes,
 - fuqinë e kombinuar të palëve në treg, e cila përcakton (së bashku me faktorët e tjerë strukturorë) aftësinë e bashkëpunimit për të ndikuar në një masë të rëndësishme konkurrencën në treg.

III.1. Natyra e marrëveshjes

1. Natyra e një marrëveshjeje lidhet me faktorë të tillë, si fusha dhe objekti i bashkëpunimit, marrëdhënia konkurruese ndërmjet palëve dhe masa në të cilën ato kombinojnë aktivitetet e tyre. Këto faktorë përcaktojnë mundësinë që palët të koordinojnë sjelljen e tyre në treg.
2. Disa forma të marrëveshjeve të bashkëpunimit, kryesisht ato të marrëveshjeve K&ZH, ose të bashkëpunimit për të vendosur standarde ose për përmirësimin e kushteve mjedisore, kanë më pak mundësi të shkaktojnë kufizime mbi çmimet dhe produktin. Nëse këto lloj marrëveshjesh shkaktojnë efekte negative, këto të fundit lidhen me novacionin ose llojshmërinë e produkteve.
3. Forma të tjera të bashkëpunimit, të tilla si marrëveshjet mbi prodhimin ose mbi blerjet, shkaktojnë një lloj shkalle njëtrajtshmërie në kostot (totale). Në qoftë se kjo shkallë është domethënëse, palët mund të koordinojnë më lehtësisht çmimet e tregut dhe prodhimin. Një shkallë domethënëse e njëtrajtshmërisë në kostot mund të arrihet vetëm duke plotësuar disa kushte:
 - a) Së pari, fusha e bashkëpunimit, p.sh prodhimi dhe blerja, duhen llogaritur për një pjesë të madhe të kostove totale në një treg të dhënë.
 - b) Së dyti, palët duhet të kombinojnë aktivitetet e tyre në fushën e bashkëpunimit në një masë domethënëse. Për shembull, ky rast është kur ato bashkërisht prodhojnë ose blejnë një produkt të ndërmjetëm, të rëndësishëm, ose një pjesë të madhe të prodhimit total të tyre për një produkt përfundimtar.

III.2. Marrëveshjet që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Ligjit

1. Disa kategori marrëveshjesh, për shkak të natyrës së tyre të veçantë, nuk përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit. Normalisht, kjo është e vërtetë për bashkëpunimet që nuk përfshijnë një koordinim të sjelljes së palëve konkurruese në treg të tilla si:
 - a) Marrëveshjet e bashkëpunimit midis jo konkurrentëve;
 - b) Marrëveshjet e bashkëpunimit midis ndërmarrjeve konkurruese që nuk mund të kryejnë në mënyrë të pavarur projektin ose veprimtarinë që mbulohet nga bashkëpunimi,
 - c) Marrëveshjet e bashkëpunimit që lidhet me një veprimtari, e cila nuk ndikon në parametrat e përkatës të konkurrencës.

Këto kategori të bashkëpunimit mund të mbulohen nga neni 4 i Ligjit vetëm në qoftë se ato përfshijnë ndërmarrje me fuqi të ndjeshme tregu dhe ka mundësi të shkaktojnë probleme përjashtimi të dukshme ndaj palëve të treta.

III.3. Marrëveshjet që pothuajse gjithmonë përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit.

1. Marrëveshjet e bashkëpunimit, që kanë si objekt apo si pasojë kufizimin e konkurrencës nëpërmjet fiksimit të çmimit, kufizimit të prodhimit ose ndarjes së tregjeve ose klientëve janë marrëveshje të ndaluara dhe vlerësohen bazuar në nenin 4 të Ligjit.

2. Marrëveshjet të cilat nuk i përkasin formës së sipërpërmendur kërkojnë analizim të mëtejshëm, bazuar në kriteret e mëposhtëm:

Këto kufizime konsiderohen që janë shumë të dëmshme sepse ato ndërhyjnë drejtpërdrejt në rezultatin e procesit konkurrues. Fiksimi i çmimit dhe kufizimi i prodhimit në mënyrë të drejtpërdrejtë bën që konsumatorët të paguajnë çmime më të larta ose të mos përfitojnë sasisë që ata dëshirojnë.

Ndarja e tregjeve ose e konsumatorëve ul mundësinë e zgjedhjes konsumatore dhe përsëri të çon në çmime më të larta ose prodhim më të ulët. Për këtë arsye prezumohet që kufizime të tilla sjellin efekte negative në treg dhe për këtë arsye në shumicën e rasteve ato janë të ndaluara.

III.4. Fuqia e tregut dhe struktura e tregut

1. Pikënisja për analizën është vlerësimi i fuqisë së palëve në tregjet e prekura nga bashkëpunimi. Kjo përcakton nëse palët n.p.m bashkëpunimit do të kenë ose jo mundësi të ruajnë, të krijojnë ose të forcojnë fuqinë e tyre në treg, që do të thotë aftësia për të shkaktuar efekte negative në treg si të çmimet, prodhimi, novacionet, ose shumëllojshmëria, ose të cilësia e mallrave dhe shërbimeve.
2. Në qoftë se pjesa e kombinuar e palëve është e vogël, efekti kufizues që rrjedh nga ky bashkëpunim është i pallogaritshëm ndaj konkurrencës në tregun përkatës dhe për rrjedhojë nuk kërkohet asnjë analizë e mëtejshme. Duke u nisur nga shumëllojshmëria e formave të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe efekteve të ndryshme që ato mund të shkaktojnë në situata të ndryshme të tregut, është e pamundur të japësh një prag të përgjithshëm xhiroje të pjesës së tregut, mbi të cilit mund të supozohet, një fuqi tregu e mjaftueshme, e cila shkakton efekte kufizuese.
3. Përveç pozicionit të palëve në treg dhe të pjesëve të tregut që ato zënë, mund të merret parasysh edhe përqendrimi i tregut, d.m.th pozicioni dhe numri i konkurrentëve si një faktor shtesë për të vlerësuar ndikimin e bashkëpunimit në konkurrencën në treg. Si një tregues mund të përdoret Indeksi Herfindah-Hirshman ("HHI"), i cili përmbledh katrorët e pjesëve individuale të tregut të të gjithë konkurrentëve: Me një HHI poshtë 1000, përqendrimi i tregut mund të karakterizohet si i ulët, një HHI midis 1000 dhe 1800, si mesatar dhe një HHI mbi 1800 si i lartë. Një treg i përbërë nga 4 firma me pjesë tregu nga 30%,25%,25% dhe 20% ka një HHI prej 2550 (900+625+625+400) para kooperimit. Nëqoftëse dy udhëheqësit e parë të tregut kooperojnë, HHI do të ndryshojë në 4050 (3025+625+400) mbas bashkëpunimit. HHI pas bashkëpunimit është e përshtatshme për vlerësimin e efekteve të mundshme të tregut të një bashkëpunimi. Një tregues tjetër i mundshëm, do të ishte raporti i përqendrimit të ndërmarrjes drejtuese, që gjendet duke mbledhur pjesët individuale të tregut të konkurrentëve kryesorë.
4. Në varësi të pozicionit në treg të palëve dhe përqendrimit të tregut, duhet të merren në konsideratë gjithashtu faktorë të tjerë, të tillë si, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut, barrierat e hyrjes dhe mundësia e hyrjes në treg, fuqia kundërvepruese e blerësve/ofruesve ose natyra e produkteve (p.sh homogjeniteti, pjekuria).

Marrëveshjet që përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit mund të përjashtohen, nëse kushtet e nenit 5 të Ligjit janë plotësuar. Ky rast është në qoftë se marrëveshja:

- kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose në shpërndarjen e produkteve, ose në nxitjen e progresit teknik ose ekonomik;
- I lejon konsumatorëve një ndarje të drejtë të përfitimeve që rezultojnë;

Dhe:

- Nuk vendos kufizime të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e objektivave të sipërpërmendura;
- Nuk i jep mundësi eliminimit të konkurrencës për një pjesë të rëndësishme të produktit në fjalë.

III.5. Përfitimet ekonomike

1. Kushti i parë kërkon që marrëveshja të kontribuojë në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjes së produkteve, nxitjen e progresit teknik apo ekonomik, efekte pozitive këto që lidhen me eficaenca statike ose dinamike, por nuk mund të konsiderohen si “përfitime ekonomike”. Përfitimet ekonomike mund të jenë më të rëndësishme se efektet kufizuese në konkurrencë. Për shembull, një bashkëpunim i mundëson ndërmarrjet për të ofruar produkte me çmime më të ulta, me cilësi më të mirë ose për të hedhur më shpejt në treg një risi. Palët në marrëveshje duhet të provojnë që eficaencat pozitive që burojnë nga kombinimi dhe integrimi i kapaciteteve apo burimeve të ndryshme si pasojë e bashkëpunimit janë thelbësore dhe nuk mund të arrihen nëpërmjet mënyrave të tjera më pak kufizuese. Deklaratat e përgjithshme mbi uljet e kostos janë të pamjaftueshme.
2. Autoriteti nuk merr parasysh uljet e kostos që rezultojnë nga ulja e prodhimit, ndarja e tregut ose thjeshtë nga ushtrimi i fuqisë së tregut.

III.6. Përfitimi i drejtë për konsumatorët

Përfitimet ekonomike duhet të favorizojnë jo vetëm palët në marrëveshje, por gjithashtu edhe konsumatorët. Në përgjithësi transmetimi i përfitimeve tek konsumatorët varet nga intensiteti i konkurrencës brenda tregut përkatës. Presionet konkurruese sjellin ulje të kostos, që pasohen në çmime më të ulta ose nxisin ndërmarrjet për të hedhur në treg produkte të reja në një kohë sa më të shpejtë. Prandaj, në qoftë se është ruajtur në treg konkurrenca e mjaftueshme, e cila kufizon palët në marrëveshje, procesi konkurrues normalisht do të sigurojë që konsumatorët të marrin një pjesë të drejtë të përfitimeve ekonomike.

III.7. Domosdoshmëria

Kufizimi i konkurrencës duhet të jetë i nevojshëm për arritjen e përfitimeve ekonomike. Në qoftë se ekzistojnë më pak kufizime për të arritur përfitime të ngjashme, eficaenca e pretenduar nuk mund të përdoret për të justifikuar kufizimet në konkurrencë. Nëse janë apo jo kufizimet individuale të nevojshme, kjo varet nga rrethanat e tregut dhe nga kohëzgjatja e marrëveshjes.

III.8. Nuk ka eliminim të konkurrencës

Kriteri i fundit i eliminimit të konkurrencës për një pjesë domethënëse të produkteve në fjalë është i lidhur me çështjen e pozitës dominuese. Nëse një ndërmarrje ka pozitë dominuese apo ka prirje për të pasur pozitë dominuese si pasojë e një marrëveshjeje horizontale, një marrëveshje që sjell efekte anti konkurruese sipas kuptimit të nenit 4 të Ligjit, në parim, nuk mund të përjashtohet.

2. MARRËVESHJET PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM

Përkufizim

1. Marrëveshjet K&Zh ndryshojnë nga forma dhe qëllimi. Ato përfshijnë:
 - kërkimin dhe zhvillimin duke filluar nga furnizimi i jashtëm i disa veprimtarive deri tek përmirësimi i përbashkët i teknologjisë ekzistuese; ose
 - bashkëpunimin që lidhet me kërkimin, zhvillimin dhe marketingun e produkteve tërësisht të rinj.

Ato mund të marrin formën e një marrëveshjeje bashkëpunimi ose të një ndërmarrje të kontrolluar bashkërisht. Ky përkufizim zbatohet tek të gjitha format e marrëveshjeve K&Zh, duke përfshirë marrëveshjet e lidhura që kanë të bëjnë me prodhimin ose tregtimin e rezultateve të siguruara nga K&Zh, me përjashtim të përqendrimeve që mbulohen nga Rregullorja e Përqendrimeve.

2. Bashkëpunimi në K&Zh mund të zvogëlojë kostot e dyfishta të panevojshme, dhe sjell rezultate në produkte dhe teknologji që zhvillohen më shpejt se sa në rast të kundërt. Si një rregull i përgjithshëm, bashkëpunimi K&Zh priret të rrisë veprimtaritë e përgjithshme të K&Zh.
3. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) formojnë një bashkësi dinamike dhe heterogjene, e cila është përballur me kërkesat në rritje të ndërmarrjeve më të mëdha, për të cilat ato shpesh punojnë si nën-kontraktorë. Për të qenë konkurrese, NVM-të kanë nevojë të përtërihen vazhdimisht dhe kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në marrëveshjet e K&Zh.
4. Megjithatë, në rrethana të caktuara, marrëveshjet K&Zh mund të shkaktojnë probleme konkurrence të tilla, si efektet kufizuese mbi çmimet, prodhimin, novacionin, shumëllojshmërinë ose cilësinë e produkteve. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson të tilla efekte për lejimin apo ndalimin e marrëveshjes.

Tregu përkatës

1. Përcaktimi i tregut përkatës në një marrëveshjeje K&Zh, është identifikimi i atyre produkteve, teknologjive ose përpjekjeve për K&Zh që do të veprojnë si kufizim konkurrenues mbi palët. Nga njëra anë, novacionet mund të çojnë në një produkt (ose teknologji), i cili konkurren në një treg ekzistues produkti (ose teknologjie). Ky është rasti kur një marrëveshje K&Zh sjell përmirësime të vogla ose llojshmëri, si p.sh. modele të reja të disa produkteve. Në këtë rast efektet e mundshme kanë të bëjnë me tregun për produktet ekzistuese. Në anën tjetër, novacioni mund të çojë në një produkt tërësisht të ri, i cili krijon tregun e tij të ri (p.sh. një vaksine të re për një sëmundje të mëparshme të pashërueshme). Në një rast të tillë, tregu përkatës konsiderohet ai ekzistues. Kjo ndodh në rastet kur përpjekjet e novacionit mund të krijojnë produkte (ose teknologji), të cilat me kalimin e kohës zëvendësojnë ato ekzistuese (p.sh CD-të të cilat kanë zëvendësuar kasetat).

(a) Tregu i produktit

1. Kur bashkëpunimi i përket K&Zh për përmirësimin e produkteve ekzistuese, këto

produkte ekzistuese duke përfshirë edhe zëvendësuesit e tyre të afërt, formojnë tregun përkatës që i përket bashkëpunimit.

2. Në qoftë se përpjekjet K&Zh synojnë në një ndryshim domethënës të një produkti ekzistues, ose edhe në një produkt të ri duke zëvendësuar atë ekzistues, zëvendësimi me produktet ekzistuese mund të jetë jo i plotë ose afatgjatë. Si pasojë, produktet ekzistuese dhe shfaqja e produkteve të reja, nuk ka mundësi t'i përkasin të njëjtit treg përkatës.
3. Në rast se K&Zh lidhet me një përbërës të rëndësishëm të një produkti përfundimtar, për vlerësim, duhet marrë në konsideratë jo vetëm tregu përkatës i këtij përbërësi, por edhe tregu ekzistues për produktin përfundimtar. (Për shembull, nëse prodhuesit e makinave bashkëpunojnë në K&Zh, që lidhet me një lloj të ri motori, tregu i prodhimit të makinave mund të ndikohet nga ky bashkëpunim K&Zh). Megjithatë, në qoftë se përbërësi për të cilin K&Zh ka synuar, është teknikisht apo ekonomikisht një element i rëndësishëm i produkteve përfundimtare dhe në qoftë se palët në marrëveshjen e K&Zh janë konkurrentë të rëndësishëm në lidhje me produktet përfundimtare, tregu përkatës është ai i produkteve përfundimtare.

(b) Tregu i teknologjisë

1. Bashkëpunimi në K&Zh mund të mos lidhet vetëm me produktet por edhe me teknologjinë. Kur të drejtat për pronësinë intelektuale janë tregtuar veçmas produktit me të cilin shoqërohen, duhet të përcaktohet edhe tregu përkatës i teknologjisë. Tregu i teknologjisë përfshin pronësinë intelektuale që është licencuar dhe zëvendësues të afërt të tyre, domethënë teknologji të tjera që klientët mund t'i përdorin si zëvendësues.
2. Në përcaktimin e tregut të teknologjisë, një rëndësi e veçantë i duhet vënë konkurrencës potenciale. Kjo ndodh kur ndërmarrjet nuk licencojnë teknologjitë e tyre dhe janë hyrës potencialë në tregun e teknologjisë, ato mund të ushtrojnë presion mbi palët për të rritur çmimin për teknologjitë e tyre (shiko shembullin 3 tek Aneksi 1).

(c) Konkurrenca për novacionin (përpjekjet e K & ZH)

1. Marrëveshjet e bashkëpunimit për K&Zh mund të mos ndikojnë në konkurrencën në tregun ekzistues, por as në konkurrencën në tregjet në novacion. Është rasti kur bashkëpunimi i përket zhvillimit të produkteve/teknologjisë së re, e cila pritet të zëvendësojë produktet / teknologjinë ekzistuese; ose synon një përdorim të ri, i cili nuk do të zëvendësojë produktet ekzistuese, por do të sjellë një kërkesë të re. Në këto situata, efektet në konkurrencë për novacionin janë të rëndësishme, por në disa raste mund të vlerësohen si të pamjaftueshme në analizimin e konkurrencës aktuale ose potenciale në tregun ekzistues të produkteve / teknologjive.

(d) Llogaritja e pjesëve të tregut

1. Llogaritja e pjesëve të tregut duhet të pasqyrojë ndryshimet në konkurrencë ndërmjet tregut të produkteve ekzistues dhe tregut të produkteve në novacione. Në fillim të bashkëpunimit pika referuese është tregu i produkteve të mundshme për përmirësim

ose zëvendësim nga produktet në zhvillim. Në qoftë se marrëveshja e K&Zh synon vetëm në përmirësimin ose përpunimin e produkteve ekzistuese, ky treg përfshin produktet e lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga marrëveshja e K&Zh. Kështu, pjesët e tregut mund të llogariten mbi bazën e vlerës së shitjes së produkteve ekzistuese. Në qoftë se K&Zh synon në zëvendësimin e një produkti ekzistues dhe nëse do të jetë i suksesshëm, produkti i ri do të bëhet zëvendësues i produkteve ekzistuese.

2. Në qoftë se marrëveshja e K&Zh synon në zhvillimin e një produkti, i cili krijon një kërkesë tërësisht të re, atëherë vlerësimi nuk mund të bazohet në pjesët e tregut të bazuara mbi shitjet. Në këtë rast është e nevojshme të kryhen analiza të tjera që lidhen me efektet mbi konkurrencën, në varësi të periudhës kohore, afatmesme (3vjet) apo afatgjata (7 vjet) si pasojë e novacionit. Për pasojë, këto marrëveshje përjashtohen për një periudhë të caktuar kohore, pas hedhjes së produktit për herë të parë në treg, pavarësisht nga pjesa e tregut. Pas periudhës kohore të caktuar, pjesët e tregut mund të llogariten bazuar në vlerën e shitjeve dhe të zbatohet pragu i pjesës së tregut prej 25%.

Natyra e marrëveshjes

Marrëveshjet që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit

1. Bashkëpunimi K&Zh ndërmjet jo konkurrentëve në përgjithësi nuk kufizon konkurrencën. Marrëdhënia konkurruese ndërmjet palëve do të analizohet në kontekstin e ndikimit në tregjet ekzistuese dhe/ose novacionin. Në qoftë se palët nuk kanë mundësi të kryejnë në mënyrë të pavarur kërkesat e K&Zh, nuk ka kufizim të konkurrencës. P.sh, kjo zbatohet për të gjitha ndërmarrjet që bashkërisht sjellin për plotësim njohuri, teknologji dhe burime të tjera. Çështja e konkurrencës potenciale do të vlerësohet mbi baza reale. Palët nuk mund të përcaktohen si konkurrentë potencialë, thjesht sepse bashkëpunimi i mundëson ata të kryejnë veprimtaritë e K&Zh. Çështja vendimtare është nëse secila palë në mënyrë të pavarur ka mjetet e nevojshme për të vlerësuar njohuritë praktike (knoë-hoë) dhe burimet e tjera.
2. Bashkëpunimi K&Zh me anën e nënkontraktorëve ekskluziv të mëparshëm të K&Zh, shpesh është kryer nga ndërmarrje të specializuara, institute kërkimi ose organizma akademike, të cilat nuk janë aktive në shfrytëzimin e rezultateve. Kryesisht, marrëveshje të tilla janë të kombinuara me një transferim të njohurive praktike dhe/ose një klauzole oferte ekskluzive që i përket rezultateve të mundshme. Për shkak të natyrës plotësuese të palëve bashkëpunuese në këto skenarë, neni 4 i Ligjit nuk zbatohet.
3. Bashkëpunimi K&Zh, që nuk përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të mundshme me anë të licencimit, prodhimit dhe/ose marketingut, rrallë përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit. Këto marrëveshje “të pastra” K&Zh mund të shkaktojnë vetëm një problem konkurrence, në qoftë se konkurrenca efektive në lidhje me novacionin është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme.

Marrëveshjet që përfshihen brenda fushës së zbatimit të nenit 4 të Ligjit

1. Në qoftë se objekti i vërtetë i një marrëveshjeje nuk është K&Zh, por krijimi i një marrëveshjeje të fshehtë, që do të thotë ndryshe fiksimi i ndaluar i çmimit, kufizimin e prodhimit, ose ndarjen e tregjeve, ai përfshihet gjithmonë brenda fushës së zbatimit të nenit 4 të Ligjit.

Fuqia e tregut dhe struktura e tregut

1. Marrëveshjet e bashkëpunimit të K&Zh mund të shkaktojnë 3 efekte negative në treg:
 - Së pari, mund të kufizojë novacionin,
 - Së dyti mund të shkaktojë koordinimin e sjelljeve të palëve në tregjet ekzistuese dhe
 - Së treti, problemet e përjashtimit mund të ndodhin në nivelin e shfrytëzimit të rezultateve të mundshme.

Megjithatë, këto lloje efektesh negative të tregut, ka mundësi të shfaqen kur palët në një bashkëpunim kanë fuqi domethënëse në tregjet ekzistuese dhe/ose konkurrenca në lidhje me novacionin është zvogëluar ndjeshëm.

2. Nuk ka prag absolut të pjesës së tregut që tregon që një marrëveshje K&Zh krijon një shkallë të fuqisë së tregut dhe si e tillë përfshihet brenda fushës së veprimit të nenit 4 të Ligjit. Megjithatë, marrëveshjet e K&Zh që janë përfunduar midis palëve me një pjesë tregu të kombinuar, që nuk i kalon 25% dhe që kushtet e tjera janë përmbushur, janë të sigurta për përjashtim.
3. Në qoftë se K&Zh është drejtuar në përmirësimin ose përpunimin e produkteve/teknologjisë ekzistuese, efektet e mundshme për këto produkte/teknologji i përkasin tregut përkatës. Sidoqoftë, efektet e mundshme mbi çmimet, prodhimin dhe/ose novacionet në tregjet ekzistuese ndodhin vetëm nëse palët së bashku kanë një pozicion të fortë, hyrja është e vështirë dhe pak veprimtari të tjera novatore janë të përcaktueshme. Për më tepër, në qoftë se K&Zh në mënyrë të pandryshueshme përbën vetëm një input relativisht të vogël të një produkti përfundimtar, efektet mbi konkurrencën në produktet përfundimtare janë shumë të kufizuara.
 - Së pari, efektet negative mbi çmimet dhe prodhimin në tregjet ekzistuese janë më të mundshëm, në qoftë se konkurrentët e fortë janë përfshirë në një situatë të tillë.
 - Së dyti, bashkëpunimi mund të jetë i ngushtë në një marrëveshje prodhimi, sepse veprimtaritë e K&Zh de fakto nuk janë baza për një bashkëpunim të tillë.
4. Në qoftë se K&Zh synon një produkt tërësisht të ri (ose teknologji) që krijon tregun e vet të ri, efektet mbi çmimin dhe prodhimin në tregjet ekzistuese janë edhe më të pamundshme. Në këtë rast analizohen kufizimet e mundshme të novacioneve përkatëse p.sh: cilësia dhe llojshmëria e produkteve/teknologjisë së ardhshme ose shpejtësisë së novacionit. Këto efekte kufizuese mund të lindin atëherë kur dy ose më shumë ndërmarrje ndërmarrin nismën e prodhimit të një produkti të tillë të ri dhe të fillojnë të bashkëpunojnë në fazën ku secila në mënyrë të pavarur janë shumë pranë hedhjes në treg të produktit të ri. Në një rast të tillë, novacioni mund të jetë i kufizuar madje edhe nga një marrëveshje e pastër K&Zh.
5. Shumica e marrëveshjeve të K&Zh mund të kenë efekte mbi novacionet, si dhe efekte prapavepruese në tregjet ekzistuese. Për pasojë, si tregjet ekzistuese ashtu dhe efektet mbi novacionet mund të jenë të përshtatshme për vlerësim lidhur me pozicionin e kombinuar të palëve, raportin e përqendrimit, numrin e lojtarëve/novatorëve dhe kushtet e hyrjes. Në disa raste, mund të ketë efekte kufizuese të çmimit/prodhimit në tregjet ekzistuese dhe një ndikim negativ në reduktimin e shpejtësisë së zhvillimit. Për shembull, në qoftë se konkurrentët e rëndësishëm

në një treg teknologjik ekzistues, bashkëpunojnë për zhvillimin e një teknologjie të re, e cila synon të zëvendësojë produktet ekzistuese, efektet kufizuese mund të shfaqen, vetëm nëse:

- palët kanë fuqi tregu domethënëse në tregun ekzistues , dhe
- nëse ata kanë një pozicion të fortë në këtë marrëveshje .

Kjo mund të ndodhë, nëse konkurenti kryesor në një treg ekzistues bashkëpunon me një konkurrent shumë të vogël ose/edhe potencial, i cili sapo ka filluar të hedhë në treg një produkt/teknologji të re, që mund të rrezikojë pozicionin e ekzistuesit (incumbent).

Përfitimet ekonomike

1. Pjesa më e madhe e marrëveshjeve të K&Zh, me ose pa shfrytëzim të përbashkët të rezultateve të pritshme, sjellin përfitime ekonomike lidhur me uljen e kostos dhe shkëmbimit të ideve dhe eksperiencës, duke çuar në zhvillimin më të shpejtë të produkteve dhe teknologjive të reja ose të përmirësuara. Nëse plotësohen këto kushte marrëveshja përjashtohet nga ndalimi megjithëse kufizon konkurrencën brenda pragut të pjesës së tregut, poshtë së cilit, efektet pozitive të marrëveshjes së Kërkimit dhe Zhvillimit tejkalojnë çdo efekt negativ mbi konkurrencën.
2. Palët pjesëmarrëse në një marrëveshje K&Zh pavarësisht nëse është krijuar një fuqi tregu e konsiderueshme, ose fuqia është rritur nga bashkëpunimi, duhet të provojnë përfitimet domethënëse të shkaktuara nga zbatimi i marrëveshjes (një hedhje të shpejtë në treg të produkteve/teknologjisë së re ose eficiencat e tjera).

Domosdoshmëria

1. Një marrëveshje K&Zh e cila vendos kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e përfitimeve të mësipërme nuk mund të përjashtohet nga ndalimi.

Koha e vlerësimit dhe kohëzgjatja e përjashtimit

1. Marrëveshjet e K&Zh që shtrihen në prodhimin e përbashkët dhe marketingun e një produkti/teknologjie të re, kërkojnë një vëmendje të veçantë si dhe kohë për t'u vlerësuar.
2. Analiza e vlerësimit për përjashtim të një marrëveshjeje K&Zh nuk mund të kryhet pa u zbatuar kjo marrëveshje. Kjo do të thotë që analiza kryhet vetëm nëse janë shfaqur rezultate që lidhen me pozicionin e palëve në treg, zhvillimin e tregut të produkteve dhe teknologjive të ardhshme.
3. Ndërmarrja për të kapur tregun me një produkt/teknologji të re, kërkon që në fillim pjesë tregu shumë të larta dhe suksesi e K&Zh shpesh vjen si rezultat i mbrojtjes së pronësisë intelektuale. Një pozicion i fortë i tregut për shkak të kësaj “përparësie të nismëtarit”, nuk vlerësohet si kufizim i konkurrencës. Kështu që përjashtimi mbulon marrëveshjet K&Zh për një periudhë kohore shtesë prej 7 vjetësh, (d.m.th përtej fazës së K&Zh) pa marrë parasysh nëse palët brenda kësaj periudhe fitojnë një pjesë të madhe tregu nga ky produkt/teknologji e re, e tyre.

Shëmbujt përkatës për marrëveshjet e K&Zh do t'i gjeni në Aneksin Nr. 1.

3. MARRËVESHJET E PRODHIMIT (PËRFSHIRË DHE MARRËVESHJET E SPECIALIZIMIT)

Përkufizimi

1. Marrëveshjet e prodhimit mund të ndryshojnë nga forma dhe qëllimi. Ato mund të jenë në formën e prodhimit të përbashkët, nëpërmjet një ndërmarrjeje të përbashkët çka nënkupton një ndërmarrje e kontrolluar së bashku, që menaxhon një ose disa pajisje prodhimi ose mund të realizohet, nëpërmjet marrëveshjeve të specializimit ose të nën kontraktimit, ku njëra palë pranon të kryejë prodhimin e një produkti të caktuar.
2. Në përgjithësi, dallohen tre kategori të marrëveshjeve të prodhimit:
 - Marrëveshja e prodhimit të përbashkët, ku palët pranojnë të prodhojnë së bashku produkte të caktuara (në mënyrë të njëanshme ose të ndërsjellët),
 - Marrëveshja e specializimit ku palët pranojnë të ndërpresin prodhimin e një produkti në mënyrë të njëanshme ose të ndërsjellët dhe ta blejnë atë nga pala tjetër; dhe
 - Marrëveshja e nën kontraktimit ku njëra palë (“kontraktori”) ia beson prodhimin e një produkti një pale tjetër (“nënkontraktori”).
3. Marrëveshjet e nënkontraktimit janë marrëveshje vertikale. Megjithatë ekzistojnë dy përjashtime për këtë rregull:
 - Marrëveshjet e nënkontraktimit midis konkurrentëve dhe
 - Marrëveshjet e nënkontraktimit midis jo-konkurrentëve që përfshijnë transferimin e know-how tek nënkontraktorët.

Tregu përkatës

1. Me qëllim që të vlerësohet marrëdhënia konkurruese midis palëve bashkëpunuese duhet që:

Së pari, të përcaktohet tregu përkatës i produktit dhe ai gjeografik i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me bashkëpunimin;

Së dyti, një marrëveshje prodhimi në njërin treg mund të prekë sjelljen konkurruese të palëve në një treg, i cili është në rrjedhën e poshtme, ose në rrjedhën e sipërme ose në tregun fqinjë, i lidhur ngushtësisht me tregun e prekur drejtpërdrejtë nga bashkëpunimi (I ashtuquajtur “treg me efekte të tepërta”). Megjithatë, efektet e tepërta ndodhin vetëm nëse bashkëpunimi në njërin treg ka për rrjedhojë bashkërendimin e sjelljeve konkurruese në tregun tjetër që nënkupton lidhje të tregjeve nga ndërvarësia dhe kur palët janë në një pozicion të fortë në tregun me efekte të tepërta.

Natyra e marrëveshjes

1. Problemet në konkurrencë nga marrëveshjet e prodhimit, janë bashkërendimi i sjelljeve konkurruese të palëve si ofrues. Kjo shfaqet atje ku palët bashkëpunuese, të paktën në një nga këto tregje përkatëse, janë konkurrentë aktualë ose potencialë

p.sh në tregun e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga bashkëpunimi dhe/ose në tregjet me efekte të tepërta.

2. Fakti që palët janë konkurrentë nuk sjell detyrimisht bashkërendimin e sjelljeve të tyre. Palët kërkojnë të bashkëpunojnë për sa i përket një pjese të rëndësishme të veprimtarisë së tyre, me synim që të arrijnë një shkallë domethënëse së njëtrajtshmërisë së kostove. Sa më e lartë të jetë shkalla e njëtrajtshmërisë së kostove, aq më e madhe është mundësia për kufizimin e konkurrencës së çmimit, në veçanti në rastin e produkteve homogjene.

Marrëveshjet e prodhimit që nuk përfshihen brenda objektit të nenit 4 të Ligjit.

Së pari, bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat konkurrojnë në tregjet e lidhura ngushtësisht me tregun si pasojë e bashkëpunimit, nuk mund të përcaktohet si kufizim i konkurrencës, nëqoftëse bashkëpunimi është i vetmi mjet i mundshëm dhe i justifikueshëm nga ana tregtare, për të hyrë në tregun e ri, për të hedhur në treg një produkt ose shërbim të ri ose për të arritur një projekt të caktuar;

Së dyti, efekti i sjelljes konkurruese të palëve (që janë ofrues në treg) nuk mund të jetë i madh, nëse palët së bashku kanë një raport të vogël të kostove totale të tyre. Për shembull, një shkallë e ulët e njëtrajtshmërisë në kostot totale ndodh atëherë kur dy ose më shumë ndërmarrje pranojnë të prodhojnë një produkt të specializuar/të përbashkët të ndërmjetëm, i cili përbën vetëm një pjesë të vogël të kostove të prodhimit të produktit përfundimtar dhe për pasojë të kostos totale.

Së treti, marrëveshjet nënkontraktuese midis konkurrentëve nuk përfshihen në objektin e nenit 4 të Ligjit, nëqoftëse ato kanë të bëjnë vetëm me shitjet dhe blerjet individuale në treg, pa detyrime të mëtejshme dhe që nuk janë pjesë e marrëdhënie tregtare midis palëve.

Marrëveshjet që përfshihen në objektin e nenit 4 të Ligjit

Marrëveshjet të cilat fiksojnë çmimet për ofruesit e palëve në treg, kufizojnë prodhimin, ose ndajnë tregjet, apo grupet e klientëve dhe kanë objekt kufizimin e konkurrencës, përfshihen gjithmonë në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit.

Megjithatë, kjo nuk zbatohet për rastet kur:

- Palët bashkëpunojnë për prodhimin në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh kapaciteti dhe volumi i prodhimit të një ndërmarrje të përbashkët ose produkteve të nënkontraktuara), ose
- Një ndërmarrje e përbashkët prodhuese realizon shpërndarjen e produkteve të prodhuara, përcakton çmimet e shitjes për këto produkte, duke siguruar që fiksimi i çmimit nga ndërmarrja e përbashkët është efekt i funksioneve të shumëllojshme integruese.

Fuqia e tregut dhe strukturat e tregut

1. Analiza fillon nga pozicioni i palëve në treg. Kjo lidhet së pari me faktin që palët pa fuqi tregu në një marrëveshje prodhimi, nuk kanë nxitjen për të koordinuar sjelljet konkurruese të tyre si ofrues. Së dyti, kjo nuk ka asnjë efekt mbi konkurrencën në treg, për palët që s'kanë fuqi tregu, edhe nëse ata do të donin të koordinonin sjelljet e tyre.

2. Nuk ka asnjë prag absolut të pjesës së tregut, i cili tregon që marrëveshja e prodhimit krijon një shkallë të caktuar të fuqisë të tregut. Megjithatë, do të përjashtohen marrëveshjet e specializimit që lidhen në mënyrë të njëanshme apo të ndërsjellët si dhe ato të prodhimit të përbashkët që janë përfunduar midis palëve, kur kanë një pjesë të kombinuar të tregut që nuk kalon 20% në tregun përkatës. Zakonisht, analiza do të përfshijë vetëm tregun përkatës në të cilin bashkëpunimi është i lidhur drejtpërdrejtë.

Pozicioni në treg i palëve, raporti i përqendrimit, numri i lojtarëve dhe faktorë të tjerë strukturorë

1. Mundësia e ndikimit të marrëveshjes së prodhimit në treg duhet të vlerësohet, nëqoftëse pjesa e kombinuar e tregut të palëve është më e madhe se 20%. Në këtë rast përqendrimi i tregut si dhe pjesët e tregut janë një faktor i rëndësishëm. Sa më e madhe të jetë pjesa e kombinuar e tregut të palëve, aq më i madh është përqendrimi në tregun përkatës. Megjithatë një pjesë e madhe tregu e lejuar për përjashtim nuk do të thotë se ka një raport të lartë përqendrimi.
Për shembull, një pjesë tregu e kombinuar e palëve pak më shumë se 20% mund të gjendet në një treg me një përqendrim mesatar. (HHI nën 1800). Në një rast të tillë efekti kufizues është i pamundur. Në një treg më të përqendruar, me një pjesë tregu më shumë se 20%, mund të kemi kufizim të konkurrencës (shih shembullin 1 në Aneksin 2). Megjithatë, tabloja mund të ndryshojë, nëse tregu është shumë dinamik, me hyrës të rinj në treg dhe pozicione të tregut që ndryshojnë në mënyrë të shpeshtë.
2. Për prodhimin e përbashkët, efektet e rrjetit, për shembull, lidhjet ndërmjet një numri të ndjeshëm të konkurrentëve, gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm. Në një treg të përqendruar, një lidhje mund të përmbysë balancën dhe të krijojë një bashkërendim të mundshëm në këtë treg, edhe nëse palët kanë një pjesë tregu të kombinuar domethënëse, por akoma mesatare. (shih shembullin 2 në Aneksin 2).
3. Sipas rrethanave të veçanta një bashkëpunim ndërmjet konkurrentëve potencialë mund të sjellë probleme për konkurrencën. Megjithatë, kjo është e kufizuar në rastet kur një lojtar i fortë në një treg bashkëpunon me një hyrës potencial real, për shembull, me një ofrues të fortë të të njëjtit produkt apo shërbim në një treg gjeografik fqinj. Zvogëlimi i konkurrencës potenciale krijon probleme të veçanta, nëqoftëse konkurrenca aktuale është e dobët dhe kërcënohet hyrja në treg.

Marrëveshjet nënkontraktuese ndërmjet konkurrentëve

Probleme të ngjashme mund të shtrohen nëse një konkurrent nënkontraktin nga një konkurrent, një përbërës të rëndësishëm ose ndonjë input tjetër për produktin e tij përfundimtar. Kjo mund të çojë në:

- probleme të përjashtimit për palët që kanë një pozicion të fortë si ofrues apo blerës në tregun përkatës të input-it (përdorim jo ekskluziv).
- Efektet e tepërta sigurojnë që imputi të jetë përbërës i rëndësishëm i kostove dhe që palët të kenë pozicion të fortë në tregjet e rrjedhës së poshtme për produktin përfundimtar.

Përfitimet ekonomike

Format më të zakonshme të marrëveshjeve të prodhimit mund të supozohet se shkaktojnë disa përfitime ekonomike në formën e ekonomive të shkallës, ose të qëllimit, apo teknologjive më të mira të prodhimit, edhe pse ato janë një instrument për fiksimit çmimi, kufizim të prodhimit, apo përcaktim të tregut dhe të klientëve. Për këtë arsye, marrëveshjet e specializimit, që përfshijnë specializim të njëanshëm apo reciprok si dhe marrëveshjet e prodhimit të përbashkët përjashtohen, duke u siguruar që ato nuk përmbajnë kufizime të rënda (hardcore) dhe që nuk janë lidhur ndërmjet palëve që kanë një pjesë tregu mbi 20% në tregun përkatës.

Domosdoshmëria

Kur bashkëpunimi sjell kufizime që tejkalojnë përfitimet ekonomike të përshkruara më sipër, nuk do të pranohet, çka nënkupton që palët nuk duhet të jenë të kufizuara në sjelljen e tyre konkurruese përtej kufirit të bashkëpunimit me synim prodhimin.

Nuk ka eliminim të konkurrencës

Marrëveshja e bashkëpunimit nuk përjashtohet, kur ka mundësi të eliminojë konkurrencën në një pjesë të ndjeshme të produkteve në fjalë. Si pasojë e një marrëveshje prodhimi, kur një ndërmarrje ka pozitë dominuese ose krijon pozitë dominuese dhe kur një marrëveshje e tillë sjell efekte anti konkurruese, ajo mund të mos përjashtohet nga ndalimi.

Shëmbujt përkatës për marrëveshjet e prodhimit dhe të specializimit do t'i gjeni në Aneksin Nr. 2.

4. MARRËVESHJET E BLERJES

Përkufizimi

1. Marrëveshjet e blerjes përfshijnë ato lloj marrëveshjesh bashkëpunimi që kanë për objekt blerjen e përbashkët të produkteve. Blerja e përbashkët mund të jetë kryer nga një ndërmarrje e kontrolluar bashkërisht, ose nga një ndërmarrje tek e cila disa shoqëri kanë një shumicë të vogël.
2. Marrëveshjet e blerjes shpesh lidhen ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe/ose të mesme për të shtuar volumin e blerjeve dhe për të zvogëluar numrin e konkurrentëve të mëdhenj. Këto lloj marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme normalisht janë pro konkurruese.
3. Blerjet e përbashkëta mund të përfshijnë marrëveshjet horizontale dhe vertikale së bashku. Në këto raste një analizë në dy faza është e nevojshme. Së pari, marrëveshjet horizontale vlerësohen në përputhje me parimet e përshkruara në këtë udhëzim. Nëqoftëse vlerësimi të çon në konkluzionin që një bashkëpunim ndërmjet konkurrentëve në fushën e blerjes pranohet, atëherë një vlerësim i mëtejshëm do të jetë i nevojshëm për të shqyrtuar marrëveshjen vertikale të përfunduar midis ofruesve dhe shitëseve individualë. Si shembull mund të merret një shoqatë e formuar nga

një grup shitësish me pakicë për blerjen e përbashkët të produkteve. Marrëveshjet horizontale të përfunduara ndërmjet anëtarëve të shoqatës ose vendimet e miratuara nga shoqata, duhet të vlerësohen në radhë të parë si një marrëveshje horizontale në përputhje me këtë udhëzues.

Tregu përkatës

Ekzistojnë dy tregje që mund të preken nga blerja e përbashkët:

- Së pari, tregu në të cilin bashkëpunimi është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, p.sh tregu përkatës i blerjes;
- Së dyti, tregu i shitjes, p.sh tregu në rrjedhën e poshtme ku pjesëmarrësit e marrëveshjeve të blerjeve të përbashkëta janë aktivë si shitësit.

Diferenca e vetme për përcaktimin e “tregjeve të shitjes” është që zëvendësueshmëria përcaktohet nga pikëpamja e ofertës dhe jo nga pikëpamja e kërkesës. Me fjalë të tjera: Alternativat e ofruesve janë vendimtare në identifikimin e kufizimeve të konkurrencës për blerësit. Këto mund të analizohen p.sh duke analizuar reagimin e ofruesve si rrjedhojë e një ulje të vogël por jo të zgjatur të çmimit. Nëse tregu është përcaktuar, pjesa e tregut mund të llogaritet si përqindje për çdo blerje nga palët e interesuara mbi totalin e shitjeve të produkteve, ose shërbimeve të blera në tregun përkatës.

Shëmbull në Aneksin Nr. 3.

Natyra e marrëveshjes

Marrëveshjet që nuk përfshihen në fushën e zbatimit sipas nenit 4 të ligjit.

Sipas natyrës, marrëveshjet e blerjes së përbashkët do të përfundohen ndërmjet ndërmarrjeve që janë të paktën konkurrencte në tregjet e blerjes. Megjithatë, nëse blerësit konkurrentë bashkëpunojnë në të njëjtin treg përkatës të rrjedhës së poshtme, ku nuk janë aktivë, (p.sh shitësit me pakicë të cilët janë aktivë në tregje të ndryshme gjeografike dhe nuk mund të jenë konkurrentë të mundshëm realë), neni 4 të ligjit, do të zbatohet rrallë, përveç se kur palët kanë një pozicion të fortë në tregun e blerjes, i cili mund të përdoret për të dëmtuar pozicionin konkurrues të lojtarëve të tjerë në tregjet e tyre respektive.

Fuqia e tregut dhe struktura e tregut

Analiza fillon me shqyrtimin e fuqisë blerëse të palëve. Fuqia blerëse ekziston nëse në një marrëveshje blerje, për një pjesë të madhe të volumit të një tregu blerjeje, çmimet tentojnë të jenë nën nivelin konkurrues ose hyrja në treg mund të përjashtohet nga blerësit konkurrentë. Një shkallë e lartë e fuqisë blerëse mbi ofruesit e një tregu mund të sjellë inefficiencën të tilla si zvogëlim të cilësisë, pakësim të përpjekjeve inovuese, ose ofertë nën optimalen. Megjithatë, problemet kryesore në kontekstin e fuqisë blerëse janë që çmimet e ulta nuk mund të kalojnë tek konsumatorët e rrjedhës së poshtme dhe shkaktojnë rritjen e kostos për konkurrentët blerës në tregjet e shitjes sepse:

- ofruesit do të përpiqen të mbulojnë zvogëlimin e çmimit për një grup të konsumatorëve nga rritja e çmimeve për konsumatorët ose konkurrentët e tjerë që kanë akses të ulët tek ofruesit eficientë.

Për pasojë, tregjet e blerjes dhe tregjet e shitjes karakterizohen nga ndërvarësitë si më poshtë.

Ndërvarësitë ndërmjet tregut të blerjes dhe shitjes.

Bashkëpunimi i blerësve konkurrues mund të kufizojë ndjeshëm konkurrencën në kuptimin e krijimit të fuqisë blerëse. Ndërsa krijimi i fuqisë blerëse mund të çojë në çmime më të ulta për konsumatorët, fuqia blerëse nuk është gjithmonë pro konkurruese dhe madje në disa rrethana shkakton efekte negative mbi konkurrencën.

- Së pari, kostot më të ulta të blerjes që rezultojnë nga ushtrimi i fuqisë blerëse nuk mund të shihen si pro konkurruese, nëse blerësit së bashku kanë fuqi në tregjet e shitjes. Në këtë rast kursimet nga kostoja mund të mos kalojnë tek konsumatorët. Sa më e madhe të jetë fuqia e kombinuar e palëve, aq më e madhe është nxitja e palëve për të koordinuar sjelljet e tyre si shitës. Kjo mund të lehtësohet nëse palët arrijnë një shkallë të lartë njëtrajtshmërisë së kostove të produkteve të tyre së bashku, nëpërmjet blerjeve të përbashkëta. P.sh nëse një grup i madh i pakicës blen së bashku një pjesë të lartë të produkteve të tyre, ata do të kenë një pjesë të madhe të përbashkët të kostos totale të tyre. Efektet negative të blerjes së përbashkët mund të jenë mjaft të ngjashme me prodhimin e përbashkët.
- Së dyti, fuqia në tregjet e shitjes mund të krijohet ose të rritet nëpërmjet fuqisë blerëse që është përdorur për përjashtimin e konkurrentëve ose për të rritur kostot e kundërshtarëve. Fuqia blerëse e ndjeshme sipas një grupi të konsumatorëve mund të çojë në përjashtimin e blerësve konkurrentë duke kufizuar aksesin e tyre tek ofruesit eficientë. Ai gjithashtu mund të shkaktojë rritjen e kostos për konkurrentët e tij sepse ofruesit do të përpiqen të mbulojnë uljen e çmimit për një grup të klientëve, duke rritur çmimet për një grup klientësh të tjerë (p.sh rabate diskriminuese nga ofruesit e pakicës). Kjo është mundësia e vetme nëse ofruesit e tregjeve të blerjes kanë një shkallë të sigurve të fuqisë së tregut. Në të dy rastet së bashku, konkurrenca në tregjet e shitjes mund të jetë e kufizuar nga fuqia blerëse.

Nuk ka asnjë prag absolut që tregon që një bashkëpunim në blerje krijon disa shkallë të fuqisë së tregut. Megjithatë, në shumë raste është e pamundur që fuqia e tregut të ekzistojë, nëse palët në marrëveshje kanë një pjesë tregu të kombinuar nën 15% në tregun e blerjes, si dhe një pjesë të kombinuar tregu nën 15% në tregun e shitjes.

Përfitimet ekonomike

Marrëveshjet e blerjes mund të sjellin përfitime ekonomike të tilla si ekonomitë e shkallës të porositjeve ose transportin, që mund të sjellin efekte kufizuese. Nëse palët së bashku kanë fuqi blerëse ose shitje të ndjeshme, duhet të analizohet efica. Kursimet e kostos që janë shkaktuar vetëm nga ushtrimi i fuqisë që nuk i përfitojnë konsumatorët, nuk mund të merret parasysh.

Domosdoshmëria

Marrëveshjet e blerjes nuk mund të përjashtohen nëse ato vendosin kufizime që nuk janë domosdoshmëri për të marrë përfitimet e përmendura më sipër. Një detyrim për të blerë ekskluzivisht nëpërmjet bashkëpunimit, në disa raste mund të jetë domosdoshmëri për të arritur një volum të nevojshëm, për realizimin e ekonomive të shkallës. Megjithatë një detyrimi i tillë, do të vlerësohet rast pas rasti.

Shembujt përkatës për marrëveshjet e blerjes do t'i gjeni në Aneksin Nr. 3.

5. MARRËVESHJET E TREGTIMIT

Përkufizimi

Marrëveshjet e tregtimit përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet konkurrentëve në shitje, shpërndarje ose nxitjen e produkteve të tyre. Këto marrëveshje mund të kenë një objekt të larmishëm, të gjerë, në varësi të funksioneve të marketingut, të cilat mbulohen nga bashkëpunimi. Në njëërën anë ekziston një shitje e përbashkët që çon tek një përkufizim i përbashkët i gjithë aspekteve tregtare lidhur me shitjen e produktit, duke përfshirë çmimin. Në anën tjetër këto janë marrëveshje të kufizuara që kanë të bëjnë vetëm me një funksion marketingu të veçantë, të tillë si shpërndarja, shërbimi ose reklama.

Më te rëndësishme nga këto marrëveshje janë marrëveshjet e shpërndarjes. Udhëzuesi mbulon vetëm marrëveshjet vertikale jo reciproke ndërmjet konkurrentëve, nëqoftëse

- (a) ofruesi është një prodhues dhe një shpërndarës i produkteve dhe blerësi është një shpërndarës, i cili gjithashtu nuk është një prodhues i produkteve konkurrencte me produktet e kontratës, ose
- (b) ofruesi është një sigures i shërbimeve në nivele të veçanta të tregtisë, ndërsa blerësi nuk siguron shërbime konkurruese në nivelin e tregtisë ku ai shet shërbimet e kontratës.

Tregu përkatës

Për të vlerësuar marrëdhënien konkurruese ndërmjet palëve bashkëpunuese;

Së pari duhet të përcaktohet tregu përkatës i produktit dhe gjeografik i lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh tregu tek i cili produktet i përkasin subjektit të marrëveshjes).

Së dyti, një marrëveshje tregtimi në një treg mundet gjithashtu të prekë sjelljen konkurruese të palëve në tregun fqinjë që lidhet në mënyrë direkt me tregun përkatës nga bashkëpunimi.

Natyra e marrëveshjes

1. Marrëveshjet e tregtimit përfshihen vetëm brenda juridiksionit të rregullave të konkurrencës, nëse palët në marrëveshje janë konkurrentë. Nëse palët nuk konkurrojnë në mënyrë të qartë në lidhje me produktet apo shërbimet e mbuluara nga marrëveshja, marrëveshja nuk mund të krijojë probleme konkurruese të një natyre horizontale. Gjithashtu, kjo zbatohet nëqoftëse marrëveshja e tregtimit është e nevojshme për të lejuar njëërën palë të hyjë në treg (e cila nuk mund të hynte në mënyrë individuale, p.sh për shkak të kostove). Një zbatim specifik i këtij parimi duhet të jenë marrëveshjet e konsorciumit që i lejojnë ndërmarrjet e përfshira për të arritur një tender/prokurim për projektet që ata nuk kanë mundësi ti përmbushin, ose nuk kanë ftesë për ofertë në mënyrë individuale. Për derisa ata nuk janë konkurrentë të mundshëm për tenderin, nuk mund të kemi kufizim të konkurrencës.
2. Në një marrëveshje tregtimi ndërmjet konkurrentëve mungesa e konkurrencës do të ishte fiksimi i çmimit. Marrëveshjet e kufizuara për shitje të përbashkët kanë si rregull shkak dhe pasojë koordinimin e politikës së çmimit të prodhuesit konkurrues. Në këtë rast ato jo vetëm eliminojnë konkurrencën e çmimit ndërmjet

palëve, por gjithashtu kufizojnë volumin e produkteve për porosinë e përcaktuara për tu shpërndarë nga pjesëmarrësit brenda kuadrit të sistemit.

3. Për marrëveshjet e tregtimit që nuk mbulojnë nga shitja e përbashkët do paraqesin dy probleme kryesore.

I pari, marrëveshjet e tregtimit sigurojnë një mundësi të qartë për ndryshimin e informacionit tregtar në mënyrë të veçantë në strategjinë e marketingut dhe çmimeve.

I dyti, në varësi nga struktura e kostos së marrëveshjes së tregtimit një input domethënës në kostot përfundimtare të palëve, mund të jetë i zakonshëm. Si rezultat, konkurrencën parë në aspektin e çmimit në nivelin e shitjeve përfundimtare mund të jetë e kufizuar.

4. Një aspekt i veçantë lidhur me marrëveshjet e shpërndarjes ndërmjet konkurrentëve, të cilët janë aktivë në tregje gjeografike të ndryshme, është që ato mund të çojnë ose mund të jenë një mjet i copëtimit të tregut. Në rastin e marrëveshjeve reciproke, pjesëmarrësit në marrëveshje që bien dakord për të shpërndarë produktet tek njëri – tjetri, ndajnë tregjet ose klientët dhe eliminojnë konkurrencën ndërmjet atyre. Në këtë rast duhet analizuar nëse marrëveshja në fjalë në mënyrë objektive është e nevojshme për palët për të hyrë në tregun e njëri – tjetrit. Nëse është kështu, marrëveshjet nuk krijojnë probleme në konkurrencë të një natyre horizontale. Megjithatë, marrëveshjet e shpërndarjes janë objekt i nenit 4 të Ligjit, nëqoftëse ato përmbajnë kufizime vertikale të tilla si kufizimet në shitjet pasive, mbajtjen e çmimeve të rishitjes etj. Nëse marrëveshja nuk është mbi baza reciprociteti, risku i copëtimit të tregut është më pak i theksuar. Megjithatë, duhet të vlerësohet, kur marrëveshja nuk është mbi baza reciprociteti dhe ndërton bazat për një mirëkuptim të heshtur për të mos hyrë në tregun e njëri – tjetrit, ose është një mënyrë për të kontrolluar aksesin tek/ose konkurrencën në tregun “importues”.

Fuqia e tregut dhe struktura e tregut

1. Marrëveshjet e tregtimit ndërmjet konkurrentëve, që nuk përfshijnë fiksimin e çmimit janë subjekt për nenin 4 të Ligjit vetëm nëqoftëse palët në marrëveshje kanë disa shkallë të fuqisë së tregut (është i paqartë kuptimi i këtij termi). Në shumë raste, nëse palët në marrëveshje kanë pjesë të kombinuar të tregut nën 15%, është e pamundur që fuqia e tregut të ekzistojë.
2. Nëqoftëse pjesa e kombinuar e tregut është më e madhe se 15% ndikimi që ka kjo marrëveshje e përbashkët e tregtimit duhet të vlerësohet. Në këtë kontekst, përqendrimi i tregut, si dhe pjesët e tregut do të jenë një faktor i rëndësishëm. Sa më i përqendruar të jetë tregu dhe sa më shumë informacion të ketë rreth çmimeve ose strategjisë së marketingut për të ulur pasigurinë, aq më e madhe do jetë iniciativa e palëve për të shkëmbyer një informacion të tillë.

Përfitimet ekonomike

1. Eficiencat që janë marrë parasysh në vlerësimin nëse një marrëveshje tregtimi e përbashkët mund të jetë e përjashtuar, do të varen nga natyra e veprimtarisë. Përgjithësisht, fiksimi i çmimit nuk justifikohet, edhe nëse është i domosdoshëm integrimi i funksioneve të tjera të marketingut dhe nëse nga ky integrim do të

prodhohen efienca esenciale. Përmasat e efiençave të prodhuara varen inter alia nga rëndësia e veprimtarive të marketingut të përbashkët në strukturën e kostos të produktit në fjalë. Shpërndarja e përbashkët është më e mundshme të gjenerojë efienca për prodhuesit e produkteve të konsumit, të shpërndara gjerësisht se sa për prodhuesit e produkteve industriale, të cilat blihen vetëm nga një numër i kufizuar të përdoruesve.

2. Përveç kësaj, efiençat që rezultojë vetëm nga eliminimi i kostos, që janë pjesë e pandarë e konkurrencës, duhen të mos jenë ruajtur, përveç atyre që rezultojnë nga integrimi i veprimtarive ekonomike një zvogëlim i kostos së transportit, si pasojë e ndarjes së klientëve jashtë integritit të çdo sistemit logjistik, mund të mos jetë një efikasitet që e bën një marrëveshje të përjashtueshme.

Domosdoshmëria

Një marrëveshje tregtimi nuk mund të përjashtohet nëse ajo vendos kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjet e përfitimeve të sipërpërmendura. Atje ku si një pasojë e një marrëveshje tregtimi, një ndërmarrje ka pozitë dominuese ose shndërrohet në ndërmarrje me pozitë dominuese, një marrëveshje e tillë që prodhon efekte anti konkurruese, nuk përjashtohet.

Shembujt përkatës për marrëveshjet e tregëtimit do t'i gjeni në Aneksin Nr. 4.

6. MARRËVESHJE MBI STANDARTIZIMIN

Përkufizimi

Marrëveshjet e standardizimit kanë si objekt të tyre kryesor përcaktimin e kërkesave teknike ose cilësore me të cilat mund të përputhen produktet në qarkullim ose ato të ardhshme, proceset e prodhimit ose metodat. Marrëveshjet e standardizimit mund të mbulojnë çështje të ndryshme të tilla si standardizimi i shkallëve apo përmasave të ndryshme të një produkti të veçantë, ose specifikimet teknike në tregjet ku përputhshmëria dhe ndërveprueshmëria me produkte ose sisteme të tjera është thelbësore. Termat e aksesit për një markë cilësie të veçantë ose për miratimin nga një ent rregullator mund të konsiderohen gjithashtu si një standard.

Tregu përkatës

Marrëveshjet e standardizimit prodhojnë efektet e tyre në tre tregje të mundshëm.

Së pari, tregu i produktit, të cilit i referohet standardit. Standardet për produktet tërësisht të reja mund të nxjerrin në pah çështje të ngjashme me ato që shfaqen tek marrëveshjet e K&Zh, për sa kohë bëhet fjalë për çështjen e përcaktimit të tregut.

Së dyti, tregu i shërbimeve për vendosjen e standardeve, nëse ekzistojnë strukturat e vendosjes së standardit ose marrëveshjeve të ndryshme.

Së treti, në raste të caktuara, treg i dallueshëm për testimin dhe certifikimin.

Marrëveshjet për standardet lidhen ose ndërmjet ndërmarrjeve private, ose lidhen me mbështetjen e strukturave publike, ose strukturave të cilave iu është besuar sigurimi i shërbimeve të interesit të përgjithshëm publik.

Natyra e marrëveshjes

1. Në rastet ku pjesëmarrja në vendosjen e standardit është e pakufizuar dhe transparente, marrëveshjet e standardizimit siç përcaktohet më sipër, të cilat nuk vendosin detyrimin për të përmbushur standardin, apo të cilat janë pjesë të një marrëveshje më të gjerë për sigurimin e përputhshmërisë së produkteve, nuk kufizojnë konkurrencën. Kjo normalisht zbatohet për standardet e miratuar nga strukturat e njohura të standardizimit, të cilat janë bazuar në procedura jo diskriminuese, të hapura dhe transparente.
2. Asnjë kufizim i ndjeshëm nuk ekziston për ato standarde që kanë një mbulim të papërfillshëm të tregut përkatës, për aq kohë sa ato mbeten të tilla. Asnjë kufizim i ndjeshëm nuk gjendet edhe në marrëveshjet, të cilat vendosin së bashku me SME-të (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) për të standardizuar formën e aksesit ose kushtet për tenderët kolektive ose ato që standardizojnë aspekte të tilla si karakteristikat e parëndësishme të produktit, format dhe raportet, të cilat kanë një efekt të pandjeshëm mbi faktorët kryesorë që prekin konkurrencën në tregjet përkatëse.
3. Marrëveshjet që përdorin një standard që është pjesë e një marrëveshjeje kufizuese më të gjerë, me synim përjashtimin e konkurrentëve aktualë ose të mundshëm, janë objekt i nenit 4 të Ligjit. P.sh: në këtë kategori do të hyjë një marrëveshje në bazë të së cilës një shoqatë kombëtare e prodhuesve vendos një standard dhe ushtron presion mbi palët e treta që të mos tregtoje produktet e tregut që nuk përputhen me standartizimin e vendosur nga kjo shoqatë.
4. Marrëveshjet e standardizimit mund të jenë subjekt i zbatimit të nenit 4 të Ligjit në rastet kur ato i sigurojnë palëve kontrollin e përbashkët mbi prodhimin dhe/ose inovacionin, duke kufizuar aftësinë e tyre për të konkurruar për karakteristikat e produktit, si dhe prekin palët e treta si ofruesit apo blerësit e produkteve të standardizuara. Vlerësimi i çdo marrëveshjeje duhet të marrë parasysh natyrën e standardit dhe efektin e tij në tregjet korresponduese nga njëra anë dhe nga ana tjetër, qëllimin e kufizimeve të mundshme tejkalojnë qëllimin e standardizimit.
5. Ekzistenca e kufizimeve të konkurrencës në marrëveshjet e standardizimit varet nga shtrirja tek e cila palët mbeten të lira për të zhvilluar standarde alternativë ose produkte që nuk përputhen me standardin e pranuar. Marrëveshjet e standardizimit mund ta kufizojnë konkurrencën në rastet kur ato pengojnë palët (nga zhvillimi i standardeve alternativë ose tregtimin e produkteve që nuk përputhen me standardin). Marrëveshjet që ngarkojnë struktura të caktuara, të besueshme, me të drejta ekskluzive për të testuar përputhshmërinë me standardet, tejkalojnë qëllimin kryesor për përcaktimin e standardit dhe gjithashtu mund të kufizojnë konkurrencën. Gjithashtu, mund të kufizojnë konkurrencën marrëveshjet që vendosin kufizime të etiketimit të konformitetit me standardet, përveç rasteve kur kjo është e detyrueshme nga dispozita ligjore rregulluese.

Fuqia e tregut dhe struktura e tregut

Pjesët e mëdha të tregut, të mbajtura nga palët në tregun e prekur nuk sjellin probleme për marrëveshjet e standardizimit. Efektiviteti i tyre është shpesh në proporcion me pjesën e tregut që ka industria e përfshirë në vendosjen dhe/ose zbatimin e standardit. Nga njëra anë, standardet që nuk janë të disponueshme për palët e treta mund të diskriminojnë ose përjashtojnë palët e treta ose segmente tregu sipas fushës gjeografike të zbatimit të tyre. Kështu, vlerësimi nëse marrëveshja kufizon konkurrencën, do të fokusohet, domosdoshmërisht mbi një bazë individuale, si dhe do të shtrihet deri aty ku heqja e pengesave të tilla për hyrjen është e mundur.

Përfitimet ekonomike

Në përgjithësi, Autoriteti duhet të mbajë një qëndrim pozitiv ndaj marrëveshjeve që nxisin futjen në tregun e përbashkët ose nxisin zhvillimin e tregjeve të reja dhe përmirësojnë kushtet e ofertës.

Me synim për të arritur përfitime teknike dhe ekonomike, standardet nuk duhet të kufizojnë novacionin. Kjo do të varet në radhë të parë nga jetëgjatësia e produkteve plotësuese, si dhe nga stadi i zhvillimit të tregut. Efektet mbi inovacionin duhet të analizohen rast pas rasti. Palët mund të tregojnë (mbi bazën e të dhënave të sigurta) që standardizimi kolektiv siguron rritjen e efikasitetit për konsumatorin, kur një standard i ri mund të shkaktojë vjetrimin e shpejtë dhe të pajustificueshëm të produktit ekzistues, pa përfitime objektive shtesë.

Domosdoshmëria

Sipas natyrës së tyre, standardet nuk do të përfshijnë të gjithë specifikimet apo teknologjitë e mundshme. Në disa raste, mund të jetë i nevojshëm për përfitimin e konsumatorëve dhe ekonomisë në përgjithësi, për të pasur vetëm një zgjidhje teknologjike. Megjithatë, ky standard duhet të vendoset në baza jo diskriminuese. Në mënyrë ideale, standardet duhet të jenë të veçuara nga teknologjia. Në çdo rast duhet të jepet argumentimi përse zgjidhet një standard ndaj një tjetri.

Pjesëmarrja në vendosjen e një standardi duhet të jetë e hapur për të gjithë, përveç rasteve kur palët demonstronë mungesën e efikasitetit në një pjesëmarrje të tillë, ose nëse ekzistojnë procedura të njohura të cilat rregullojnë përfaqësimin e interesave kolektive, ashtu si dhe në strukturat formale të standardeve.

Duhet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet vendosjes së një standardi dhe K&Zh në lidhje me këtë standard, si dhe shfrytëzimit tregtar të atij standardi. Marrëveshjet për standardet duhet të mbulojnë jo më shumë se sa është e nevojshme për të siguruar qëllimet e tyre, qoftë kur bëhet fjalë për përputhueshmëri teknike apo një nivel të caktuar të cilësisë. Për shembull, duhet të tregohet shumë qartë pse është e domosdoshme që për krijimin e përfitimeve ekonomike me kusht që një marrëveshje të sigurojë një standard në një industri, ku vetëm një konkurrenues ofron një alternativë, kjo marrëveshje duhet të detyrojë palët në marrëveshje për ta bojkotuar alternativën.

Shembujt përkatës për marrëveshjet e standartizimit do t'i gjeni në Aneksin Nr. 5.

7. MARRËVESHJET MJEDISORE

Përkufizimi

Marrëveshjet mjedisore janë ato marrëveshje të cilat palët i ndërmarrin për të arritur uljen e ndotjes, siç përcaktohet në ligjin e mjedisit, ose në objektivat mjedisore. Prandaj, qëllimet dhe masat e pranuar nevojiten të jenë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me uljen e elementëve ndotës ose të ndonjë forme të njohur të çlirimit të mbetjeve të përcaktuara si të tilla në rregulloret përkatëse. Kjo përjashton marrëveshjet që prekin rënien e nivelit të ndotjes si një nënprodukti të masave të tjera.

Tregu përkatës

Kur elementi ndotës nuk është një produkt në vetvete, tregu përkatës do të jetë ai i produktit në të cilin është inkorporuar (trupëzuar) elementi ndotës. Për sa i përket marrëveshjeve të mbledhjes/riciklimit, përveç efekteve të tyre në tregje ku palët janë aktive si prodhues ose shpërndarës, duhet të vlerësohen edhe efektet në tregun e shërbimeve të grumbullimit të ndotjeve që potencialisht mbulojnë produktin në fjalë.

Natyra e marrëveshjes

1. Vlerësimi do të fokusohet në diskrecionin që do t'u jepet palëve në lidhje me mjetet teknike dhe ekonomike të vlefshme me qëllim për të arritur objektivin mjedisor të pranuar. Sa më shumë mjete të tilla të ketë, aq më pak të ndjeshme do jenë efektet e mundshme kufizuese.
2. Në mënyrë të ngjashme, marrëveshjet që caktojnë performancën mjedisore të produkteve ose proceset që nuk ndikojnë ndjeshëm produktin dhe shumëllojshmërinë e prodhimit në tregun përkatës ose ato rëndësia e të cilave është marxhinale për të influencuar në vendimet blerëse, nuk përfshihen brenda fushës së veprimit të nenit 4 të Ligjit. Atje ku disa kategori të një produkti janë ndaluar ose nxjerrë nga tregu, kufizimet nuk mund të gjykohen të ndjeshme, përderisa pjesa e tyre e tregut në tregun gjeografik përkatës është e papërfillshme (minor).
3. Së fundi, marrëveshjet të cilat mundësojnë krijimin e një tregu të ri, p.sh marrëveshjet e riciklimit, përgjithësisht nuk kufizojnë konkurrencën, për aq kohë sa palët nuk do të jenë të afta të kryejnë veprimtaritë e tyre në mënyrë të pavarur, ndërkohë që mungojnë alternativat e tjera dhe/ose konkurrentët e tyre.
4. Marrëveshjet mjedisore që nga natyra e tyre, përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit nga natyra, në qoftë se bashkëpunimi në të vërtetë nuk synon realizimin e objektivave mjedisore, por shërben si një instrument për tu angazhuar në një marrëveshje të ndaluar të maskuar, p.sh fiksimi i çmimit, kufizimi i prodhimit, ndarja e tregjeve, ose nëse bashkëpunimi përdoret si një ndër mjetet e një marrëveshje kufizuese të gjerë, e cila synon përjashtimin e konkurrentëve aktualë ose të mundshëm.
5. Marrëveshjet mjedisore që mbulojnë një pjesë të madhe të një industrie në nivel kombëtar, mund të jenë objekt i nenit 4 të Ligjit në rast se ato kufizojnë ndjeshëm aftësinë e palëve për të projektuar karakteristikat e produkteve të tyre ose mënyrën e tyre të prodhimit, duke siguruar përparësi mbi prodhimin apo shitjet e njëri – tjetrit. Përveç kufizimeve ndërmjet palëve, një marrëveshje mjedisore, mund të zvogëlojë ose të prekë ndjeshëm prodhimin e palëve të treta, që mund të jenë si të ofruesit ashtu edhe të blerësit.

6. Marrëveshjet mjedisore, të cilat mund të nxjerrin jashtë tregut, ose të prekin ndjeshëm palët në një pjesë të rëndësishme të shitjeve të produktit të tyre ose të procesit të prodhimit, mund të përfshihen brenda fushës së veprimit të nenit 4 të Ligjit kur palët kanë një pjesë domethënëse të tregut. Kjo zbatohet njësoj edhe në rastin kur palët caktojnë kuota individuale të ndotjes.
7. Në mënyrë të ngjashme, marrëveshjet në të cilat, palët që kanë pjesë të mëdha të tregut, në një pjesë thelbësore të tregut të përbashkët, caktojnë një ndërmarrje si ofrues ekskluziv të shërbimeve të mbledhjes dhe/ose riciklimit të produkteve të tyre, gjithashtu mund të kufizojnë ndjeshëm konkurrencën, me kusht që të ekzistojnë ofrues të tjerë aktualë ose realisht potencialë.

Përfitimet ekonomike

1. Autoriteti mban qëndrim pozitiv për rastet e marrëveshjeve mjedisore në planet e veprimit mjedisor, me kusht që marrëveshje të tilla janë në përputhje me rregullat e konkurrencës.
2. Marrëveshjet mjedisore që përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit mund të japin përfitime ekonomike, të cilat si në nivel individual, ashtu edhe në nivelin e përgjithshëm konsumator, tejkalojnë efektet e tyre negative në konkurrencë. Për të përmbushur këtë kusht, duhet të ekzistojnë përfitime neto të shprehura në uljen e presionit mjedisor të rezultuara nga marrëveshja, mbi bazë krahasimi me nivelin e këtij presioni në kohën kur nuk është marrë asnjë veprim. Me fjalë të tjera, përfitimet ekonomike të pritshme duhet të tejkalojnë kostot.
3. Kosto të tilla përfshijnë efektet e uljes së konkurrencës së bashku me kostot e përshtatjes për operatorët ekonomikë dhe/ose efektet mbi palët e treta. Përfitimet mund të vlerësohen në dy faza. Nëse konsumatorët në mënyrë individuale kanë një normë pozitive kthimi nga marrëveshja gjatë një periudhe të arsyeshme kthimi, nuk është e nevojshme që përfitimet e përgjithshme mjedisore të vendosen objektivisht. Në të kundërt, një analizë përfitim-kosto mund të jetë e nevojshme për të vlerësuar nëse përfitimet neto për konsumatorët në përgjithësi janë të mundshme sipas supozimeve të arsyeshme.

Domosdoshmëria

1. Kur një marrëveshje mjedisore demonstroi me objektivitet eficiencën ekonomike, aq më qartësisht çdo masë mund të gjykohet si domosdoshmëri për arritjen e qëllimit mjedisor brenda kontekstit të tij ekonomik.
2. Një vlerësim objektiv i të dhënave të cilat “prima facie” mund të gjykohen si jo të domosdoshme, duhet të mbështeten me analiza efektivitet – kosto, duke treguar që, në bazë të supozimeve të arsyeshme, masat alternative për arritjen e përfitimeve mjedisore të pritshme, do të ishin më të kushtueshme ekonomikisht dhe financiarisht. P.sh: duhet të tregohet qartësisht që zbatimi i një tarife uniforme, pavarësisht nga kostot individuale për grumbullimin e mbetjeve, është domosdoshmëri për funksionimin e një sistemi grumbullues mbarë industrial.

Shëmbujt përkatës për marrëveshjet mjedisore do t'i gjeni në Aneksin Nr. 6.

ANEKS Nr. 1

MARRËVESHJET E KËRKIM ZHVILLIMIT

Shembulli 1

Situata: Janë dy ndërmarrje kryesore në treg për prodhimin e pjesëve elektronike ekzistuese: A (30%) dhe B (30%). Secili nga këto ka kryer një investim në marrëveshjen e K&Zh për zhvillimin e pjesëve elektronike në miniaturë dhe kanë zhvilluar prototipet e para. Tani, ata pranojnë për të bashkuar përpjekjet e tyre për K&Zh, duke krijuar një ndërmarrje të përbashkët, për të plotësuar K&Zh dhe të prodhojnë pjesët, të cilat do t'iu shiten sërish ndërmarrjeve që krijuan ndërmarrjen e përbashkët, të cilat do t'i tregtojnë ato veçmas. Në treg kanë ngelur ndërmarrje të vogla me burime të pamjaftueshme për të ndërmarrë investimet e duhura.

Analiza: Pjesët elektronike në miniaturë, ndërsa kanë mundësi të konkurrojnë me pjesët ekzistuese në disa zona, janë në thelb një teknologji e re. Në këtë rast analiza duhet bërë nisur nga dy polet e kërkimit në drejtim të këtij tregu të ardhshëm. Në qoftë se ndërmarrja e përbashkët zhvillohet, atëherë prodhimi teknologjik do të ekzistojë vetëm në një drejtim, ndërsa duhej të shfaqej mundësia që A dhe B mund të arrijnë individualisht tregun me produkte veçmas. Ndërsa marrëveshja mund të ketë përparësi në sjelljen e një teknologjie të re, me shpejtësi të përparuar, ajo gjithashtu zvogëlon llojshmërinë dhe krijon një njëtrajtshmëri të kostos midis palëve. Duhet të merret parasysh mundësia e palëve për të shfrytëzuar pozicionin e tyre në tregun ekzistues. Përderisa ata nuk do të përballojnë konkurrencë në nivelin e K&Zh për të vijuar teknologjinë e re nën ritmin e lartë, nxitja do zvogëlohet ndjeshëm. Megjithatë, disa nga këto probleme rregullohen duke i kërkuar palëve të japin licenca për njohuritë bazë të prodhimit të pjesëve në miniaturë. Përsëri do të jetë e pamundur të rregullohen të gjitha problemet dhe të përmbushen kushtet për një përjashtim.

Shembulli 2

Situata: Një kompani kërkimesh e vogël A, e cila nuk ka strukturë të vetën për marketingun, ka zbuluar dhe certifikuar një substancë farmaceutike të bazuar në një teknologji të re që do të revolucionarizojë trajtimin e një sëmundje të caktuar. Ndërmarrja hyn në një marrëveshje K&Zh me një prodhues të madh farmaceutik B, që prodhon produkte farmaceutike që deri në atë moment janë përdorur për trajtimin e sëmundjes. Ndërmarrjes B i mungon çdo program i ngjashëm K&Zh. Për produktet ekzistuese, ndërmarrja B ka një pjesë tregu prej rreth 75% në treg, por patentat kanë afatin e skadencës brenda një periudhe 5 vjeçare. Ekzistojnë dy pole të tjera për kërkimet, që afërsisht kanë të njëjtin stad të zhvillimit dhe që përdorin të njëjtën bazë të teknologjisë së re. Ndërmarrja B do të sigurojë fonde dhe njohuri të konsiderueshme për produktin e zhvilluar për t'u futur në të ardhmen në treg. Ndërmarrjes B i është dhënë një licencë për prodhim dhe shpërndarje ekskluzive të rezultateve të produktit për kohëzgjatjen e patentës. Pritet që palët të sjellin bashkërisht produktin në treg nga 5 në 7 vjet.

Analiza: Produkti ka mundësi ti përkasë një tregu të ri përkatës. Palët sjellin burime plotësuese dhe kapacitete për bashkëpunim dhe probabiliteti i produktit për të hyrë në treg, rritet ndjeshëm. Megjithëse, ndërmarrja B duket se ka fuqi tregu të konsiderueshme në tregun ekzistues, kjo fuqi do të ulët shumë shpejt dhe ekzistenca e poleve të tjera të kërkimit është e mundshme për të eliminuar çdo nxitës që zvogëlon përpjekjet K&Zh. E

drejta e shfrytëzimit gjatë periudhës së mbetur të patentës, ka mundësi të jetë e nevojshme për ndërmarrjen B për të bërë investime të konsiderueshme të kërkuara nga ndërmarrja A, që nuk ka në zotërim burime marketingu. Në këtë mënyrë marrëveshja duket se nuk kufizon konkurrencën.

Shembulli 3

Situata: Dy ndërmarrje inxhinierie që prodhojnë pjesë këmbimi për autovetura, pranojnë të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët për të kombinuar përpjekjet e tyre K&Zh për të përmirësuar prodhimin dhe performancën e një pjesë këmbimi ekzistuese. Ato gjithashtu bashkojnë teknologjitë e tyre duke licencuar një biznes në këtë fushë, por do vazhdojnë të prodhojnë në veçanti. Të dy ndërmarrjet kanë pjesë tregu prej 15% dhe 20% në tregun e produktit OEM. Ekzistojnë edhe dy konkurrentë të tjerë të mëdhenj, si dhe disa programe kërkimi të brendshme të prodhuesve të mëdhenj të autoveturave. Në tregun ndërkombëtar për licencimin e teknologjive për këto produkte ato kanë pjesë prej 20% dhe 25% të matura në termat e të ardhurave të gjeneruara dhe janë dy teknologji të tjera të mëdha. Cikli i jetës së produktit për pjesët e këmbimit është kryesisht 2 - 3 vjet. Në çdo 5 vitet e fundit njëra nga ndërmarrjet e mëdha ka futur në treg një version të ri ose e ka përmirësuar atë.

Analiza: Përderisa përpjekjet e asnjërës ndërmarrje për K&Zh nuk synojnë një produkt tërësisht të ri, tregjet që do të merren parasysh janë ato për pjesët ekzistuese dhe për licencimin e teknologjive përkatëse. Megjithatë (programet e tyre ekzistuese të K&Zh mbivendoseshin gjerësisht) dublimi më i zvogëluar nëpërmjet bashkëpunimit do t'i lejojë ata të shpenzojnë më shumë në K&Zh se sa do të shpenzonin individualisht. Ekzistojnë disa teknologji të tjera dhe pjesa e kombinuar e palëve në tregun e OEM nuk u krijon atyre një pozicion dominues. Megjithëse pjesa e tyre në tregun teknologjik është shumë e lartë, në 45%, ekzistojnë edhe teknologji konkurruese. Përveç kësaj, prodhuesit e autoveturave, të cilët aktualisht nuk e kanë licencuar teknologjinë e tyre, janë gjithashtu hyrës të mundshëm në këtë treg, duke kufizuar në këtë mënyrë aftësinë e palëve për të ngritur çmimin. Siç është përkrahur, ndërmarrja e përbashkët ka mundësi të përfitojë nga një përjashtim.

ANEKS Nr. 2

MARRËVESHJET E PRODHIMIT DHE SPECIALIZIMIT

Prodhimi i përbashkët

Shembulli 1

Situata: Dy ofrues A dhe B mbi bazën e produktit kimik X vendosin të ngrenë një fabrikë të re prodhimi të kontrolluar nga një ndërmarrje e përbashkët. Kjo fabrikë do të prodhojë afërsisht 50% të totalit të produktit të tyre. X-i është një produkt homogjen dhe nuk është i zëvendësueshëm nga produkte të tjera, d.m.th formon një treg përkatës në zotërimin e tij. Tregu është mjaft i qëndrueshëm. Palët nuk do të rrisin në mënyrë të ndjeshme prodhimin e përgjithshëm, por do mbyllnin përkohësisht dy fabrikat e vjetra dhe do ndryshojnë kapacitetin për fabrikën e re. Edhe A edhe B kanë një pjesë tregu prej 20%. Në këtë treg ekzistojnë tre ofrues ku secili ka 10-15% pjesë tregu dhe disa lojtarë më të vegjël.

Analiza: Ka mundësi që kjo marrëveshje e përbashkët të ketë një efekt në sjelljen konkurruese të palëve, sepse koordinimi do tu japë atyre fuqi të konsiderueshme tregu, edhe nëse nuk ekziston një pozicion dominues. Efektet kufizuese të rënda në treg janë të mundshme. Rritjet e mëdha të eficiencës që mund të peshojnë më shumë në anën e këtyre efekteve, janë të pamundura të ndodhin në një rast të tillë ku një rritje e ndjeshme në prodhim nuk mund të jetë e pritshme.

Shembulli 2

Situata: Dy ofrues A dhe B formojnë një prodhim të përbashkët në të njëjtin treg përkatës si në shembullin 1. Gjithashtu, marrëveshja e përbashkët prodhon 50% të totalit të produktit të palëve. Edhe A edhe B kanë një pjesë tregu prej 15%. Janë dhe 3 lojtarë të tjerë: C me një pjesë tregu 30%, D me 25% dhe E me 15%. B ka tashmë një fabrikë të përbashkët me E.

Analiza: Tregu këtu është i karakterizuar nga disa lojtarë dhe nga një strukturë mjaft simetrike. Ndërmarrja e përbashkët krijon një lidhje shtesë ndërmjet lojtarëve. Bashkëpunimi ndërmjet A edhe B, de facto do të rrisë më tej përqendrimin dhe gjithashtu lidhjen e E tek A edhe B. Ky bashkëpunim ka mundësi të shkaktojë një efekt kufizues serioz dhe si në shembullin 1, nuk mund të priten arritje të larta të eficiencës.

Shembulli 3

Situata: A dhe B paraqet një prodhim të ndërmarrjes së përbashkët, për një produkt të ndërmjetëm X, nëpërmjet ristrukturimit të fabrikës. Ndërmarrja e përbashkët shet produktin X ekskluzivisht A dhe B. Prodhon 40% të totalit të produktit të A dhe 50% të totalit të produktit të B. A dhe B janë përdoruesit ekskluzivë të produktit X dhe janë gjithashtu ofruesit jo ekskluzivë të tregut. Pjesa e A në totalin e produktit industrial të X është 10%, pjesa e B është baras me 20% dhe pjesa e ndërmarrjes së përbashkët 14%. Megjithatë, në tregun jo ekskluziv A dhe B kanë respektivisht 25% dhe 35% pjesë tregu.

Analiza: Pavarësisht nga pozicioni i fortë i palëve jo ekskluzivë në treg, bashkëpunimi nuk mund të eliminojë efektin konkurrues në treg për X, nëse ndryshimi i kostove ndërmjet përdorimit ekskluzivë dhe jo ekskluzivë janë të vogla. Megjithatë, vetëm një ndryshim shumë i shpejtë duhet të kundërveprojë në pjesën e madhe të tregut prej 60%. Ndryshe ky prodhim i përbashkët do të shfaqë interesa konkurruese serioze, të cilat nuk mund të barazpeshohen nga përfitimet ekonomike të ndjeshme.

Shembulli 4 i përket bashkëpunimit në lidhje me një produkt të ndërmjetëm të rëndësishëm, me efekte të tepërta në tregun e rrjedhjes së poshtme.

Shembulli 4

Situata: A dhe B paraqet një prodhim të ndërmarrjes së përbashkët për një produkt të ndërmjetëm X. Ata do të mbyllin fabrikat e tyre të vjetra në zotërim, të cilat kanë qenë prodhuese të produktit X dhe do të mbulojnë nevojat e produktit të tyre X nga ndërmarrja e përbashkët. Produkti i ndërmjetëm X llogaritet nga 50% i totalit të kostove të produktit përfundimtar Y.

A dhe B secila ka një pjesë tregu 20% për produktin Y. Ekzistojnë edhe dy ofrues të tjerë

domethënës të Y-së ku secili ka 15% pjesë tregu dhe disa konkurrentë të vegjël.

Analiza: Këtu njëtrajtshmëria e kostove është e madhe; për më tej, palët duan të fitojnë fuqi tregu, nëpërmjet koordinimit të sjelljeve të tyre në tregun e produktit Y. Rasti i shfaqjes të problemeve të konkurrencës dhe vlerësimi është pothuajse identik si shembulli 1, megjithëse këtu bashkëpunimi është në tregun e rrjedhës së sipërme.

Specializimi reciprok

Shembulli 5

Situata: A dhe B secila prodhojnë dhe ofrojnë produktet homogjene X dhe Y, të cilat i përkasin tregjeve të ndryshme. Pjesa e tregut të A-së të produktit X është 28% dhe e Y është 10%. Pjesa e tregut të B-së tek produkti X është 10% dhe tek produkti Y është 30%. Për shkak të ekonomive të shkallës ato përfundojnë një marrëveshje specializimi reciprok, sipas të cilës A do të prodhojë në të ardhmen vetëm produktin X dhe B do të prodhojë vetëm Y.

Të dy së bashku pranojnë ofertat e kryqëzuara kështu që ato do të mbeten në tregje si ofrues. Lidhur me natyrën homogjene të produkteve, kostot e shpërndarjes janë të vogla.

Ekzistojnë edhe dy ofrues të tjerë të prodhimit të X dhe Y me pjesë tregu afërsisht 15% secili dhe ofruesit e mbetur kanë një pjesë 5-10%.

Analiza: Shkalla e njëtrajtshmërisë së kostove është shumë e lartë, vetëm një shpërndarje relativisht e vogël e kostove mbetet e veçuar. Për pasojë ekziston vetëm një hapësirë e vogël për konkurrencën. Palët duan të fitojnë fuqi tregu nëpërmjet koordinimit të sjelljeve të tyre në treg për X dhe Y. Për më tepër, ka mundësi që tregu i ofruesve të Y nga A dhe X nga B do të zvogëlohet gjatë kohës. Rasti shfaq probleme të konkurrencës që ekonomitë e shkallës e kanë të pamundur për ta baraspeshuar.

Skenari mund të ndryshojë nëqoftëse X dhe Y ishin produkte heterogjene me një masë shumë të lartë të kostove të marketingut dhe shpërndarjes (d.m.th 65-70% e totalit të kostove). Për më tepër nëse oferta e produkteve të diferencuara është kusht për një konkurrencë të suksesshme, atëherë tërheqja e një apo më shumë palëve si ofrues të X dhe/ose Y është e pamundur. Në një skenar të tillë kriteri për përjashtim mund të jetë përmbushur pavarësisht nga pjesa e lartë e tregut (Sigurohet që ekonomitë janë të ndjeshme).

Nënkontraktimi ndërmjet konkurrentëve

Shembulli 6

Situata: A dhe B janë konkurrent në treg për produktin përfundimtar X. A-ja ka një pjesë tregu prej 15% dhe B-ja prej 20%. Të dy së bashku prodhojnë mallin e ndërmjetëm Y, i cili shërben si lëndë e parë në prodhimin e produktit X, por gjithashtu përdoret për prodhimin e produkteve të tjera. Ai llogaritet si 10% e kostos të X-it. A-ja prodhon produktin Y vetëm për konsumin e brendshëm, ndërsa B-ja është gjithashtu shitës i Y tek palë të treta konsumatorësh. Pjesa e tregut të tyre për Y është 10%.

A dhe B pranojnë në një marrëveshje nënkontraktuese, ku A do të blejë 60% të kërkesave të veta të Y nga B-ja. Ai do të vazhdojë të prodhojë 40% të kërkesave të tij të brendshme pa humbur kurrë lidhur me prodhimin e Y-së.

Analiza: Së pari, duke qenë se A-ja është prodhuesi i vetëm i Y-it për konsumin e brendshëm, duhet të analizohet, nëse A është një hyrës potencial real në tregun e shitjeve Y tek palët e treta. Në rastin e kundërt, marrëveshja nuk kufizon konkurrencën lidhur me Y. Efektet e tepërta në treg për X-in gjithashtu janë të pamundura duke marrë parasysh shkallën e ulët të njëtrajtshmërisë së kostove të krijuara nga marrëveshja.

Nëse A shihet si një hyrës potencial real në tregun tregtar për shitjet e Y palëve të treta, pozicioni në treg i B-së për Y nevojitet të mbahet parasysh. Duke qenë se pjesa e tregut të B-së është mjaft e ulët rezultati analizave nuk ndryshon.

ANEKS Nr. 3

MARRËVESHJET E BLERJES

Shembull: Një grup prodhuesish të makinave pranojnë të blejnë së bashku produktin X. Blerja e tyre e kombinuar e X është e barabartë me 15 njësi. Të gjitha shitjet e X për prodhuesit e makinave është e barabartë me 50 njësi. Megjithatë, X u është shitur prodhuesve të produkteve të tjera sa makinat. Të gjitha shitjet e X llogariten nga 100 njësi. Kështu pjesa e tregut (të blerjes) të grupit është 15%.

Shembulli 1

Situata: Dy prodhues, A dhe B vendosin të blejnë bashkërisht përbërësin X. Ata janë konkurrentë në tregun e tyre të shitjes. Shitjet e tyre së bashku përfaqësojnë 35% të totalit të shitjeve të X në treg, i cili supozohet të jetë tregu gjeografik përkatës. Ekzistojnë edhe 6 konkurrentë të tjerë (konkurrentë të A dhe B në tregun e tyre të shitjes), që llogaritet të mbajnë 65 % të tregut të blerjes; njëri ka 25%, ndërsa të tjerët llogariten të kenë pjesë më pak të ndjeshme. Nga ana e ofertës tregu është mjaft i përqendruar me 6 ofrues të përbërësit X, dy me një pjesë nga 30% secili dhe mbetja me 10-15% (HHI nga 2300-2500) Në tregun e tyre të shitjes, A dhe B kapin një pjesë të kombinuar prej 35%.

Analizat: Përsa i takon fuqisë së tregut të palëve në tregun e tyre të shitjes, përfitimet nga kursimet e mundshme të kostos, nuk mund t'i kalojnë tek konsumatori përfundimtar. Për më tepër blerjet e përbashkëta kanë mundësi për të rritur kostot e palëve konkurrentë më të vegjël pasi dy ofruesit më të fuqishëm rimbulojnë në mënyrë të mundshme zvogëlimet e çmimit për grupin sipas rritjes së çmimeve të konsumatorëve më të vegjël. Duke rritur përqendrimin në tregun e rrjedhës së poshtme, bashkëpunimi mund të na çojë në një përqendrim të mëtejshëm ndërmjet ofruesve. Edhe një përqendrim më i vogël (i cili gjithmonë mund të punojë afër ose nën minimumin optimal të shkallës) çon në nxjerrjen nga tregu nëse ata nuk mund të ulin më tej çmimet. Një rast i tillë i mundshëm shkakton një kufizim të ndjeshëm të konkurrencës.

Shembull 2

Situata: 150 shitës të vegjël pakice përfundojnë një marrëveshje për të formuar një organizatë blerëse të përbashkët. Ata janë të detyruar të blejnë një minimum volumi

nëpërmjet organizatës, e cila llogaritet për rreth 50% nga totali i kostos së secilit shitës pakice. Shitësit me pakicë mund të blejnë nëpërmjet organizatës më shumë se sa minimumi i volumit dhe gjithashtu mund të blejnë nga jashtë bashkëpunimit. Ata kanë një pjesë të kombinuar të tregut prej 20% për secilin në tregun e blerjes dhe të shitjes. A dhe B janë 2 konkurrentët më të mëdhenj të tyre, A ka 25% në secilin treg të interesuar dhe B 35%. Diferenca e konkurrentëve më të vegjël ka formuar gjithashtu një grup blerjeje. 150 shitësit me pakicë arrijnë nga kombinimi i ekonomive një shumë të ndjeshme të volumit dhe çështjeve të blerjes.

Analizat: Shitësit me pakicë mund të arrijnë një shkallë të larë të kostove nëse ata përfundimisht blejnë së bashku më shumë se sa minimumi i volumit të pranuar. Megjithatë, së bashku ata kanë vetëm një pozicion tregu të mesëm në tregun e blerjes dhe të shitjes. Për më tepër, bashkëpunimi sjell disa ekonomi të shkallës. Ky bashkëpunim ka mundësi të përjashtohet.

Shembulli 3

Situata: Dy zinxhirë supermaketesh përfundojnë një marrëveshje për të blerë bashkërisht produktet që llogariten rreth 50% të totalit të kostove të tyre. Në tregjet përkatëse të blerjes për kategori të ndryshme të produkteve, palët kanë pjesë tregu ndërmjet 25% dhe 40%, në tregun përkatës të shitjes ata arrijnë 40% (supozohet që ka vetëm një treg gjeografik në tregun përkatës). Ekzistojnë edhe 5 shitës të tjerë me pakicë me 10-15% pjesë tregu secili. Hyrja në treg në këtë rast nuk është i mundur.

Analizat: Ka të ngjarë që kjo marrëveshje blerjeje e përbashkët të ketë një efekt mbi sjelljet konkurruese të palëve, sepse bashkëpunimi duhet t'i japë atyre fuqi tregu të ndjeshme. Veçanërisht ky është rasti kur hyrja është e dobët. Nxitja për të koordinuar sjelljen është më e madhe nëse kostot janë të ngjashme. Margjinave e ngjashme duhet tu shtohet një nxitës për të pasur të njëjtat çmime. Edhe pse eficiencat shkaktohen nga bashkëpunimi, nuk ka mundësi të përjashtohen lidhur me shkallën e lartë të fuqisë së tregut.

Shembulli 4

Situata: Kooperativat e vogla përfundojnë një marrëveshje për të formuar një organizatë blerëse të përbashkët. Ato janë të detyruara të blejnë një minimum volumi nëpërmjet organizatës. Palët mund të blejnë më shumë se sa minimumi i volumit nëpërmjet organizatës. Por ata gjithashtu mund të blejnë nga jashtë organizatës së bashkuar. Secila nga palët ka një pjesë tregu në total 5% në secilin nga tregjet e blerjes dhe shitjes, duke dhënë një pjesë tregu të kombinuar prej 25%. Janë edhe dy shitës të tjerë me pakicë që secili ka 20-25% pjesë tregu dhe një numër i shitëseve më të vegjël me pakicë me pjesë tregu nën 5%.

Analizat: Krijimi i organizatës së blerjeve të përbashkëta ka mundësi ti japë palëve një pozicion tregu në tregjet e blerjes dhe të shitjes së bashku, të një shkalle, e cila i mundëson ata të konkurrojnë me dy shitësit me pakicë më të mëdhenj. Përveç kësaj, prania e këtyre dy lojtarëve të tjerë me nivele të ngjashme të pozicionit të tregut, ka mundësi të rezultojë në një marrëveshje me efikasitet që kalon tek konsumatorët. Në një rast të tillë marrëveshja ka të ngjarë të përjashtohet.

ANEKS Nr. 4

MARRËVESHJET E TREGTIMIT

Shembulli 1

Situata: 5 prodhues të vegjël ushqimesh, secili me nga 2% pjesë të tregut në tregun e përgjithshëm ushqimor, pranojnë që: të kombinojnë lehtësitë shpërndarëse të tyre, të tregtojnë nën emrin e markës së përbashkët, dhe të shesin produktet e tyre me të njëjtin çmim. Kjo përfshin një investim të rëndësishëm në magazina, transport, reklamë, marketing dhe një detyrim shitje. Në mënyrë domethënëse redukton koston bazë të tyre, duke përfaqësuar në mënyrë tipike 50% të çmimit me të cilin ata shesin dhe u lejon atyre për të ofruar një sistem shpërndarje eficient më të shpejtë. Klientët e prodhuesve ushqimorë janë hallkat e mëdha të zinxhirit të shitjeve me pakicë.

Tre grupe të mëdhenj ushqimore shumëkombëshe dominojnë tregun, ku secila ka 20% pjesë të tregut. Pjesa e mbetur e tregut përbëhet nga prodhues të vegjël, të pavarur. Linjat e produktit të palëve të kjo marrëveshje mbivendosen në disa zona domethënëse, por pjesa e tyre e kombinuar e tregut, në tregun e produktit, nuk kapërcen 15%.

Analizat: Marrëveshja përfshin fiksimin e çmimit dhe kështu përfshihet brenda fushës së veprimit në nenit 4 të Ligjit, edhe pse palët në marrëveshje nuk mund të konsiderohen si mbajtës të fuqisë së tregut. Megjithatë, integrimi i marketingut dhe shpërndarjes shfaqet për të siguruar eficienta domethënëse, të cilat së bashku përbëjnë përfitimet e konsumatorëve porsa i përket shërbimit të përmirësuar dhe koston më të ulët. Çështja është nëse marrëveshja është e përjashtueshme. Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të vendoset nëse fiksimi i çmimit është domosdoshmëri për integrimin e funksioneve të tjera të marketingut dhe arritjes së përfitimeve ekonomike. Në këtë rast, fiksimi i çmimit mund të shihet si domosdoshmëri, aq sa klientët e zinxhirit të madh të pakicës nuk dëshirojnë të merren me një gamë të gjerë të çmimeve. Gjithashtu, është domosdoshmëri aq sa qëllimi i një marke të përbashkët (që mund të jetë besueshmëria e fituar) dhe të gjitha aspektet e marketingut, përfshirë edhe çmimet janë standardizuar.

Shembulli 2

Situata: Dy prodhues të kushinetave, me 5% pjesë tregu secili, krijojnë një ndërmarrje të përbashkët shitjeje, që do të tregtojë produktet, do përcaktojë çmimet dhe do të ndajë porositë tek ndërmarrjet mëmë. Ato ruajnë të drejtën për të shitur jashtë kësaj strukture. Shpërndarjet për klientët vazhdojnë të bëhen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fabrikat fqinje. Ata pretendojnë që kjo do të krijojë eficienta, meqenëse forca e përbashkët shitëse mund të paraqesë produktet e palëve në të njëjtën kohë dhe për të njëjtët klientë, duke eliminuar kështu një dublim të kotë të përpjekjeve të shitjes. Përveç kësaj, ndërmarrja e përbashkët, atje ku do ishte e mundshme, do të shpërndante porositë tek fabrika më e afërt e mundshme, duke reduktuar kështu koston e transportit.

Analizat: Marrëveshja përfshin fiksimin e çmimit dhe kështu bie brenda fushës së veprimit të nenit 4 të ligjit, edhe pse palët në marrëveshje nuk mund të konsiderohen si mbajtës të fuqisë së tregut. Ato nuk mund të përjashtohet, për sa kohë eficientat e pretenduara janë vetëm zvogëlime të koston të rrjedhura nga eliminimi i konkurrencës ndërmjet palëve.

Shembulli 3

Situata: 2 prodhues të pijeve të buta janë aktivë në 2 tregje të ndryshëm, fqinjë. Së bashku kanë një pjesë tregu 20% në tregun e tyre të brendshëm. Ato pranojnë të shpërndajnë në mënyrë

reciproke produktet e njëri tjetrit në tregun gjeografik korespondues. Së bashku tregjet janë të dominuar nga një numër i madh prodhuesish pijesh të buta, ku secili ka një pjesë tregu prej 50%.

Analiza: Marrëveshja bie brenda fushës së veprimit të nenit 4 të Ligjit, nëqoftëse palët do ishin konkurrentë të mundshëm. Për të vlerësuar këtë kërkohet një analizë e pengesave të hyrjes në tregjet gjeografikë korespondues. Në qoftë se palët mund të kenë hyrë në mënyrë të pavarur në tregjet e njëri – tjetrit, atëherë kjo marrëveshje eliminon konkurrencën ndërmjet tyre. Megjithatë, edhe pse pjesa e tregut të palëve tregon që ata mund të kenë disa fuqi tregu, një analizë e strukturës së tregut tregon që kjo nuk është shkak. Përveç kësaj, në një marrëveshje shpërndarëse reciproke përfitojnë klientët për atë sa ajo rrit zgjedhjen e përshtatshme në secilin treg gjeografik. Marrëveshja duhet të jetë e përjashtuar edhe pse konsiderohej kufizuese për konkurrencën.

ANEKS Nr. 5

MARRËVESHJET E STANDARTIZIMIT

Shembulli 1

Situata: EN 60603-7:1993 përcakton kërkesat për të lidhur marrësit televizivë tek aksesorët gjenerues të videove të tillë si video regjistruarit dhe video games. Megjithëse standardi nuk është ligjërish i detyrueshëm, në praktikë prodhuesit e marrësve televizivë dhe video-gameve së bashku përdorin standardin, duke qenë se kjo është kërkesë e tregut.

Analiza: Neni 4 i Ligjit nuk është shkelur. Standardi ka qenë i miratuar nga strukturat e njohura të standardeve, nëpërmjet procedurave të hapura dhe transparente në nivel kombëtar, Evropian dhe ndërkombëtar dhe bazohet në konsensusin kombëtar duke pasqyruar pozicionin e prodhuesve dhe konsumatorëve. Të gjithë prodhuesit lejohen të përdorin standardin.

Shembulli 2

Situata: Një numër prodhuesish video kasetash pranojnë të zhvillojnë një markë cilësore ose standard për të treguar faktin që video kasetat përmbush minimumin e caktuar të specifikimeve teknike. Prodhuesit janë të lirë të prodhojnë videokasetat të cilat nuk janë në përputhje me standardin dhe standardi është lirish i disponueshëm për zhvilluesit e tjerë.

Analiza: Me kushtin që marrëveshja nuk kufizon në ndonjë mënyrë tjetër konkurrencën, neni 4 i Ligjit nuk është shkelur, duke qenë se pjesëmarrja në vendosjen e standardit është e pakufizuar dhe transparente dhe marrëveshja e standardizimit nuk vendos detyrim për përputhshmëri me standardin. Në qoftë se palët pranojnë të prodhojnë vetëm videokasetat, të cilat janë konform standardit të ri, marrëveshja do të kufizonte zhvillimin teknik dhe do të pengonte palët në shitjen e produkteve të diferencuara, gjë që do të përbente shkelje të nenit 4 të Ligjit.

Shembulli 3

Situata: Një grup konkurrentësh aktivë në tregje të ndryshme, të cilët janë të ndërruar me produktet që duhet të jenë të krahasueshëm dhe me mbi 80% të tregjeve përkatëse, pranojnë

të zhvillojnë bashkërisht një standard të ri që do të futet në konkurrencë me standardet e tjerë të pranishëm në treg, të zbatuara gjerësisht nga konkurrentët e tyre. Produktet e ndryshme që do të përputhen me standardin e ri nuk do të jenë në përputhje me standardet ekzistuese. Për shkak të investimit të madh të kërkuar për të kaluar nga një standard tek tjetri dhe për të mbajtur prodhimin sipas një standardi të ri, palët bien dakord që të kryejnë një volum të shitjeve të produkteve sipas standardit të ri me qëllim për të krijuar një “sasi kritike” në treg. Gjithashtu ata bien dakord të kufizojnë volumin e prodhimit individual të tyre në nivelin e arritur në vitin e fundit, për produktet jo në përputhje me standardin.

Analiza: Kjo marrëveshje për shkak të fuqisë së palëve në treg dhe kufizimeve në prodhim, bie brenda fushës së veprimit të nenit 4 të Ligjit, me përjashtim të rasteve kur aksesin në informacionin teknik ishte siguruar mbi baza jo diskriminuese dhe terma të arsyeshme për ofruesit e tjerë që duan të konkurrojnë.

ANEKS Nr. 6

MARRËVESHJET MJEDISORE

Shembull 1

Situata: Pothuajse të gjithë prodhuesit dhe importuesit të një aparati shtëpiak të dhënë (p.sh makina larëse), pranojnë me nxitjen e një strukture publike të mos prodhojnë dhe mos importojnë në treg, produkte, të cilat nuk janë në përputhje me një kriter mjedisor të caktuar (p.sh efienca e energjisë). Së bashku, palët mbajnë 90% të tregut. Produktet, të cilat do të lihen jashtë tregut llogariten si një pjesë e rëndësishme e totalit të shitjeve. Ato do të zëvendësohen me produkte të tjera që favorizojnë mjedisin, por njëkohësisht janë produkte më të shtrenjta. Marrëveshja në mënyrë indirekte zvogëlon prodhimin e palëve të treta (p.sh pajisjet elektrike, ofruesit e përbërësve të inkuorporuar (trupëzuar) në produktet e nxjerra jashtë tregut).

Analiza: Marrëveshja u jep palëve kontrollin e prodhimit dhe importit individual dhe i korrespondon një pjese të ndjeshme të shitjeve të tyre dhe totalit të prodhimit (outputit), ndërsa zvogëlon prodhimin e palëve të treta. Zgjedhja konsumatorë, e cila është fokusuar pjesërisht në karakteristikat mjedisore të produktit, ulet dhe çmimet do të ngrihen. Marrëveshja përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit.

Megjithatë, produktet më të reja janë më të avancuara teknikisht dhe duke zvogëluar problemet e mjedisit, gjë që synohet në mënyrë indirekte, (emetimi nga prodhimi energjisë), ato nuk do të krijojnë ose rrisin në mënyrë të paevitueshme një problem tjetër mjedisor (p.sh konsumin e ujit, përdorimin e detergjentit). Kontributi neto për përmirësimin e situatës mjedisore tejkalon rritjen e kostove. Për më tepër, blerësit individualë të produkteve më të shtrenjta, do të rikuperojnë me shpejtësi rritjen e kostos përderisa produktet më të favorshme për mjedisin kanë kosto operative më të ultë.

Alternativat e tjera kundrejt marrëveshjes konsiderohen të jenë më pak të sigurta dhe me kosto – efektivitet më të ulët për arritjen e të njëjtave përfitime neto. Mjetet teknika të ndryshme janë ekonomikisht të disponueshme për palët që synojnë të prodhojnë produkte të cilat janë në përputhje me karakteristikat mjedisore të pranuar dhe konkurrenca do të vazhdojë të ekzistojë për karakteristikat e tjera të produktit. Për këto arsye, kushtet për përjashtim janë përmbushur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 138, Datë 17.02.2010

Për

“Miratimi i Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009 dhe synimet kryesore për vitin 2010”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.02.2009 shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm, të titulluar “Raporti vjetor 2009 dhe synimet kryesore për vitin 2010”.

Bazuar në nenet 24, germa e dhe 29 germa ç të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pas shqyrtimit të projekt-raportit të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009 dhe synimet kryesore për vitin 2010” sipas raportit bashkëlidhur këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
 (_____)
 Anëtar

Koço Broka
 (_____)
 Anëtar

Rezana Konomi
 (_____)
 Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 139, Datë 24.02.2010

Mbi

Autorizimin e përqendrimit për përftimin e plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së 100% aseteve të shoqërisë target Sara Lee Air Care.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.02.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit për përftimin e plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të biznesit ndërkombëtar të kompanisë target Sara Lee Air Care.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit”; Aneksi I- Formulari i thjeshtuar i njoftimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit dhe Relacionit të Sekretares së Përgjithshme bashkëlidhur këtij raporti,

V Ë R E N S E:

Palët:

Procter & Gamble Group, në cilësinë e blerësit, me seli në Ohajo, SHBA, nëpërmjet filialeve të saj ushtron veprimtari brenda dhe jashtë SHBA-së për prodhimin e produkteve të kujdesit shtëpiak, të bukurisë, të shëndetit, si dhe të produkteve për bebet dhe familjen.

Sara Lee Corporation, në cilësinë e shitësit, me seli në Illinois, SHBA, ushtron veprimtarinë e saj në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të markuara për konsumatorët në të gjithë botën, të përqendruara kryesisht në kategoritë e mishit, brumrave, pijeve, mirëmbajtjes shtëpiake dhe kujdesit për trupin.

Shoqëria Sara Lee Air Care, objektivi i operacionit (target), me seli në Illinois, USA, ushtron veprimtarinë e saj në tregun ndërkombëtar të prodhimit dhe tregimit të produkteve të aromatizuesave të ajrit nën markën Ambi Pur.

Përqendrimi

Transaksioni përfshin blerjen 100% të veprimtarisë ekonomike (biznesit) të Sara Lee Air Care, për prodhimin dhe tregtimin ndërkombëtar të produkteve të aromatizuesave të ajrit nën markën Ambi Pur.

Ky transaksion është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të blerësit (P&G) për zgjerimin e tregut të prodhimit dhe tregimit të aromatizuesave, ku veprimtaria e tij është e kufizuar vetëm në aromatizuesin e tekstileve të markës “Febreze”.

Xhiro për vitin 2009

Përqëndrimi i njoftuar është objekt i autorizimit të Komisionit të Konkurrencës pasi plotëson kriteret e xhiros në kuptim të nenit 12, pika 1.

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është xxxxx miliardë lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është xxxxx miliard lekë

Tregu Përkatës:

- Tregu i produktit: Aromatizuesit e ajrit, që përfshijnë këto nëntregje:
 - Aromatizuesh shtëpish
 - Aromatizues makinash
 - Aromatizues banjosh; dhe
 - Aromatizues tekstilesh

Tregu gjeografik: Teritorri i Republikës së Shqipërisë.

Tregje të prekura: Produktet, të cilat prodhohen dhe tregtohen nga të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në përqendrim dhe që i përkasin të njëjtit grup (aromatizuesish) nuk kanë të njëjtin qëllim përdorimi, pra nuk janë produkte të zëvendësueshme ose të shkëmbyeshme.

Si konkluzion,

Transaksioni i njoftuar që konsiston në përfitim të kontrollit ndërmjet Procter & Gamble dhe Sara Lee Corporation, me objektiv blerjen 100 % të aseteve të prodhimit, shpërndarjes dhe tregimit të produkteve të aromatizuesave në Sara Lee Air Care, nuk të çon në ndryshime strukture, mbivendosje të pjesëve të tregut apo rritje të pjesëve të

tij, sepse ndërmarrjet pjesëmarëse veprojnë në tregje të ndryshme të produktit. Nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqendrimi dhe krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregje të brendshme për ndërmarrjet objekt përqendrimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar për përftimin e plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së 100% aseteve të shoqërisë target Sara Lee Air Care.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

()

()

()

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 139/1, Datë 01.04.2010

**“Për disa korigjime e saktësime në
Vendimin Nr. 139 datë 24.02.2010”**

“Mbi autorizimin e përqendrimit për përfitimin e plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes 100 % të aseteve të shoqërisë target Sara Lee Air Care”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ndrejja e gabimeve materiale që nuk prekin përmbajtjen e Vendimit Nr. 139 datë 24.02.2010 të Komisionit të Konkurrencës “Mbi autorizimin e përqendrimit për përfitimin e plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes 100 % të aseteve të biznesit të target Sara Lee Air Care”.

Baza ligjore: Neni 24 shkronja “d”, i Ligjit Nr 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Neni 120 dhe 129 i Ligjit Nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm për ndrejjen e gabimeve materiale të dukshme që nuk prekin përmbajtjen e Vendimit Nr. 139 datë 24. 02.2010 të Komisionit të Konkurrencës dhe kërkesës së shoqërisë Procter & Gamble Company, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 26/7 Prot. datë 26. 03. 2010.

V Ë R E N S E:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës shoqëria Procter & Gamble Company ka paraqitur kërkesën e saj, protokolluar me Nr. 26/7 Prot. datë 26. 03.2010, e cila kërkon nga Autoriteti i Konkurrencës që të bëhen disa saktësime në Vendimin Nr. 139 datë 24. 02. 2010 të Komisionit të Konkurrencës.

Sipas kësaj kërkesë, në pjesët e vendimit Nr. 139 datë 24. 02. 2010 ku është përshkruar Sara Lee Air Care, është cituar si “shoqëria Sara Lee Air Care”, duke e trajtuar atë si një shoqëri me personalitet juridik të veçantë nga Sara Lee Corporation, ndërkohë që Sara Lee Air Care është emërtim i një biznesi.

Komisioni i Konkurrencës është i mendimit se kërkesa e Procter & Gamble Company është e drejtë dhe se gjatë përpilimit të vendimit Nr. 139 datë 24. 02. 2010 në pjesën “palët” është bërë një gabim i dukshëm duke e konsideruar biznesin Sara Lee Air Care me seli në Illinois, USA si një shoqëri me personalitet juridik të veçantë nga shoqëria Sara Lee Corporation.

E njëjta gjë është në titullin e këtij vendimi dhe në pikën “1” të pjesës urdhëruese të tij, ku biznesi i emërtuar “Sara Lee Air Care”, vazhdon të konsiderohet si “shoqëria “Sara Lee Air Care”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 24 shkronja” d”, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenet 120 e 129 të Ligjit nr. 8485 datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”

V E N D O S I:

1. Në përmbajtjen e Vendimit Nr. 139 datë 24.02.2010 në pjesën “palët”, paragrafi me përmbajtje: “Shoqëria Sara Lee Air Care, objektivi i operacionit (target), me seli në Illinois, USA, ushtron veprimtarinë e saj në tregun ndërkombëtar të prodhimit dhe tregtimit të produkteve të aromatizuesave të ajrit nën markën Ambi Pur”, të korrigjohet e saktësohet me këtë përmbajtje: “Sara Lee Air Care”, objektivi i operacionit (target), ushtron veprimtarinë e saj në tregun ndërkombëtar të prodhimit dhe tregtimit të produkteve të aromatizuesave të ajrit nën markën Ambi Pur”.
2. Në titullin dhe në pikën “1” të pjesës urdhëruese të vendimit Nr. 139 datë 24. 02. 2010 fjala “shoqërisë” të korrigjohet me “biznesit”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K O M I S I O N I I K O N K U R R E N C Ë S

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 140, Datë 10.03.2010

“Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.03.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të Grupit të Punës për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma d, dhe neni 44.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Grupit të Punës mbi kufizimet e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm dhe pas dëgjimit të palëve në seancën e organizuar në datën 10 mars 2010.

V Ë R E N S E:

Nisur nga disa shqetësime të shprehura nëpërmjet mediave dhe ankesat e disa operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e importit dhe të tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) për situatën e konkurrencës në këtë treg, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës mori vendimin nr. 1, datë 17.02.2010 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim - shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”. Këto shqetësime janë ngritur edhe nëpërmjet shkresave të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr 81, datë 12.02.2010 dhe nr 102, datë 25.02.2010.

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të vendimit të mësipërm dhe në bazë të neneve 35 dhe 36 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pajisi me Autorizim Inspektimi me nr 85, datë 17.02.2010, inspektorët e grupit të punës, për kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtronin veprimtari në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm.

Në vazhdim të hetimit, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, më datë 02.03.2010, njoftuan dhe vunë në dispozicion të koncensionarëve vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës Nr. 1, datë 17.02.2010 dhe në bazë të neneve 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” kryen një inspektim pranë zyrave qendrore të ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA.

Porti “Vlora-1” i është dhënë me koncesion nga shteti ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO RUMENA” SPA, me anë të Ligjit nr. 9231, datë 13.05.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit të formës “BOO” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës”, si dhe për ratifikimin e “marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës”.

Referuar nenit 3 të Marrëveshjes së Koncesionit, terminali është projektuar dhe do të funksionojë si një terminal shërbimesh të pavarura, i hapur për të gjithë operatorët e kualifikuar, veçanërisht në industrinë e naftës dhe koncensionarit nuk i lejohet të ushtrojë veprimtari tregtare për naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre.

Sipas nenit 5, pika 7 të kësaj Marrëveshje, koncesionari gjatë afatit të koncesionit detyrohet të kryejë shërbimet përkatëse në lidhje me depozitat dhe me trajtimin (ngarkim-shkarkimin në tokë ose në det) e produkteve të naftës dhe gazeve të lëngshme të naftës, për çdo operator të licencuar kombëtar ose ndërkombëtar të interesuar të operojë me një terminal të pavarur të një niveli shumë të lartë.

Referuar nenit 8 të kësaj Marrëveshje, koncesionarit i jepet e drejta që: “të jetë i vetmi entitet, në të gjithë zonën e Gjirit të Vlorës (përfshirë zonën detare dhe platformat detare, nëse ka, të Gjirit të Vlorës), që do të lejohet të ndërtojë dhe të shfrytëzojë një terminal bregdetar dhe infrastrukturën e tij portuale, përfshirë këtu edhe platformat në det, si dhe i vetmi entitet i pajisur me të drejtën për të depozituar e trajtuar (ngarkim-shkarkim) (nga brenda dhe nga jashtë, nga toka dhe nga deti) naftë, produkte të naftës, produkte të gazit të lëngshëm dhe produkte të tjera të lëngshme.

Gjatë inspektimeve, nga përfaqësuesit e ndërmarrjes u deklarua se aktualisht janë ndërtuar 2 sfera për depozitimin e gazit me kapacitet 2 450 m³ secila, që përdoren deri në 2 000 m³ për arsye sigurie. Të dyja këto depozita sferike i janë dhënë në përdorim ndërmarrjes “KALAJA” SHA (që ushtron veprimtari importi dhe tregtimi të GNL-së) dhe ndërmarrjet e tjera importuese, për shkarkimin e gazit duhet të kontaktojnë paraprakisht me “KALAJA” SHA. Lidhur me këto shpjegime u mbajt dhe procesverbali i datës 02.03.2010, “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.

Në procedurën e inspektimit u administrua një kopje e kontratës “Për shërbimin e depozitimit dhe trajtimit të produkteve të lëngshme”, të lidhur midis ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA dhe ndërmarrjes “KALAJA” SHA, si dhe Shtojca nr. 1, datë 23.06.2009 dhe Lidhja “A”, datë 29.08.2008, bashkëngjitur saj. Gjithashtu u gjet dhe një shkresë e ndërmarrjes “KALAJA” SHA drejtuar ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, ku i kërkohej kësaj të fundit lejimi i

shkarkimit të një anijeje me gaz për llogari të shoqërisë “GLOBAL GAZ” SHA dhe të gjitha detyrimet kontraktuale do të jenë në ngarkim të ndërmarrjes “KALAJA” SHA. Për kryerjen e këtij inspektimi dhe marrjen e evidencave të mësipërme u mbajtën dhe procesverbalet e datë 02.03.2010, “Për inspektimin në ndërmarrje”.

Tregu përkatës

Tregu i shërbimit të ngarkim – shkarkimit dhe depozitimit të hidrokarbureve.

Ky treg funksionon si një treg i liberalizuar për sa i përket aktivitetit të import/eksportit në rrugë detare të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, kjo veprimtari realizohet vetëm nëpërmjet dy porteve të naftës në zonën e ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës dhe në zonën e Porto Romanos, Durrës, porte të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit përkatësisht me ndërmarrjet LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA dhe Porto Romano SHA, duke pasur të “drejtën ekskluzive” për këtë lloj shërbimi.

Në portin “Vlora - 1” sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave shkarkohen dhe depozitohen rreth 55 % të totalit të gazit të lëngshëm të importuar, pjesa tjetër prej 45 % shkarkohet dhe depozitohet nëpërmjet Portit të Porto Romanos në Durrës, dhe vetëm 1 % në rrugë tokësore.

Vlerësimi ligjor

Nga vlerësimi ligjor rezulton se ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit i është dhënë ekskluziviteti për të ndërtuar dhe shfrytëzuar një terminal bregdetar dhe infrastrukturën e nevojshme portale, si dhe ekskluziviteti për të depozituar dhe trajtuar (ngarkim-shkarkimi) gazin e lëngshëm të naftës.

Nga shqyrtimi i kontratës të lidhur midis ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA dhe ndërmarrjes “KALAJA” SHA, si dhe Shtojca nr. 1, datë 23.06.2009 dhe Lidhja “A”, datë 29.08.2008, bashkëngjitur saj, rezulton se ndërmarrja “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, ka vënë në dispozicion të ndërmarrjes “KALAJA” SHA të gjithë kapacitetin e saj depozitues për gazin e lëngshëm, si dhe impiantin e ngarkim shkarkimit të këtij produkti, duke kufizuar mundësinë e importuesve të tjerë për të shkarkuar dhe depozituar produktin e tyre.

Depozitat e GLN-së dhe rrjeti i tubacioneve që formojnë sistemin e ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së, përbëjnë një “lehtësi esenciale” (essential facility), për ushtrimin e kësaj veprimtarie, pasi:

- Për ushtrimin e veprimtarisë së importit të GLN-së nga ndërmarrjet importuese është i domosdoshëm aksesin në këtë infrastrukturë për të konkurruar në treg. Ky akses duhet të sigurohet në baze të nenit 5, pika 7 të Marrëveshjes së Koncesionit për çdo operator të licencuar kombëtar ose ndërkombëtar të interesuar.
- Sipas nenit 8 të Marrëveshjes së Koncesionit, terminali dhe zona e koncesionit portual janë ekskluzive si i vetmi terminal bregdetar dhe e vetmja infrastrukturë portuale për depozitimin dhe trajtimin (ngarkim-shkarkim) (nga brenda dhe nga jashtë, nga toka dhe nga deti, produkte të gazeve të lëngshme dhe produkte të tjera të lëngshme në Gjirin e Vlorës.

Ndërmarrja “ LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA me anë të kontratës “Për shërbimin e depozitimit dhe trajtimit të produkteve të lëngshme”, të lidhur me ndërmarrjen “KALAJA” SHA ka kufizuar të drejtën e operatorëve të tjerë që ushtrojnë veprimtari importi dhe tregtimi me shumicë të GLN për të shkarkuar dhe depozituar produktet e tyre, pasi ia ka kaluar këtë “lehtësi esenciale”, vetëm ndërmarrjes “KALAJA” SHA, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj tregtimin me shumicë të gazit të lëngshëm të naftës, duke i kaluar kësaj ndërmarrje administrimin e kësaj “lehtësie esenciale”, pra ngarkim-shkarkimin dhe depozitimin e GLN-së në territorin e Gjirit të Vlorës.

Aktualisht nga inspektimet e kryera dhe dokumentet e administruara rezulton se ndërmarrja “KALAJA” SHA është e vetmja ndërmarrje e cila ka të drejtën të shkarkojë dhe të depozitojë produktet e saj në depozitat në pronësi të “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA.

Kjo kontratë që në kuptim të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” përbën një marrëveshje vertikale, mund të sjellë kufizime në konkurrencë në tregun e importit të GLN-së, pasi nuk u ka dhënë mundësinë ndërmarrjeve të tjera që operojnë në këtë treg për shkarkimin dhe depozitimin e këtij produkti. Kjo situatë ka eliminuar thuajse plotësisht konkurrentët e ndërmarrjes “KALAJA” SHA në këtë segment të tregut.

Si konkluzion, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, duke parë dhe mundësinë e shkeljes së nenit 9, pika 2 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, nenin 44 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Marrjen e masave të përkohshme si vijon :
 - 1.1 Detyrimin e menjëhershëm dhe jo me vonë se 5 ditë nga njoftimi i vendimit të ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, për të mundësuar ankorimin, shkarkimin, trajtimin dhe depozitimin e GLN-së, për çdo operator të licencuar kombëtar ose ndërkombëtar të interesuar të operojë në këtë terminal;
 - 1.2 Njoftimin pranë Autoritetit të Konkurrencës për përjashtim nga ndalimi me vendim të Komisionit të Konkurrencës të të gjitha marrëveshjeve të koncensionarit “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” në bazë të neneve 6 dhe 49 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,.
2. Masat e përkohëshme merren për një periudhë kohore deri në përfundim të hetimeve.
3. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën 1 të këtij vendimi ndëshkohet me gjobë 2-10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b e ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, në bazë të nenit 76 të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore ne vitin financiar paraardhes, deri sa shoqëria “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e vendimit shoqërisë “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA dhe ndërmarrjes “KALAJA” SHA.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)

(_____)

(_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 141, Datë 18.03.2010

**“Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese”
për revokimin e Vendimit Nr 140, datë 10.03.2010 të Komisionit të
Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.03.2010 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” SHA për revokimin e vendimit nr.140, datë 10.3.2010, të Komisionit të Konkurrencës, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma d, dhe neni 46 .

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes “La Petrolifera Italo Albanese” SHA, për revokimin e vendimit nr.140, datë 10.03.2010, të Komisionit të Konkurrencës,

V Ë R E N S E:

Kërkesa e ndërmarrjes “La Petrolifera ItaloAlbanese” SHA, për revokimin e vendimit nr.140, datë 10.3.2010, nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga neni 46 e Ligjit 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pra është e pabazuar ne ligj dhe ne prova. Gjithashtu kërkesa e paraqitur nga “La Petrolifera ItaloAlbanese” SHA për nxjerrjen e udhëzimeve për te mundesuar zbatimin e vendimit 140,te Komisionit te Konkurrences është e pa mbështetur në Ligjin 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, nenin 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.140, datë 10.3.2010, të Komisionit të Konkurrencës “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”
2. Rezimin e kërkeses se ndermarrjes “La Petrolifera Italo-Albanese”SHA për revokimin e Vendimit Nr.140 date 10.03.2010 te Komisionit te Konkurrences “Per marrjen e masave te perkohshme ne tregun e sherbimit te ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit te gazit te lengshem”
3. Rezimin e kërkeses se ndermarrjes “La Petrolifera Italo Albanese”SHA nxjerrjen e udhezimeve ne zbatim te vendimit nr.140 date 10.03.2010 te Komisionit te Konkurrences “Per marrjen e masave te perkohshme ne tregun e sherbimit te ngarkim shkarkimit dhe depozitimit te gazit te lengshem”
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “La Petrolifera Italo Albanese” SHA.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

()

()

()

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)**KRYETARE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 142, Datë 15.03.2010

“Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj “Raiffeisen Bank” Sh.a për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit dhe përcaktimi i kushteve dhe detyrimeve për “Raiffeisen Bank” Sh.a”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.03.2010 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit të thelluar për abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese të “Raiffeisen Bank” në tregun e bonove të thesarit

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 9, pika 2, germa dh), neni 24, shkronja d dhe neni 45 pika 2;

Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”,

Komisioni i Konkurrencës pasi shqyrtoi raportin e grupit të punës për hetimin e thelluar në tregun e bonove të thesarit, të hapur me Vendimin Nr. 98, datë 18.12.2008 të Komisionit të Konkurrencës, relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe pretendimet e palës, të paraqitura në seancën dëgjimore të datës 18.01.2010 dhe të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës në data 15.01.2010 dhe 04.02.2010,

KONSTATOI:

I. Procedurat e ndjekura

- 1) Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II të pjesës II dhe në Kreun II dhe III të pjesës së III të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

- 2) Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, germa a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me nismën e tij, gjatë vitit 2008 nisi një monitorim në tregun bankar në përgjithësi dhe tregun e bonove të thesarit në veçanti, për të parë nëse konkurrenca në këtë treg ishte e kufizuar si pasojë e sjelljes së një apo disa aktorëve të tregut apo si pasojë e akteve ligjore/nënligjore që rregullonin këtë treg.
- 3) Në përfundim të monitorimit të kryer në tregun primar të bonove të thesarit nga Sektori i Studimit dhe Analizës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me anë të Vendimit Nr. 8, datë 15.07.2008 vendosi “Hapjen e hetimit paraprak në tregun primar të bonove të thesarit”.
- 4) Në përfundim të hetimit paraprak të kryer në tregun primar të bonove të thesarit rezultoi se tregu primar i bonove të thesarit ishte një treg i përqendruar, në të cilin banka Raiffeisen (këtu e në vijim RB) shfaqet si operatori kryesor në këtë treg. Çmimi i bonove të thesarit në tregun primar ka pasur luhatje të ndjeshme në periudha të ndryshme kohe. Banka e Shqipërisë kishte evidentuar probleme të funksionimit të tregut primar të bonove të thesarit. Gjithashtu, u evidentua se banka Raiffeisen kishte një peshë të konsiderueshme në tregun sekondar të bonove të thesarit.
- 5) Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe nenit 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me Vendim Nr. 98, datë 18.12.2008 vendosi “Hapjen e hetimit të thelluar për abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Bankës Raiffeisen në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”
- 6) Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.98, datë 18.12.2008, “Për hapjen e hetimit të thelluar për abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Bankës Raiffeisen në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, me anë të Urdhrit Nr 114, datë 22.12.2008 “Për ngritjen e grupit të punës për realizimin e hetimit të thelluar në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit” dhe në mbështetje të neneve 28, germa “b” dhe 29, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe neneve 18 dhe 22 të rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, urdhëroi ngritjen e grupit të punës.
- 7) Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar në tregun e bonove të thesarit.
- 8) Në zbatim të nenit 39 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës ftoi në seancë dëgjimore bankën Raiffeisen për të paraqitur me shkrim pretendimet e saj në lidhje me konkluzionet e raportit të thelluar “Mbi abuzimin e mundshëm të bankës Raiffeisen me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”. Banka Raiffeisen paraqiti pretendimet e saj me shkrim me shkresën me nr 436/7prot, 15.01.2010 dhe 436/10 date 04.02.2010 dhe në mënyrë verbale në seancën dëgjimore të datës 18/01/2010
- 9) Gjithashtu një tryezë konsultative u organizua me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbykëqyrjes Financiare, në të cilën u paraqitën komentet e këtyre institucioneve.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJA NËN HETIM

- 10) Periudha e hetimit është periudha nga 2005 deri 2008, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 98 datë 18.12.2008 “Për hapjen e hetimit të thelluar për abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Bankës Raiffeisen në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”.
- 11) Ndërmarrja nën hetim sipas Vendimit Nr.98 të Komisionit të Konkurrencës, është përkatësisht: Raiffeisen Bank

III. TREGU PERKATES

- 12) Tregu përkatës përcaktohet në dy dimensionet:
 - a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik

III.1. Tregu përkatës i produktit

- 13) Tregu përkatës i produktit është tregu i bonove të thesarit (borxhi i brendshëm afatshkurtër deri në 1 vit) ndarë në:
 1. Tregu primar i bonove të thesarit, është tregu në të cilin kryhen rregullisht blerja dhe shitja e bonove të thesarit të emetuara rishtazi nga Republika e Shqipërisë ndërmjet bankave që i zotërojnë ato.
 2. Tregu sekondar i bonove të thesarit i cili ndahet në dy nën-tregje të tjerë:
 - a) tregu sekondar ndër-bankar që është tregu në të cilin kryhet rregullisht blerja dhe shitja e bonove të thesarit ndërmjet bankave që i zotërojnë ato,
 - b) tregu sekondar me pakicë që është tregu i organizuar në sportelet e bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara për kryerjen e transaksioneve me investitorët të cilët mund të jenë persona fizikë ose juridikë, rezident ose jo-rezident.

III.2. Tregu përkatës gjeografik

- 14) Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse bankat dhe institucionet financiare që marrin pjesë në tregun e bonove të thesarit janë prezente në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si treg gjeografik përcaktohet tregu i Republikës së Shqipërisë.

III.3. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës

- 15) Nga ana e kërkesës së bonove të thesarit janë bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare, subjektet tjerapivate ose publike dhe individët. Analiza e zëvendësueshmërisë merr në konsideratë edhe alternativat e tjera investuese të këtyre subjekteve.

III.4. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës

- 16) Një alternativë e zëvendësimit të këtij produkti në krahun e ofertës (ofrimi i B-Th nga Ministria e Financave, ose kërkuesi i likuiditeteve) janë obligacionet. Edhe

obligacionet janë tituj borxhi, pa risk, por me afat të gjatë maturimi më të gjatë se 1 vit (në Shqipëri 2, 5 ose 7 vjeçar). Pavarësisht se këto produkte kanë afate të ndryshme maturimi, mund ti konsiderojmë si zëvendësues të njëri tjetrit, sepse të dy shërbejnë për financimin e borxhit të qeverisë dhe janë pa risk.

IV. ZHVILLIMET NE TREGUN E BONOVE TE THESARIT

IV.1. Tregu primar

- 17) Banka Raiffeisen ka trashëguar nga procesi i privatizimit të ish Bankës së Kursimit, pozite dominuese në tregun e bonove të thesarit. Gjatë periudhës objekt hetimi konstatohet se ky treg ka qënë shumë dinamik në lidhje me pjesët e tregut të zotëruara nga operatorët e tij. Në mënyrë më të detajuar, dinamika e pjesëve të tregut përkatës, në sistemin bankar, së kësaj banke paraqitet në tabelën 1¹.

Tabela Nr.1: Pjesët e tregut të RB në tregun primar të bonove të thesarit


Vitet	2005	2006	2007	2008
Raiffeisen Bank				
Banka Kombëtare Tregtare				
Tirana Bank				
Intesa Sanpaolo Bank				
Banka Alpha				
Banka Procredit				
Banka Popullore				
Banka Credins				

- 18) Tregu primar ka barriera hyrje për shumën minimale të pjesëmarrjes për individët dhe zhvendosja e sportelit të shitjes së bonove në tregun primar nga Banka e Shqipërisë të bankat e nivelit të dytë që nga viti 2005 ka rritur barrierat e hyrjes dhe kostot e pjesëmarrjes në ankandet primare të bonove të thesarit për individët dhe bizneset e vogla. Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur në favor të depozitimit të fondeve për investime në tregun primar të bonove të thesarit në sportelin e Bankës së Shqipërisë si një mundësi për akses direkt në tregun primar të bonove të thesarit nga individët dhe SME-të.
- 19) Në këtë treg kemi të bëjmë me një shitës të vetëm që është Qeveria Shqiptare. Për të mbuluar nevojat e saj për likuiditet Qeveria emeton letra me vlerë. Borxhi i brendshëm i qeverisë mund të financohet nëpërmjet instrumentave të ndryshëm. Pësia specifike që zënë bonot e thesarit në financimin e borxhit të brendshëm është shumë herë më e madhe sesa pësia që kanë instrumentat e tjerë të financimit të borxhit. Pësia e bonove të thesarit është zvogëluar kurse pësia që zënë obligacionet në financimin e borxhit ka ardhur në rritje, sidomos pas vitit 2005.

¹ Burimi: Të dhëna të marra nga Banka e Shqipërisë (2005-2008)

- 20) Nga hetimi dhe seancat degjimore rezultojn se gjate periudhes nen hetim si rezultat i strategjise se Ministrise se Financave ka patur ndryshime ne strukturen e instrumentave te financimit te borxhit, nga ai afat shkurter ne ate afatgjate, duke rritur peshen specifike te emetimit te obligacioneve. Grafiku i mëposhtëm² paraqet përqindjen që zënë instrumentat e financimit të borxhit në vitet 2002 - 2008. Siç shihet obligacionet janë hedhur në treg duke filluar nga viti 2002 dhe deri në vitin 2004 kanë qenë vetëm për afatin e maturimit 2 vjeçar. Në vitin 2005 janë hedhur për herë të parë obligacione 3 vjeçare ndërsa obligacionet 5 vjeçare janë ofruar një vit më vonë, në 2006. Për herë të parë gjatë vitit 2007 qeveria emetoi obligacione 7 vjeçare.

Grafiku nr.1: Stoku i Borxhit të brendshëm sipas instrumentave



IV.2. Tregun sekondar

- 21) Bonot e thesarit tregtohen në tregun sekondar mes bankave (tregu ndërbankar) dhe mes bankave dhe poseduesve të bonove (tregu i pakicës). Në tregun sekondar të tregtimit të bonove me pakicë sipas të dhënave të AMF veprojnë 5 banka dhe ky treg nuk është shumë i zhvilluar.
- 22) Numri i degëve që ka RB, brenda vendit, është shumë më i madh krahasuar me bankat e tjera. Degët e saj shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe fuqia konkurruese e bankave të tjera është e vogël (krahasuar me numrin e degëve të RB) për vetë numrin e degëve që kanë këto banka. Në disa rrethe te vendit RB është banka (mundësia) e vetme për të investuar në tregun sekondar të bonove të thesarit për shkak se bankat e tjera ose nuk kanë degë ose nuk e ofrojnë shërbimin e tregtimit të bonove të thesarit për individët.
- 23) Karakteristikë tjetër e tregut primar dhe sekondar të bonove të thesarit është Asimetria në informacion. Informacioni i paraqitur nga bankat është jo i plotë dhe jo i qartë, duke kufizuar kështu mundësinë e zgjedhjes së klientit. Ky fakt është evidentuar nga vrojtimi në teren i realizuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës. Në përgjithësi, nga vëzhgimet tona në banka të ndryshme që ofrojnë tregtimin e bonove të thesarit në tregun sekondar, vihet re një mungesë e transparencës në informimin e

² Burimi: Ministria e Financave, Treguesit e borxhit dhe instrumentet financiar

klientëve për sa i përket bonove të thesarit. Gjithashtu vlen për tu theksuar mungesa e broshurave informuese në lidhje me bonot e thesarit, gjë që i mundëson klientëve njohjen më të mirë me këtë shërbim që ofrojnë bankat.

V. SJELLJA E BANKES RAIFFEISEN

- 24) Gjatë analizës së dinamikës së yieldid të bonove të thesarit, është konstatuar një rritje e dukshme e yieldid në tremujorin e tretë të vitit 2006, që ishte dhe shkaku i këtij hetimi.
- 25) Gjatë periudhës objekt hetimi konstatohet se pozicioni i Bankës Raiffeisen ka pësuar rënie jo vetëm të pjesëve të bakës në tregun e bonove të thesarit, por edhe pjesët e tregut të depozitave. Dinamika e pjesëve të tregut të depozitave të Bankës Raiffeisen, gjatë periudhës objekt hetimi paraqitet në tabelën Nr. 2³.

Tabela Nr 2: Pjesa e tregut të RB sipas depozitave

Viti	2005	2006	2007	2008
Depozita				

- 26) Nga analiza e evidencave mbi faktorët që kanë ndikuar sipas raportit të hetimit të thelluar dhe pretendimeve të palës e konsultimet me institucionet publike që janë faktorë dhe mbikëqyrës të tregut objekt hetimi konstatohet se:
- nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë dhe sistematike midis pjesëmarrjes ose jo të bankës dhe dinamikës së ndryshimit të yieldid në ankandet e zhvilluara gjatë periudhës objekt hetimi (gjatë periudhës në të cilën banka kishte fuqi të ndjeshme tregu).
 - Banka Raiffeisen ka argumentuar që mospjesëmarrja në ankandin, i cili është pasuar me rritjen e yieldid, ka ardhur si pasoje e uljes së depozitave, rritjes së kredisë dhe pjesëmarrjen në ankandet e obligacioneve me afat marturimi 2 vjeçar. Keto faktore kanë sjelle mungesë të likujditetit e cila nuk ka mundësuar pjesëmarrjen dhe/ose masen e pjesëmarrjes në tregun primar të bonove të thesarit.
 - Banka e Shqipërisë në “Raportin e politikës monetare të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2006” (fq. 27) ka argumentuar që rritja e huamarrjes të qeverisë dhe rritmet e larta të kreditimit në lekë kanë krijuar mungesën e likujditetit në sistem dhe janë reflektuar në rritjen e yeldeve të bonove të thesarit.
- 27) Komisionet e aplikuara nga Banka Raiffeisen për transferimin e fondeve nga llogaria e saj drejt Bankës së Shqipërisë janë të larta. Sipas të dhënave të AMF-së (për vitin 2008), Banka Raiffeisen aplikon një komision 1.2 % mbi fondin e individëve për pjesëmarrje në tregun primar të bonove të thesarit, ndërsa bankat e tjera aplikojnë një komision 0.2 % për të njëjtin shërbim
- 28) Për sa me sipër nuk provohet abuzimi i mundshëm i Bankës Raiffeisen në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit gjatë periudhës objekt hetimi.
- 29) Në tregun primar janë vënë re komisione të larta të paargumentuara nga pikepamja

³ Burimi: Te dhenat e bankës Raiffäisen dhe llogaritjet e Raportit të Hetimit të Thelluar

ekonomike. Banka Raiffeisen ka shprehur marrjen e disa angazhimeve, te cilat do te permiresojne nivelin e konkurrences dhe do te ulin kostot per konsumatoret.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 45, pika 2, të Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Mbylljen e hetimit të thelluar ndaj Raiffeisen Bank SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit
2. Vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj Raiffeisen Bank SHA mbi bazën e angazhimeve të shprehura nga banka në seancën dëgjimore:
 - I. Uljen e komisioneve që i tarifohen individëve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në tregun primar. Këto komisione duhet të ulen në masën 50%, për një periudhë 3 vjeçare, me qëllim që të nxitet dhe të rritet pjesëmarrja e individëve në tregun primar.
 - II. Korrigjimet për të përmirësuar dhënien e informacionit mbi BTH tek publiku si më poshtë:
 - a. RB do të hartojë ad hoc material mbi marketingun që do të ekspozohet dhe/ose shpërndahet në secilën prej degëve të saj.
 - b. Në çdo degë do të shfaqen në mënyrën e duhur tendencat e yield-it të BTH të përditësuara në kohë.
 - c. Informacioni rreth BTH do të jetë i publikuar në faqen e internetit të RB nëpërmjet një linku të identifikueshëm.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e palës dhe ndjekjen e angazhimeve të shprehura në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)

(_____)

(_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 143, Datë 15.03.2010

“Mbi disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.03.2010 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënia e rekomandimeve për institucionet qëndrore për rritjen e konkurrencës në tregun përkatës: tregu primar dhe sekondar të bonove të thesarit

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d dhe f, dhe neni 70 pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të grupit të punës “Mbi hetimin e thelluar nëse Banka Raiffeisen ka abuzuar ose jo me pozitën dominuese në tregun e letrave me vlerë”, relacionit të Sekretares së Përgjithshme dhe të komenteve të Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

VEREN SE:

I. Tregu i bonove të thesarit

Tregu i bonove të thesarit është një nga tregjet e rëndësishme të sektorit financiar për shkak të funksionit që kryen në plotësimin e kërkesave të qeverisë për mbulimin e borxhit të brendshëm afatshkurtër.

II. Procedurat e ndjekura

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2008 ka monitoruar tregun bankar në përgjithësi dhe tregun e bonove të thesarit në veçanti për të parë nëse konkurrenca në këtë treg ishte e kufizuar si pasojë e sjelljes së një apo disa aktorëve të tregut apo si pasojë e akteve ligjore/nënligjore që rregullonin këtë treg.

Në përfundim të monitorimit të kryer në tregun primar të bonove të thesarit nga Sektori i Studimit dhe Analizës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me anë të Vendimit Nr. 8, datë 15.07.2008 vendosi “Hapjen e hetimit paraprak në tregun primar të bonove të thesarit”.

Me Vendim Nr. 98, datë 18.12.2008 Komisioni i Konkurrencës vendosi “Hapjen e hetimit të thelluar për abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Bankës Raiffeisen në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”.

Para vendimmarrjes, Komisioni i Konkurrencës zhvilloi një seancë konsultative me datë 27.11.2009 me përfaqësuesit e institucioneve si Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes të cilët paraqiten komentet e tyre me shkrim dhe në formë verbale.

III. Tregu përkatës

III.1. Tregu përkatës i produktit

Tregu përkatës i produktit është tregu i bonove të thesarit (borxhi i brendshëm afatshkurtër deri në 1 vit) ndarë në:

1. Tregu primar i bonove të thesarit është tregu në të cilin bankat, institucionet financiare si dhe publiku mund të blejnë rregullisht instrumentet e borxhit afatshkurtër (bono thesari) të emetuara për herë të parë nga Ministria e Financave në emër të Republikës së Shqipërisë.
2. Tregu sekondar i bonove të thesarit i cili ndahet në dy nëntregje të tjerë:
 - a) **tregu sekondar ndërbankar** që është tregu në të cilin kryhet rregullisht blerja dhe shitja e bonove të thesarit ndërmjet bankave që i zotërojnë ato,
 - b) **tregu sekondar me pakicë** që është tregu i organizuar në sportelet fizike apo virtuale të bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara për kryerjen e transaksioneve me investitorët të cilët mund të jenë persona fizikë ose juridikë, rezident ose jorezidentë.

III.2. Tregu përkatës gjeografik

Bankat dhe institucionet financiare që marrin pjesë në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit operojnë në të gjithë territorin të Shqipërisë, për këtë arsye, si treg gjeografik është përcaktuar tregu i Republikës së Shqipërisë.

IV. ZHVILLIMET NE TREGUN E BONOVE TE THESARIT

IV.1. Pengesat ligjore dhe ekonomike për të hyrë në tregun e bonove te thesarit

Tregu primar

Në tregun primar të bonove të thesarit mund të marrë pjesë çdo person juridik ose fizik, vendas ose i huaj. Shuma minimale e lejuar për pjesëmarrje, që mund të konsiderohet si barrierë për hyrjen në treg, është 300 000 (treqind mijë) lekë.

Tregu sekondar

Për të qenë pjesë e tregut sekondar me pakicë bankat ose subjektet e tjera duhet të marrin një licencë nga AMF, e cila jo vetëm jep licenca për tregun sekondar me pakicë por edhe e mbikëqyr atë. Gjithashtu për të marrë licencën për tregun sekondar me pakicë bankat duhet të trajnojnë stafet që do të ofrojnë këtë produkt dhe duhet të mbajnë llogari ditore që raportohen në AMF, duke përbërë në këtë mënyrë kosto shtesë. Ndërsa përsa i përket individëve, ata mund të marrin pjesë në tregun sekondar me pakicë duke blerë ose shitur bono thesari mjafton që të kenë 10.000 lekë. Duhet që banka që shet bono në tregun sekondar me pakicë të pajisë blerësin me një vërtetim shpallje fitues për veprimet e tregut primar dhe me një vërtetim blerjeje për veprimet e shitjes nga portofoli i vetë.

IV.2. Konkurrenca potenciale

Tregu primar

Banka Raiffeisen është mbajtësi kryesor i borxhit të brendshëm të qeverisë që sipas të dhënave të Ministrisë së Financave mbulon mbi 30% të tij për periudhën 2005-2008. Banka e Shqipërisë që mban 22.98 % të portofolit nuk ndikon në çmimin e bonove të thesarit për shkak se oferta BSH është jokonkurrenuese bazuar në marrëveshjen me Ministrinë e Financave (yields i ofertës së tyre përcaktohet me yieldin mesatar të pranuar të ankandit pas shpalljes nga Ministria e Financave).

Konkurrent potencial për sa i përket shumave të ofruara dhe si pasojë edhe në nivelin e yieldit të pranuar të bonove të thesarit janë individët dhe bizneset që mund të marrin pjesë drejtpërdrejtë në ankandet e bonove të thesarit në sportelet e Bankës së Shqipërisë ose Postës Shqiptare¹. Për vitin 2008 individët zotërojnë 7.26 për qind të portofolit të bonove por kjo pjesë tregu do të ishte shumë më e lartë nëse Banka e Shqipërisë nuk do të mbyllte sportelin për investimin e drejtpërdrejtë nga individët në bono thesari.

Fondi Monetar Ndërkombëtar në periudhën kur këto sportele u mbyllën në Bankën e Shqipërisë dhe degët e saj, pikërisht në Gusht 2005 në Raportin për Shqipërinë me Nr. 05/267² thekson se duke vazhduar rekomandimet e FSAP, duhet të mbajmë “dritaren” për

¹ Posta Shqiptare ofron shërbimin e arkëtimit nga individë të fondeve për pjesëmarrje në ankandin e Bonove të Thesarit. Individët mund të marrin pjesë në blerjen e bonove të thesarit me paraqitjen e tyre në sportelet të Postës Shqiptare sh.a. Individët duhet të paraqiten me dokument identifikues si leter njoftim, pasaportë, certifikatë personale me fotografi, për të kryer veprimet që lidhen me bonot e thesarit.

² TP PT TU <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2005/cr05267.pdf>UT

shitjen e bonove të thesarit në Bankën e Shqipërisë si një mjet të aksesit të publikut në tregun primar të bonove të thesarit. Sipas FMN-së shuma minimale (300 000 lekë) për pjesëmarrje në ankandet primare të bonove të thesarit duhet të mbetet e njëjtë dhe mund të fillojë vendosja e një komisioni për hapjen e llogarisë.

Banka e Shqipërisë e ndryshoi politikën e saj të aksesit të individëve dhe bizneseve të vegjël që investonin në bono thesari duke i detyruar që të hapnin një llogari pranë saj (pra nuk i zhvendosi individët nga sportelet e Bankës Qendrore) ku mund të transferonin paratë e depozituara në një nga bankat e nivelit të dytë kundrejt komisioneve që variojnë nga 1/1000 e shumës (por jo më pak se 1000 lekë) deri në 3500 lekë. Duke i shtuar kësaj kosto dhe efektet negative të asimetrisë së informacionit për klientët në banka lidhur me shërbimin e investimit në bono thesari, konkludojmë se janë rritur barrierat për pjesëmarrësit në ankandet e tregut primar të bonove të thesarit dhe ka kufizuar konkurrencën ndaj bankave.

Tregun sekondar

Bonot e thesarit tregtohen në tregun sekondar midis bankave (tregu ndërbankar) dhe midis bankave dhe poseduesve të bonove (tregu i pakicës). Në tregun sekondar të tregtimit të bonove me pakicë sipas të dhënave të Autoriteti i Mbykëqyrjes Financiare veprojnë 5 banka dhe ky treg nuk është shumë i zhvilluar.

IV.3. Karakteristikat e tjera të tregut

Karakteristika të tjera të tregut primar dhe sekondar të bonove të thesarit janë:

Asimetria në Informacion. Klientët individë apo ndërmarrjet e vogla, nuk e kanë mundësinë për të siguruar informacion të gjerë për të bërë zgjedhjet e tyre. Kjo për faktin se në përgjithësi informacioni i paraqitur nga bankat është jo i plotë dhe jo i qartë, duke kufizuar kështu mundësinë e zgjedhjes së klientit.

Për të analizuar nivelin e transparencës së bankave për klientët në lidhje me tregtimin e bonove të thesarit realizuam një vrojtim (vrojtimi datë, 29. 02. 2008 në disa banka që ofrojnë bono thesari gjatë monitorimit të tregut bankar) në bankat e mëposhtme: RB, BE, BP, Credins, ABA, dhe BKT. Metoda e ndjekur ishte të sjellurit si konsumator i interesuar për të blerë BTH. Në shumicën e bankave të pyetura informacioni ishte shumë sipërfaqësor duke e konsideruar konsumatorin sikur të kishte vite që merrej me këtë treg. Në lidhje me dokumentacionin, komisionet dhe yieldin informacioni ishte me i qartë. Nga bankat e pyetura vetëm BKT ofronte informacion të shkruar me një përllogaritje të thjeshtë të fitimit nëse investoje në bono thesari dhe nuk i depozitoje paratë. Disa banka si BP dhe BE shërbenin vetëm si ndërmjetës në tregun e letrave me vlerë për llogari të BQ. Gjithashtu informacioni ndryshonte në degë të së njëjtës bankë në zona të ndryshme gjeografike.

Në përgjithësi, nga vëzhgimet tona në banka të ndryshme që ofrojnë tregtimin e bonove të thesarit në tregun sekondar, vihet re një mungesë e transparencës në informimin e klientëve për sa i përket bonove të thesarit. Gjithashtu vlen për tu theksuar mungesa e broshurave informuese në lidhje me bonot e thesarit, gjë që i mundëson klientëve njohjen më të mirë me këtë shërbim që ofrojnë bankat.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenit të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. T’i propozojë Bankës së Shqipërisë të rikthejë depozitimin “cash” në sportelet e saj në Tiranë dhe në 5 rrethet kryesore ku ajo ka degë për pjesëmarrjen në ankandet e tregut primar të bonove të thesarit si një mënyrë efikase për eliminimin e kostos së transaksionit të shumave të investuara për bono thesari nga bankat e nivelit të dytë drejt Bankës së Shqipërisë.
2. T’i propozojë Ministrisë së Financave rritjen e marketingut të produktit të bonove të thesarit për të rritur gamën e pjesëmarrësve në ankandet e tregut primar të biznesit, institucionet financiare dhe individëve kryesisht nëpërmjet:
 - Njoftimet publike të ankandëve të radhës (jo vetëm te TVSH dhe ATSH) por të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike. Përgatitja e fletëpalosjeve dhe broshurave të tjera informative për bizneset, klientët e bankave, shoqatat e konsumatorëve etj.
 - Marketing interaktiv nëpërmjet internetit dhe instrumentave të tjerë të komunikimit me publikun
 - Marketing ndërkombëtar për bonot e thesarit për rritjen e pjesëmarrjes në tregun primar të bonove të thesarit
3. T’i rekomandojë Bankës së Shqipërisë si autoritetit qëndror monetar marrjen e masave për reduktimin e asimetrisë së informacionit për klientët nga ana e bankave të nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë me anë të një akti nënligjor (rregullore/urdhër me fuqi detyruese për bankat e nivelit të dytë) të rregullojë problemin e asimetrisë së informacionit duke marrë masat si vijon:

- a) Bankat e nivelit të dytë në çdo degë apo agjenci të tyre duhet të japin të dhëna të plota, të sakta dhe të qarta për klientët për të gjitha produktet, kostot dhe interesat respektive që ofron (përfshirë dhe bonot e thesarit) duke sqaruar kryesisht përfitimet e klientëve dhe duke krahasuar mundësitë e investimit (depozita kundrejt bono thesari)
- b) Në faqet e internetit të bankave të nivelit të dytë të shfaqen në kohë reale të dhënat e ankandëve të radhës të bonove të thesarit dhe tendencat e përditësuara të yieldit të bonove të thesarit
- c) Bankat e nivelit të dytë duhet të informojnë klientët me instrumentat e parashikuar (email, telefon, faks) për ankandet e radhës të bonove të thesarit, shumat e kërkuara, afatet e depozitimit të parave për pjesëmarrje dhe të dhëna të tjera të kërkuara.
- d) Bankat e nivelit të dytë të kenë një seksion të veçantë për trajtimin e ankesave të klientëve në mënyrë të veçantë për asimetrinë e informacionit nga ana e nëpunësve të bankës;

- ç) Klientët që janë keqinformuar të përfitojnë të drejtën e dëmshpërblimit në rast të fitimit të munguar për shkak të asimetrisë së informacionit dhe/ose keqorientimit nga nënpunësit e bankës për pjesëmarrjen në tregun primar të bonove të thesarit;
4. T'i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare rritjen e mbikëqyrjes në tregun me pakicë dhe transparencën e tij

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për mbikëqyrjen e tregut sekondar me pakicë të letrave me vlerë të qeverisë, AMF të mbikëqyrë në mënyrë periodike tregun e bonove të thesarit duke përgatitur raportet e mbikëqyrjes së këtij tregu (ashtu siç vepron me tregun e sigurimeve dhe me tregun e sigurimeve të pensioneve vullnetare) dhe të informojë Autoritetin, mbi problematikën e hasur në funksionimin e këtij tregu si pasojë e ndonjë kufizimi të mundshëm të konkurrencës.

Të zhvillojë instrumentat e duhur për mbrojtjen konsumatore edhe për letrat me vlerë të qeverisë ashtu siç po vepron me mbrojtjen konsumatore për tregun e sigurimeve duke ngritur një njësi për trajtimin e ankesave të individëve që marrin pjesë në tregun e letrave me vlerë dhe mundësimin e dëmshpërblimit të dëmit konsumator të shkaktuar nga bankat e nivelit të dytë.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e vendimit Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 144, Datë 23.03.2010

Rekomandim për Entin Rregullator të Energjisë për liçencimin e dy shoqërive Cable Sistem” Sh.p.k dhe 400 KV” Sh.p.k.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.03.2010 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie rekomandimi për liçensimin e dy shoqërive “Cable Sistem” Sh.p.k dhe 400 KV” Sh.p.k, nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d dhe f, dhe neni 70.

VEREN SE:

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE), me shkresën Nr. 119 Prot. date 8 Mars 2010, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës mendimin lidhur me aplikimin për pajisjen me licence të dy shoqërive Cable Sistem” Sh.p.k dhe 400 KV” Sh.p.k.

Shoqëria tregtare “Energji” Sh.p.k, ka krijuar në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 18.04.2008 “Për tregtarin dhe shoqëritë tregtare” dy shoqëri të tjera përkatësisht:

- “Cable Sistem” Sh.p.k, tek e cila zotëron 90% të kuotave të kapitalit themeltar;
- “400 KV” Sh.p.k, tek e cila zotëron 99% te kuotave te kapitalit themeltar.

Të dyja këto shoqëri (“Cable Sistem” Sh.p.k dhe “ 400KV” Sh.p.k) kanë aplikuar pranë ERE-s për tu pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike sipas ligjit Nr. 9072, date 23.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe konform “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit te licencave”.

Aktualisht te dyja shoqëritë kanë marre nga ERE vendimin për fillimin e procedurave te shqyrtimit të aplikimit për liçencë dhe është në vazhdim procedura për liçensimin e tyre. ERE, pas publikimit ne median e shkruar, është ne pritje të ankesave nga palët e treta ne lidhje me këto aplikime.

Në tregun e energjisë elektrike aktualisht operojnë mbi 8 shoqëri për tregtimin e energjisë elektrike, të cilat kanë aktivitetet relativisht të reduktuar për shkak se janë operatorë të licensuar vitet e fundit në treg dhe për shkak se importet dhe eksportet e energjisë elektrike kryhen kryesisht nëpërmjet shoqërive të huaja.

Pajisja e dy shoqërive si më sipër me licensën e tregtimit do të bëjë që në treg të operojnë mbi 10 shoqëri. Ky fakt nuk e pengon apo cënon konkurrencën pasi shoqëria “Energy” apo dy shoqëritë që do të licensohen nuk kanë fuqi tregu me efekte për konkurrencën.

Gjithësesi, sjellja e dy shoqërive të reja në tregun e energjisë elektrike do të jetë objekt monitorimi i Autoritetit të Konkurrencës për shkak të zotërimit nga e njëjta shoqëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe f si dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë Elektrike të pajisë me liçensë për tregtimin e energjisë elektrike shoqëritë “Cable Sistem” Sh.p.k dhe “400KV” Sh.p.k.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e Entit Rregullator të Energjisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 145, Datë 15.04.2010

Per miratimin e Udhëzimit
“Per vlerësimin e Marrëveshjeve Vertikale”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.04.2010 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Udhëzimit “Për vlerësimin e Marrëveshjeve Vertikale” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, neni 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt Udhëzimit ”Për vlerësimin e Marrëveshjeve Vertikale”:

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzimin “Për vlerësimin e Marrëveshjeve Vertikale”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 146, Datë 17.06.2010

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.06.2010 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 26, dhe neni 45/2.

Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pasi shqyrtoi raportin e grupit të punës “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionin përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

KONSTATOI:

I. PROCEDURA E NDJEKUR:

1. Bazuar në informacionin e marr nga media mbi rritjen e çmimit të bukës në Qarkun e Korçës, Sekretari i Përgjithshëm, mbështetur në nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (këtu e si vijon Ligji), vendosi për hapjen e hetimit me anë të Vendimit Nr. 9, datë 18.05.2010 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës”, për të vërtetuar ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar në kuptim të Ligjit.

2. Në vazhdim të procedurës, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nga Sekretariati u kërkuan të dhëna dhe informacione nga: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, Bashkia Korçë, Kolonjë, Pogradec dhe Devoll.
3. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 218, datë 18.05.2010 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit kreu disa inspektime në ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun Korçë.
4. Më datë 31.05.2010 u organizua një seancë nga Komisioni i Konkurrencës me prodhuesit dhe tregtuesit e bukës në Qarkun e Korçës, në të cilën morën pjesë disa prej tyre. Organizimi i seancës u bë me qëllim identifikimin e faktorëve që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun përkatës objekt hetimi.
5. Gjatë seancës pjesëmarrësit deklaruan se pas inspektimeve dhe njohjes me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, kanë reaguar duke bere ulje te çmimeve, ne mënyre te pavarur nga njeri tjetri. Ato deklaruan se çmimi i këtij produkti në raport me peshën është më i ulët, i krahasuar me rrethet e tjera te Shqipërisë. Gjithashtu ato u angazhuan te marrin përsipër te veprojnë në respektim të rregullave të konkurrencës.
6. Në përfundim të hetimit Sekretariati hartoi dhe paraqiti pranë Komisionit të Konkurrencës raportin “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës”.

II. VLERESIMI I KONKURRENCËS NE TREG

II.1 Përcaktimi i tregut përkatës

7. Produktet që duhet të përfshihen në tregun përkatës dhe kufijtë gjeografikë të atij tregu, përcaktohen në varësi të hapësirës në të cilën klientët mund të zgjedhin shumë lehtë midis produkteve të zëvendësueshme, ose furnitorët mund ta kenë të lehtë furnizimin e këtyre produkteve alternative.

II.1.1 Tregu i produktit

8. Në baze të informacionit të ofruar nga ndërmarrjet që u inspektuan, në termin “buke” përfshihen një sërë produktesh nga buka masive (e bardhe, e zeze), buke thekre, e deri tek simite dhe franxholle, të cilat konsumatori i gjen si të zëvendësueshme. Megjithatë ky treg i produkteve të bukës mund të ndahet në:
 - Buka masive (që në shumë raste mund të jetë edhe bukë e prerë në fetë) e cila prodhohet në fabrikat e bukës dhe furrat e bukëpjekësve dhe tregtohet në mini-markete dhe pikat e tyre të shitjes me pakicë. Kjo lloj buke zë pjesën më të madhe të tregut (70-80% të tregut) pasi preferenca e shumicës së konsumatorëve është për këtë lloj buke.
 - Produktet e tjera (franxholle, simite, bukë thekre e për hamburger etj)

II.1.2 Tregu gjeografik

9. Tregu gjeografik shtrihet në qytetet e Korçës, Kolonjës dhe Bilishitit pasi prodhuesit e bukës masive e tregtojnë produktin e tyre në këto tre qytete të qarkut të Korçës.

III. SJELLJA E NDERMARRJEVE NE TREG

10. Mbulimi i nevojave sigurohet nga aktiviteti i rreth 43 ndërmarrjeve me objekt të aktivitetit të tyre prodhim dhe tregtim buke. Madhësia totale e tregut për vitin 2009 ka një xhiro rreth 82 milion lekë¹. Ndërmarrjet në tregun përkatës kanë një xhiro vjetore nga 2 - 17 milion leke. Shumica e ndërmarrjeve zëne 1-5% të Tregut Përkatës.
11. Gjatë inspektimeve të kryera ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës masive në Qarkun e Korçës u konstatua se disa operatorë, me vullnetin e tyre, kanë rritur çmimet për një periudhë kohore rreth 4 ditë, duke reaguar pas ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës, me ndryshimin e sjelljes në treg duke rivendosur konkurrencën.
12. Nga inspektimet dhe sipas deklarimeve të prodhuesve të bukës masive, që morën pjesë në seancë, u konstatua se nuk ekziston një shoqatë vetëm për bukëpjekësit.
13. Gjate inspektimeve ndërmarrjet u treguan shume bashkëpunuese me Autoritetin e Konkurrencës, për rivendosjen e konkurrencës në treg, gjë e cila u pasqyrua edhe në sjelljen e tyre pas inspektimeve të Autoritetit të Konkurrencës në Qarkun e Korçës.
14. Gjatë seancës së organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës, pjesëmarrësit deklaruan se janë angazhuar të veprojnë në menyre të pavarur në treg duke respektuar rregullat e konkurrencës së lirë dhe efektive në vijim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe 45 paragrafi 2, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës.
 2. Pranimin e angazhimeve të palëve për rivendosjen e konkurrencës në treg.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)

(_____)

(_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

¹ Burimi; Te dhenat e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Korçë

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.146, datë 17.06.2010 “Për Mbylljen e procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e Prodhimit dhe tregtimit të Bukës në Qarkun e Korcës”, kam mbajtur qëndrim kundër si lidhur me argumentat hipotetikë të pjesës arsyetuese të tij, ashtu dhe lidhur me piken 2 të dispozitivit të këtij vendimi, me arsyetimin e mëposhtëm :

I-Lidhur me Hetimin e këtij tregu jam shprehur për mbylljen e tij dhe kam pershendetur qëndrimin bashkëpunues të ndermarrjeve të ardhura në seancën konsultative me Autoritetin e Konkurrencës. Nderkohe gjatë gjithë mbledhjeve të Komisionit kam shprehur rezerva serioze për Raportin Hetimit Paraprak në Tregun e Prodhimit dhe tregtimit të Bukës në Qarkun e Korcës, kam shprehur vërejtjet e mia sidomos me çështjen e mosjelljes të provave dhe fakteve, për konkludimin se “grupimi i ndërmarrjeve të prodhimit dhe tregëtimit të produktit përkatës “bukë” kanë fiksuar çmimin e shitjes së produktit duke shkelur nenin 4, pika 1 gërma a) të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, pasaktësi të tjera të grupit të punës duke pretenduar “se ndërmarrjet në hetim kanë reaguar duke bërë ulje të çmimeve”, dhe për rrjedhojë jam kundër trajtes fillesatare pika 2 e dispozitivit sipas të cilit komisioni vendosi miratimin e materialit “Mbi Vleresimin Ligjor të Praktikës së Bashkërenduar të Rritjes dhe Fiksimit të Çmimit të Bukës në Qarkun e Korcës” të shndërruar në Piken 2 “Pranimin e Angazhimeve të Paleve për Rivendosijen e Konkurrencës në Treg” dhe “heshtjen” për mos vleresimin e raportit dhe veprimtarisë së grupit të Punës dhe Sekretariatit për këtë hetim

Përsa i përket raportit, si dhe paraqitjes skematike që ju bë atij nga grupi i Punës në mbledhjen e Komisionit të datës 14.06.2010, u evidentua se grupi i punës, përmes raportit nuk ka qenë në gjendje t’i japë përgjigje shqetësimit të Komisionerëve dhe kryesisht shqetësimit tim në lidhje me problematikën e këtij tregu, përfshirë informalitetin e tij. Shqetësues është krijimi i precedentit se pa prova dhe fakte, pretendohet për një marrëveshje të ndaluar, duke i shndërruar grupet e punës dhe veprimtarinë e Sekretariatit të Konkurrencës në një trupe sa jo eficientë aq dhe subjektive. Këto qëndrime për fat të keq nga qëndrime të rastit janë duke u bërë një dukuri e vazhdueshme. Ky shqetësim i imi nuk është parë i arsyeshëm të merret në konsideratë nga anëtarët e tjerë të komisionit, edhe kur menaxhues të Sekretariatit kalojnë në fyerje, duke eliminuar dhe dokumentacionin përkatës që duhej të pasqyronte dhe zbardhte atë.

Kur them për shndërrimin e Sekretariatit në një trupe jo eficientë dhe aq subjektive, mbështetem:

a) Në faktin se grupet e punës i shmangen pasqyrimin transparent të veprimtarisë së tyre, duke u paraqitur vetëm në bllok, pa lënë gjurmë në qëndrimin individual të secilit anëtar të grupit hetimor. b) Në vend të bëhet një diagnozë objektive e tregut, duke zbuluar difektet reale të tij, në Raport por dhe qëndrimin përfundimtar insistohet në “marrëveshja e ndaluar” në kuptimin e nenit 4 –te Ligjit Nr ,9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” -Marrëveshje të Ndaluar, pa sjellë prova dhe fakte ose pa interpretuar në mënyrë objektive të dhënat që gjenden në dosjen hetimore.

Mjafton të kujtoj se tregu i bukës në Qarkun e Korcës nga vete natyra e tij dhe numri i subjekteve që marrin pjesë është një treg që i përket strukturës së tregut me konkurrencë të plotë, dhe nga ndërmarrjet e marra nën hetim, vetëm 2 ndërmarrje kishin për vitin 2009 një xhiro zyrtare mbi 8 Milion lekë, ndërsa gjithë të tjerrat me pak se 5 milion lekë xhiro. Ndër këto 2 ndërmarrje njëra përjashtohet nga hetimi nga grupi i punës ndërkohe

qe ndërrmarrja tjetër kishte një fitim zyrtar më të vogël se paga vjetore neto e çdo komisioneri apo e drejtuesve kryesorë të Sekretariatit të Autoritetit. Ky është “atakimi” i monopoleve, oligopoleve apo ndërmarrjeve me fuqi tregu që sjellin pengimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, nga ana e grupit të punës dhe Sekretariatit c) pretendohet për “marrëveshje të ndaluar” pa dhënë listën konkrete të ndërmarrjeve që kanë bërë marrëveshjen dhe ato që nuk janë të përfshira në marrëveshje.

Së dyti, në Raportin e Grupit të Punës aludohet për ekzistencën e disa evidencave, sipas të cilave evidentohet një sjellje e bashkrenduar nga disa ofruesit e mallit të këtij tregu. Në Raportin e Grupit të Punës nuk është evidentuar asnjë evidencë e tillë si provë dhe për më tepër asnjë element që con në krijimin e bindjes se kemi të bëjmë me një marrëveshje të shfaqur në formën e praktikës së bashkrenduar dhe me sjellje që ka cuar drejt fiksimit të cmimit si rezultat i kësaj praktike. Nga studimi i Raportit të grupit të punës, nga studimi i dosjes hetimore, une u binda për difekte serioze të praktikave të konkurrencës së pandershme dhe informalitetit në këtë treg, por nuk gjeta evidenca dhe prova që vertetëjnë një praktikë të bashkrenduar-marrëveshje të ndaluar që bie ndesh me nenin 4 të Ligjit pika 1 gërma a) të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”,

Nese koleget janë të bindur për evidencat dhe provat e Grupit të Punës për marrëveshje të ndaluar, në përputhje me kërkesat e nenit 45 të Ligjit nr 9121 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” Komisioni duhet të shprehë në këtë vendim për ndalimin e kësaj marrëveshje të ndaluar. Është tautologji që në vend të shprehjes së qarte ndaj një marrëveshje të ndaluar të shprehësh thjesht vetëm për “pranimin e angazhimeve të paleve për rivendosjen e konkurrencës në treg” duke luajtur me interpretimin e paragrafit 1 dhe 2 të Nenit 45 Vendimet e Komisionit të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” .

Në paragrafin e parë, në pjesën konstatuese të Vendimit të Komisionit, shkruhet se “Madhesia totale e tregut për vitin 2009 ka një xhiro rreth 82 milion Lek. Në variantin e parë të Raportit të Grupit të punës flitet për një xhiro rreth 68 milion leke. Nisur nga ky fakt me një përlllogaritje të thjeshtë më rezulton se paskemi të bëjmë me një popullsi të këtij tregu gjeografik objekt-hetimi prej rreth 13.000 banoresh ose 15 000, që është tejet e pasaktë po të kemi parasysh se behet fjale për qytetin e Korçës, Maliqit dhe në një pjesë rurale si Pojan, Zvezde, Bulgarec, Pirc, Libonik. Sa më sipër arrijmë në konkluzionin se jemi para rastit të një tregu me informalitet të theksuar, të një tregu ku ushtrohet një Konkurrence e Pandershme (Unfair Competition), por që eliminimi i së cilës kërkon që Komisioni i Konkurrencës të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, apo drejtorinë rajonale të saj, bashkë dhe komunat përkatëse ku ushtrojnë veprimtarinë këto firma.

Në këtë kuadër e gjej me vend të theksoj se bazuar në dosjen hetimore grupi i punës nuk ka pasqyruar në Raport në trajtë shteruese të gjithë informacionin e ndodhur në të. Mbeshtetur edhe në Dosjen hetimore, seancën konsultative me disa nga ndërmarrjet në hetim qëndrimi im është se ngritja e cmimit të bukës masive në qytetin e Korçës dhe fshatra rreth tij, ka ardhur si rezultat i disa faktorëve që nuk janë unike dhe me shkallë të njejtë si për të gjithë ndërmarrjet që i janë nënshtruar hetimit por edhe për grupimin ku ka hasur rritje të cmimit. Ndermarrjet në hetim qoftë ato që kanë rritur cmimin kanë dallime jo të vogla si përsa i përket madhësisë, teknologjisë, strukturës së kostos, për rrjedhojë faktorët dhe masa e tyre që kanë përcaktuar ndryshimin e kostos dhe të cmimit është e ndryshme. Në varesi të këtyre kushteve, peshës së bukës, për disa ka pasur ndikim prioritar rritja e cmimit të energjisë elektrike, karburantit, për disa të tjera rritja e cmimit

te gazit te lenget nga 67 lek per kg ne Nentor 2009, ne 93 lek per kg ne Mars-Prill 2010, kalimi nga biznes i vogel pa TVSH ne biznes qe paguan TVSH, masave shtrënguese të administratës tatimore të këtij qarku për ta futur edhe këtë treg në hullinë e formalitetit dhe të kanaleve të kontrolluara nga shteti (pagimin e sigurimeve shoqerore)që shoqërohet (sipas praktikave ekonomike të sintetizuara edhe në teori) me një ngritje të çmimi, e cila nuk është gjë tjetër vecse një kosto normale që shoqëron formalizimin e tregjeve me dukuri të theksuara informaliteti. Nje ndikim ne rritjen e cmimit te bukes ne Rrethin e Korces pati deklarata e emer te shoqates te bukes ne rrethin e Korces ne daten 17 Maj. Perverc gazetave te dites se neserme, nga grupi hetimor nuk jane siguruar, evidenca prova dhe fakte se kush e ka bere kete deklarate per te mbajtur nje qendrim ndaj deklarates abuzive ne emer te shoqates se bukes. Qendrimi i Komisionit te Konkurrences ndaj kesaj deklarate ne emer te shoqates se bukes ne Korçë eshte jo vetem i nevojshëm por edhe i domosdoshëm.

Së treti, do te desha te nenvizoja dhe pasaktesi te tilla si ato në përcaktimin e Tregut Gjeografik ku përcaktohet se hetimi shtrihet në qarkun e Korçës. Kur jepet struktura e tregut te ndermarrjeve të prodhimit dhe tregëtimit te Bukës qarkun e Korçes listohen vetem ndermarrje qe operojne ne bashkine e Korçës, Maliqit dhe disa komuna rreth tyre.

Sa më sipër nuk jam dakord me mos vleresimin tërësor te evidencave ne dosjen hetimor, në argumentet e pjesës konstatuese të vendimit, me eliminimin e vleresimit te Raportit dhe procedurave perkate te grupit te punes hartuar nga shumica. Në këtë mënyrë jap miratimin tim për piken e dispozitivit të këtij vendimi, e cila lidhet me Mbylljen e Hetimit Paraprak në Tregun e Prodhimit dhe tregëtimit të Bukës në Qarkun e Korçës, për shkak të paprovueshmërisë nga ana e raportit e shkeljeve dhe/ose kufizimeve të konkurrencës që janë objekte të Ligjit 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Nuk pranoj piken 2 te dispozitivit “ Pranimin e angazhimeve te paleve per rivendosjen e konkurrencës ne treg” dhe pretendimin e grupit te punes se kane ndryshuar cmimet ne kete teritor per rivendosje te konkurrences ne treg. Nga hetimi i pjesshem rezulton se çmimet jane ato te diteve te hetimit nga Grupi Hetimor i Autoritetit te Konkurrences, dhe zhvillimeve te fundit ne tregun e miellit gjate muajit aktual.

Prandaj çmoj që për përmbajtjen e vendimit jap votën kundër.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Koço BROKA

(_____)

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 147, Datë 23.06.2010

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.06.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1- Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 42, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me anë të Vendimit Nr. 1, datë 17.02.2010, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm, për të parë nëse ka elementë të kufizimit të konkurrencës

- 2- Në bazë të nenit 35 dhe 36, të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 85, datë 17.02.2010 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i punës gjatë periudhës së hetimit ka kryer inspektime në ndërmarrjet: “ROMANO PORT” SH.A, “PIA” SHA, “KALAJA” SH.A dhe “INTER GAZ” SH.A.
- 3- Hapësirat për ndërtimin e depozitave bregdetare të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, janë përcaktuar në zonën bregdetare të Porto – Romanos në Durrës dhe në zonën e Gjirit të Vlorës, me anë të Marrëveshjeve Koncesionare, përkatësisht nëpërmjet ligjit Nr.9298, datë 28.10.2004, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, i ndryshuar dhe ligjit Nr.9231, datë 13.05.2004, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Koncesionit të formës “BOO” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës”, si dhe për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në Gjirin e Vlorës”.

II. TREGU PËRKATËS

II.1. Tregu i Produktit/Shërbimit

- 4- Tregu përkatës është ngarkim - shkarkimi dhe depozitimi i gazit të lëngshëm(GLN) të importuar në rrugë detare respektivisht nëpërmjet portit “Vlora 1” dhe portit “Romano Port”. Procesi i ngarkimit dhe shkarkimit nuk mund të realizohet pa procesin e depozitimit të produktit në depozitat e lidhura me impiantin e ngarkim-shkarkimit. Të dy portet e mësipërme funksionojnë në bazë të marrëveshjeve koncesionare. Në portin “Vlora 1”, ofrimi i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GNL, bëhet nga ndërmarrja e cila ka marrë me koncesion portin “Vlora-1”, “PIA” SHA, e cila është e detyruar t’ua ofrojë këtë shërbim në bazë të tarifave përkatëse, duke i trajtuar operatorët në kushte të barabarta. Kjo pasi sipas nenit 3 të ligjit Nr. 9231 Dt. 13.5.2004 theksohet se terminali është ...”i hapur për të gjithë operatorët e kualifikuar...”. Gjithashtu neni 5 i këtij ligji thekson se koncesionari është i detyruar që të kryejë shërbimet e ngarkim-shkarkimit të produkteve të naftës dhe gazit të lëngshëm “...për çdo operator të licencuar kombëtar ose ndërkombëtar të interesuar ...”.
- 5- Shërbimi i ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit në zonën e Porto Romanos kryhet në dy segmente, të ndarë, por në funksion të njëri tjetrit:
 - tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit të ofruar nga infrastruktura portuale e Portit ‘Porto Romano’,
 - tregu i shërbimit të depozitimit, i lidhur me impiantin e ngarkim-shkarkimit, i cili mund të ofrohet nga ndërmarrje të cilat kanë ndërtuar depozita në këtë zonë apo duke i marrë me qera.

Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës

- 6- Në vitin 2009 pjesa dërrmuese e importit (99%), është realizuar në rrugë detare duke përdorur për shkarkim portin “Vlora-1” dhe portin “Porto Romano”, ndërsa për

periudhën janar-maj 2010, importi në rrugë detare ka zënë 88.27% të tregut ndërsa për periudhën janar-maj 2010 importi në rrugë të tjera ka zënë 11.73% të tregut dhe përbëhet kryesisht nga importi në rrugë hekurudhore. Ngarkim-shkarkimi dhe depozitimi i gazit të lëngshëm nëpërmjet rrugëve të tjera (tokësore, hekurudhore) vlerësohet një shërbim jo i zëvendësueshëm për shkak të kostove të larta dhe teknologjisë së ndryshme të përdorur, e cila paraqet kufizime esenciale.

II.2. Tregu gjeografik

- 7- Tregu gjeografik përfshin territorin e portit “Vlora-1” në ish-uzinën e PVC në gjirin e Vlorës, si dhe territorin e portit “ROMANO PORT” në zonën e Porto Romanos, Durrës.
- 8- Si konkluzion tregu përkatës i produktit, është tregu i shërbimit të ngarkimit – shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare në zonën gjeografike të Gjirit të Vlorës dhe Porto Romanos.

III. VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE

- 9- Në bazë të pikës 5, të nenit 3, të Ligjit Nr. 9121, datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pozitë dominuese është ajo pozitë e një ose më shumë ndërmarrjeve që i bën ato të jenë të afta të veprojnë, përta i takon ofertës ose kërkesës” në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
- 10- Bazuar në vlerësimin e pozitës dominuese sipas nenit 8, të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe referuar pjesëve në tregun përkatës dhe barrierave që ekzistojnë në treg (ligjore dhe ekonomike), rezulton se:
 - Ndërmarrja “PIA” Sh.a ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm;
 - Ndërmarrja “ROMANO PORT” SHA ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm;
 - Ndërmarrja “Inter Gaz” SHA, ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”.

III. SHENJAT E KUFIZIMIT TE KONKURRENCËS

III.1. Lidhur me portin “Vlora-1”

- 11- Nga ispektimet e kryera në këtë port janë të ndërtuara dhe janë në funksionim dy depozita GLN me kapacitet 4 800 m³ që së bashku me rrjetin e tubacioneve formojnë sistemin e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së, përbëjnë një “lehtësi esenciale” (essential facility), për ushtrimin e kësaj veprimtarie, pasi:
- 12- Të dyja këto depozita sferike i janë dhënë me qira kompanisë “KALAJA” SHA në bazë të kontratës “Për shërbimin e depozitimit dhe trajtimit të produkteve të lëngshme”, të lidhur midis ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA dhe ndërmarrjes “KALAJA” SHA, si dhe Shtojca nr.1, datë 23.06.2009 dhe Lidhja “A”, datë 29.08.2008, bashkëngjitur saj.

- 13- NËpërmjet kësaj marrëveshje, ndërmarrja “KALAJA” SHA është e vetmja ndërmarrje e cila ka të drejtën të shkarkojë dhe të depozitojë produktet e saj në depozitat në pronësi të “PIA” SHA.
- 14- Kjo sjellje e shoqërisë PIA ka kufizuar konkurrencën në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në Gjirin e Vlorës, duke krijuar rreziqet e abuzimit me pozitën dominuese nëpërmjet vendosjes së kufizimeve për hyrjen në tregun përkatës, duke rrezikuar nxjerrjen nga tregu të disa importuesve.
- 15- Gjithashtu ndërmarrja PIA ka kërkuar lidhjen e kontratave me kushte që palët kontraktuese të pranojnë detyrime shtesë siç është përshembull kërkesa për një garanci financiare prej 4 milionë euro, që mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Ndërkohë që PIA sh.a e ka marrë me koncesion ndërtimin, zhvillimin dhe operimin e portit “Vlora 1” dhe në bazë të Marrëveshjes Koncesionare dhe nenit 5 të Marrëveshjes Koncesionare, PIA ka detyrimin e ofrimit të shërbimit për të gjithë operatorët që importojnë gazin e lëngshëm.
- 16- Si përfundim nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes PIA sha në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN, kjo ndërmarrje, bazuar në nenin 9, pika 2, të ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të ketë abuzuar me pozitën e saj dominuese në këtë treg, me anë të kushteve të vendosura për ofrimin e shërbimit.

III.2. Lidhur me portin “PORTO ROMANO”

- 17- Ky port i është marrë me koncesion nga ndërmarrja “Romano Port” sh.a, me anë të Ligjit nr.9298, datë 28.10.2004, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, në funksion të depozitave bregdetare të ndërtuara në zonën bregdetare të Porto Romanos nga ndërmarrjet importuese të GLN.
- 18- Ndërmarrja “ROMANO PORT” sh.a tarifat e shërbimeve që ofron i ka të përcaktuara nga OSHA, gjithashtu kjo ndërmarrje ju ofron shërbim të gjithë operatorëve importues të GLN të cilët kanë mundësi depozitimi pranë këtij porti.
- 19- Ndërmarrja “ROMANO PORT” sha është e integruar vertikalisht me ndërmarrjen INTERGAZ SHA e cila ka edhe të vetmet depozita për shkarkimin e GLN-së në zonën e Porto Romanos. Duke pasur një kapacitet prej 10 000 m³ kjo ndërmarrje gjatë periudhës qershor 2009 - maj 2010 ka dhënë me qira kapacitetin e saj depozitues për ndërmarrjet e GLN-së që operojnë në këtë treg. Kontratat e qirasë të lidhura nga kjo ndërmarrje që zotëron të vetmet kapacitete depozituese të GLN-së që janë edhe e vetmja lehtësi esenciale në këtë port, vlerësohet se mund të paraqesin kufizime të konkurrencës për kushtet që ato vendosin për palët e treta.

Si konkluzion:

- 20- Bazuar në vlerësimin e pozitës dominuese sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe referuar pjesëve në tregun përkatës dhe barrierave që ekzistojnë në treg (ligjore dhe ekonomike), rezulton se:

- Ndërmarrja “PIA” sh.a ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm
 - Ndërmarrja Romano Port sh.a ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm,
 - Ndërmarrja “Inter Gaz” sh.a, ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të depozitimit të gazit të lëngshëm ne portin “Porto Romano”.
- 21- Nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve (1)PIA sha në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN,(2) “Romano Port” sh.a në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm dhe (3) “Inter Gaz” sh.a në tregun e shërbimit të depozitimit të gazit të lëngshëm, bazuar në nenin 9, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të kenë abuzuar me pozitën e tyre dominuese në tregjet përkatëse me anë të kushteve të vendosura për ofrimin e shërbimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, te Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit te Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “VLORA-1” dhe portin “PORTO ROMANO” ndaj ndërmarrjeve: “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA; “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA, me objekt ekzistencën ose jo te abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës
 - II. Hetimi i Thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01.06.2009 deri në 31.05.2010.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim;
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)

(_____)

(_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.147, datë 23.06.2010 “Për hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Shërbimit të Ngarkim –Shkarkimit dhe Depozitimit të Gazit të Lëngshëm”, kam mbajtur qëndrim kundra si lidhur me argumentet hipotetike të pjesës arsyetuese të tij, ashtu dhe lidhur me pikën (I) të dispozitivit të këtij vendimi, me arsyetimin e mëposhtëm :

- I- Lidhur me Hetimin e Thelluar të këtij tregu “ Përsa i përket pikës (II) dhe (III) të dispozitivit, ndaj të njëjtin mendim me shumicën e Komisionit”, pra jam për hapjen e hetimit të thelluar, duke kërkuar në të njëjtën kohë kryerjen sa më të shpejtë të tij, që të mos lejohet agravimi i mëtejshëm i pasojave negative për operatorët e dëmtuar në këtë treg, nga praktikatat e mundshme antikonkurrese.”

Duke patur parasysh se:

- Raporti “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit dhe depozitimin e gazit të lëngshëm” është i javës së parë të Marsit 2010; si dhe
 - Vendimi Nr.140, date 10.03.2010 i Komisionit të Konkurrencës “Për tregun e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm” dhe sidomos Pika 1 e dispozitivit: “Marrjen e masave të përkohshme si vijon: “1.1 Detyrimin e menjëhershëm dhe jo më vonë se 5 ditë nga njoftimi i vendimit të ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SH.A, për të mundësuar ankorimin, shkarkimin, trajtimin dhe depozitimin e GLN-së, për çdo operator të licencuar kombëtar ose ndërkombëtar të interesuar të operojë në këtë terminal”, nuk ka gjetur ende zbatim, mbështes propozimin e Grupit të Punës për “Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjes ”LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” Sh.A, me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës të Shërbimit të Ngarkim Shkarkimit dhe Depozitimit të Gazit të Lëngshëm”.
- II- Nuk jam dakord me pikën (I) të dispozitivit të këtij vendimi: “Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në tregun e Shërbimit të Ngarkim Shkarkimit dhe Depozitimit të Gazit të Lëngshëm në Portin “Vlora -1” dhe Portin “Porto Romano“ ndaj ndërmarrjeve, “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA; “Romano Port” SHA dhe “INTER GAZ” SHA, me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit dhe pozitën dominuese në tregun përkatës, pasi:
- Shtimi i 2 (dy) subjekteve nën hetim, i pa kërkuar nga grupi i punës, rrezikon të sjellë vonesa të panevojshme gjatë periudhës së hetimit të thelluar. Ndërkohë Objekti i “Hetimit të Thelluar në tregun e Shërbimit të Ngarkim Shkarkimit dhe Depozitimit të Gazit të Lëngshëm”, mbështetur në hapësirat që lejon Ligji Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës“ në tërësi, kërkesat e nenit 33 dhe 35 të tij në veçanti, nuk kanë krijuar (dhe nuk krijojnë) asnjë pengesë për të siguruar informacion mbi praktikat e tjera të mundshme antikonkurrese në këtë treg, apo në tregun e gazit të lëngët që është zhndruar në duopol, kur kjo kërkohej nga Grupi i Punës.
 - Ndërkohë, referuar Raportit të Grupit të Punës, nga shqyrtimi i kushteve të vendosura nga ndërmarrja “PIA” SHA, për ofrimin e shërbimit rezulton:

- Nga të dhënat e sjella nga ndërmarrja “PIA” SHA dhe ndërmarrjet e tjera importuese të GLN, për ofrimin e shërbimit të ngarkim shkarkimit dhe depozitimit ndërmarrja “PIA” SHA ka zhvilluar negociata me operatorët importues me rrugë detare të GLN duke bërë dhe ofertat përkatëse.
- Nga Shqyrtimi i ofertave konstatohet që ndërmarrja “PIA” SHA u ka ofruar ndërmarrjeve të importit të GLN kapacitetet e saj depozituese, por pavarësisht pjesës që zënë këto ndërmarrje në tregun e importit të GLN, pagesa vjetore për ndërmarrjen “PIA” SHA është e njëjtë, pasi kjo ndërmarrje cakton si qarkullim minimal vjetor sasinë prej 30 000 t/GLN në vit¹. Nga analiza e të dhënave të importit të gazit të lëngët rezulton se asnjë operator importues nuk e ka patur këtë volum importi për vitin 2008, ndërsa për vitin 2009 del se e vetmja ndërmarrje që plotëson këtë sasi qarkullimi të GLN të importuar është ndërmarrja “Kalaja” SHA, e cila plotëson këtë sasi qarkullimi të GLN-së.
- Në këto kushte , sasia prej 30 000 GLN në vit kthehet në një nivel dysheme për të cilën të gjitha ndërmarrjet e tjera duhet të paguajnë pavarësisht në se e realizojnë apo jo këtë qarkullim të këtij produkti.
- Ky kusht është shoqëruar në vitin 2010 me ndryshime drastike në strukturën tregun e gazit të lëngshëm, duke e zhndruar nga njëra anë atë në treg duopol, ndërsa nga ana tjetër është duke u ulur ndjeshëm pesha specifike e ndërmarrjeve që kanë operuar në këtë treg, duke u rrezikuar të dalin fare nga tregu.

Prandaj çmuj që për përmbajtjen e pikës (I) të dispozitivit të vendimit të jap votën kundër.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

¹ Shih Raportin e Grupit të Punës faqe 40



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 148, Datë 24.06.2010

“Për përcaktimi i hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm të naftës.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.06.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përcaktimi i hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm të naftës

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të Vendimit _____, datë _____, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

V E N D O S I:

- I. Përcaktimin e fazave të kryerjes së hetimit të thelluar si më poshtë vijon:
- a) Inspektime në ndërmarrjet nën hetim;
 - b) Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - c) Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;

- ç) Hartimi i Raportit të Ndërmjetëm brenda datës 01.07.2010;
 - d) Diskutim i Raportit të Ndërmjetëm me Komisionin;
 - dh) Hartimi i Raportit Përfundimtar të Hetimit të Thelluar dhe paraqitja e tij përpara Komisionit.
- II. Sekretari i Përgjithshëm të miratojë matricën e veprimeve të hetimit të thelluar sipas hapave të përcaktuar më sipër në këtë vendim.
- III. Afati i fundit për kryerjen e këtij hetimi është data 01.07.2010.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 149, Datë 24.06.2010

“Për kërkim të dhënash nga Shoqëria “ARMO” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.06.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Kërkim i të dhënave nga ndërmarrja “ARMO” SHA.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 33 “Detyrimi për të njoftuar” paragrafi 1 dhe 2 neni 83 i Kodit të Procedurës Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të pretendimeve të ndërmarrjes “ARMO” SHA të parashtruara në seancën dëgjimore të datës 02 Qershor 2010 me shkrim me Nr. 312 Prot datë 27. 05. 2010 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 201/1 datë 27. 05.2010), si dhe sqarimeve të sjella pranë Autoritetit të Konkurrencës me anë të shkresës Nr. 341 Prot datë 08. 06. 2010, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 201/2 datë 09. 06. 2010,

V Ë R E N S E:

- Me Vendimin Nr. 129 datë 19.11.2009 Komisioni i Konkurrencës ka vendosur për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “ARMO” SHA me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës të produktit lëndë djegëse Diesel D2.
- Në zbatim të procedurave hetimore Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, ka kryer hetimin dhe ka paraqitur Raportin përkatës pranë Komisionit të Konkurrencës.
- Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës ftoi ndërmarrjen “ARMO” SHA për të paraqitur pretendimet e saj me shkrim si dhe të merrte pjesë në seancën dëgjimore të datës 02 Qershor 2010.
- Ndërmarrja “ARMO” SHA paraqiti pretendimet e saj me shkrim me anë të shkresës Nr.

- 312 Prot. datë 27.05.2010 protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 201/1 Prot datë 27.05.2010, si dhe mori pjesë në seancën dëgjimore të datës 02 Qershor 2010.
- Gjatë seancës dëgjimore, Komisioni i Konkurrencës i parashtrori disa pyetje ndërmarrjes “ARMO” SHA, e cila pasi u njoh me to, parashtrori se i duhej kohë për t’iu përgjigjur, dhe se përgjigjet do t’i paraqiste me shkrim.
 - Ndërmarrja “ARMO” SHA paraqiti sqarimet me shkrim ndaj pyetjeve që iu bënë nga Komisioni I Konkurrencës në seancë dëgjimore, me atë të shkresës Nr.341 datë 08. 06. 2010 protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 201/2 datë 09. 06. 2010.
 - Nga përgjigjet e depozituara me shkresën Nr. 341 Prot. datë 08. 06. 2010 (protokolluar pranë Autoritetit me Nr. 201/2 Prot. datë 09.06.2010) Komisioni i Konkurrencës konstaton se ndërmarrja “ARMO” SHA nuk i ka dhënë përgjigje pyetjes se si ka qenë struktura e shpërndarjes nga ana e saj e lëndës djegëse Diesel D2 gjatë viteve 2007, 2008 dhe deri në muajin shtator 2009.
 - Dhënia e informacionit të plotë në përgjigje të kësaj pyetje nga ana e “ARMO SHA” do të ndihmojë në marrjen e një vendimi sa më objektiv nga ana e Komisionit të Konkurrencës.
 - Në bazë të nenit 73 të Ligjit, Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 % të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse japin të dhëna jo të sakta, jo të plota ose mashtruese në përgjigje të kërkesës ose vendimit të bërë, sipas nenit 33 pikat 1 dhe 2 të këtij Ligji, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e marrë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d) dhe nenit 33, paragrafi 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

1. T’i kërkojë ndërmarrjes “ARMO” SHA, që brenda datës 02.07.2010, ora 14.00 t’i vërë në dispozicion Komisionit të Konkurrencës strukturën e shpërndarjes së lëndës djegëse Diesel D2 gjatë viteve 2007, 2008 dhe deri në muajin shtator 2009.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

()

()

()

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 150, Datë 20.07.2010

“Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “ARMO” SHA në tregun e prodhimit të produktit lëndë djegëse diesel D2”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2010, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Ekzistenca ose jo e abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë ARMO SHA në tregun e prodhimit dhe të tregtimit me shumicë dhe pakicë të produktit lëndë djegëse diesel (D2).
- Baza ligjore:** - Neni 24, germa (d) dhe Neni 8, Neni 9, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”; (këtu e më poshtë Ligji)
 - Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”
 - “Kodi i Procedurave Administrative”,
- Pala në hetim:** Ndërmarrja ARMO SHA me nr. regjistri tregtar J82916498D dhe Adresë Rr. Qemal Stafa, Kompleksi “Xhura”, Tiranë.
- Periodha e hetimit:** Periodha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 129 datë 19.11, 2009 është 01 Janar 2009 - 31 Tetor 2009.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës për hetimin e thelluar në tregun e lëndës djegëse për automjete diesel (D2) për ndërmarrjen “ARMO” SHA, të shoqëruar me relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm;

- Pretendimeve të paraqitura me shkrim dhe në mënyrë verbale nga ndërmarrja “ARMO” SHA, në seancën dëgjimore të datës 10 qershor 2010.

V Ë R E N S E:

I. ÇËSHTJA NË SHQYRTIM

1. Autoriteti i Konkurrencës pas Vendimit nr. 91, datë 26.10. 2008, të Komisionit të Konkurrencës, “Mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 85 % të aksioneve të ARMO SHA tek shoqëria e përbashkët ANIKA MERCURIA REFINERY ASSOCIATED OIL SHA”, ka monitoruar sjelljen e ndërmarrjes ARMO SHA në tregun e karburanteve dhe në mënyrë të veçantë për produktin lëndë djegëse diesel D2.
2. Në pikën 2 të vendimit të mësipërm, palët pjesëmarrëse në transaksion, në rast të ndryshimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e AMRA - s midis aksionerëve dhe/ose palëve të treta, duhet t’i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës për një vlerësim, përpara realizimit të transaksionit. Ky detyrim nuk është përmbushur nga shoqëria AMRA SHA dhe për pasojë Autoriteti i Konkurrencës nuk ka mundur të realizojë në kohë reale analizën e efekteve në treg të ndryshimit strukturor të pronësisë midis aksionerëve të shoqërisë.
3. Sipas VKM Nr. 52 datë 14.01.2009, “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (dizel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë”, shoqëria “ARMO” SHA kishte për detyrim të raportonte në mënyrë periodike pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky detyrim nuk është përmbushur nga ana e shoqërisë “ARMO” SHA.

II. PROCEDURA

4. Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të nenit 28 germa a të Ligjit, monitoroi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO’ SHA. Gjatë periudhës së monitorimit Autoriteti i Konkurrencës iu drejtua ndërmarrjes “ARMO” SHA në mënyrë të përsëritur, me anë të shkresave Nr. 191 Prot. datë 23.04.2009; Nr. 238 Prot. datë 28. 05. 2009, me anë të së cilave i kërkonte informacion të domosdoshëm për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes në treg. Ky informacion nuk është sjellë brenda afateve të përcaktuara.
5. Me vendimin Nr. 262 datë 27.07.2009, Sekretari i Përgjithshëm vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak mbi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO” SHA në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë dhe pakicë të produktit lëndë djegëse diesel D2, për të parë nëse kjo ndërmarrje ka kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën në treg si pasojë e sjelljes së saj.
6. Pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa “d” dhe nenit 43, pika 1 të Ligjit me Vendimin Nr. 129 datë 19.11.2009 vendosi: “Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “ARMO” SHA, me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës të produktit lëndë djegëse diesel D2”.
7. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative.

8. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur “Raportin e hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2 për ndërmarrjen “ARMO” SHA”, pranë Komisionit të Konkurrencës. Ky raport në zbatim te nenit 47 të Kodit të Procedurave Administrative i është vënë në dispozicion ndërmarrjes objekt hetimi.
9. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, “ARMO” SHA paraqiti pretendimet e saj me shkrim dhe në mënyrë verbale në seancën dëgjimore të organizuar nga Komisioni i Konkurrencës në datën 10 qershor 2010.

III. TREGU PËRKATËS

10. Tregu përkatës sipas Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 76 datë 07.04.2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:
 - a. Tregu i përkatës i produktit
 - b. Tregu gjeografik

III.1. Tregu përkatës i produktit

11. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 129, datë 19.11.2009, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2 për ndërmarrjen “ARMO” SHA”, tregu përkatës i produktit përfshin lëndën djegëse diesel D2, që përdoret për përfitim të nxehtësisë në kaldaja dhe për gjenerimin e fuqisë në makina/makineri.

III.2. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe ofertës

12. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës midis produkteve diesel (D1) dhe diesel (D2), nga karakteristikat, produktin D1 e konsiderojmë zëvendësues të plotë të D2-shit, sepse automjetet dhe motorët e tjerë që përdorin dieselin D2 mund ta zëvendësojnë atë me D1. Ndërsa për sa i përket produktit D2 konsiderohet zëvendësues i afërt i D1-shit, pasi automjetet dhe motorët të cilat janë projektuar në katalogun e përdorimit për të përdorur D1 jo gjithmonë mund të zëvendësohen me D2. Çmimi i produktit D2 është më i ulët se ai i produktit D1 duke mos plotësuar njërin nga kriteret e zëvendësueshmërisë midis produkteve.
13. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës, mund të themi se produkti diesel (D2) nuk është i zëvendësueshëm, pasi në bazë të VKM Nr 52, dt. 14.01.2009, për periudhën janar – gusht 2009, ky produkt mund të prodhohet dhe tregtohet në këtë nivel vetëm nga ana e rafinerisë “ARMO” SHA.

III.3. Tregu gjeografik

14. Tregu gjeografik i produktit lëndë djegëse diesel D2, që përdoret për përfitim të nxehtësisë dhe për gjenerimin e fuqisë në makina/makineri, është territori i Republikës së Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE

15. Në bazë të nenit 3 të pikës 5 të Ligjit, pozitë dominuese është ajo pozitë e një ose më shumë ndërmarrjeve që i bën ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

16. Vlerësimi i pozitës dominuese të ndërmarrjes nën hetim, “ARMO” SHA, është bërë duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 8 të Ligjit .

IV.1. Pjesët e tregut dhe ndryshimi i pjesëve të tregut

17. Gjatë periudhës objekt hetimi ndërmarrja “ARMO” SHA ka zotëruar pjesën më të madhe të tregut për produktin diesel (D2). Dinamika e ndryshimit të strukturës së tregut duke marrë në konsideratë prodhimin vendas dhe importin e produktit përkatës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.1: Pjesët e tregut të lëndë djegëse diesel D2 për vitet 2008 dhe 2009

Ndërmarrjet	2008 Sasia (në liter)	2008 Pjesët e tregut në %	2009 Janar-gusht Sasia (në litër)	2009 Pjesët e tregut
PRODHIM VENDAS D2				
ARMO SHA	74.660.332	28,30%	62.923.647	80,58%
IMPORT D2				
TACI OIL INTERNAT. TRADING & SHPLY Total	46.859.649	17,76%	7.283.603	9,33%
KAST PETROL SHA Total	46.621.952	17,67%	6.698.148	8,58%
"EUROPETROL DURRES ALBANIA"SHA Total	43.362.997	16,44%	682.061	0,87%
ADA PETROL Total	6.898.131	2,61%	197.655	0,25%
GLOBAL PETROLEUM Total	11.693.307	4,43%	150.000	0,19%
AL.P.IN SHA Total	3.315.169	1,26%	110.323	0,14%
KIN-ALBANIA Total		0,00%	43.000	0,06%
MAMIDOIL ALBANIAN	12.303.709	4,66%		
Te tjera	7.902.323	3,00%		
FLABENS-OIL	884.647	0,34%		
R I R A	745.656	0,28%		
FIT-MEK-OIL	2.277.176	0,86%		
KLODI	6.317.490	2,39%		
<i>Total D2 Import</i>	<i>189.182.206</i>	<i>71,7%</i>	<i>15.164.790</i>	<i>19,4%</i>
Total D2 Import + Prodhim vendas	263.842.538	100,00%	78.088.437	100,00%

Burimi: Të dhënat e paraqitura nga ndërmarrja ARMO SHA dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave

18. Në mënyrë më të detajuar për vitin 2009 pjesa e tregut të ndërmarrjes ARMO SHA në tregun e prodhimit dhe të importit të produktit përkatës, paraqitet në tabelën nr 2: Ndarja e tregut të D2 të prodhuar dhe importuar¹ për vitin 2009

¹ Muajt shtator dhe tetor ndërmarrja ARMO SHA nuk ka prodhuar diesel D2.

Tabela Nr.2: Pjesët e tregut sipas prodhimit vendas dhe importit të lëndës djegëse diesel D2 për vitin 2009

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
Pjesa e tregut ARMO	84,35%	83,7%	99,25%	100%	69,9%	39,09%	0,92%	100%	0%	0%
Pjesa e tregut import	15,65%	16,3%	0,75%	0%	30,09%	60,91%	99,08%	0	100%	

Burimi: Të dhënat e paraqitura nga ndërmarrja ARMO SHA dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave

19. Sikurse vihet re në tabelën e mësipërme, gjatë muajve prill dhe gusht 2009 pjesa e tregut e ndërmarrjes është rritur dukshëm.
20. Pjesa që ka ndërmarrja në tregun përkatës, në kuptim të nenit 8 të Ligjit, është komponenti kryesor i vlerësimit të pozitës dominuese. Në këtë vlerësim, sipas të dhënave, të paraqitura në tabelat e mësipërme, rezulton se ndërmarrja “ARMO” SHA ka zotëruar 80.58% të tregut lëndë djegëse diesel (D2) për periudhën objekt hetimi. Gjatë periudhës shtator-tetor ndërmarrja “ARMO” SHA nuk ka qenë prezent në prodhimin dhe tregtimin e produktit përkatës, lëndë djegëse diesel D2.
21. Duke iu referuar të dhënave sasiore të produktit lëndë djegëse diesel D2 në treg, rezulton se gjatë periudhës janar-gusht të vitit 2008 sasia e importuar e lëndës djegëse dieselit D2 ka qenë 145 042 887 litra, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit 2009 rezulton se janë importuar 15 134 790 litra. Sasia e importuar në vitin 2009 për këtë periudhë është vetëm 10.43 % e sasisë që është importuar në vitin 2008.
22. Nga analiza e treguesit të përqendrimit HHI², për periudhën janar-gusht 2009, rezulton se HHI për produktin lëndë djegëse diesel D2 është 6,870, pra ka ndryshime thelbësore në strukturën e tregut, duke kaluar nga një treg me nivel përqendrimi te ulët dhe mesatar në një treg shume te përqendruar. Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e faktit se ndërmarrja “ARMO” SHA zotëron e vetme 80.58% të tregut përkatës.
23. Edhe nga treguesit e përqendrimit CR3 dhe CR5 rezulton se tregu është shumë i përqendruar, sepse 5 ndërmarrje zënë 99.75% të tregut në 8 mujorin e parë të vitit 2009. Këto dy tregues kanë pësuar rritje në krahasim me vitin 2008.

Tabela Nr.3: Treguesit e përqendrimit për produktin përkatës

Treguesi/ Viti	2008	2009
HHI	1,955	6,870
CR3	74.33%	98.63
CR5	86.60%	99.75%

² HHI: Matës specifik i përqendrimit të tregut, domethënë i shkallës në të cilën një numër i vogël i firmave zënë një përqindje të madhe të tregut të produktit. HHI-ja përdoret si një tregues i mundshëm i fuqisë së tregut ose i konkurrencës midis firmave. Sa më i lartë të jetë HHI-ja për një treg të caktuar, aq më shumë është i përqendruar produkti i atij tregu në një numër të vogël firmash. Me fjalë më të përgjithshme, kur një HHI është më i vogël se 1 000, atëherë përqendrimi i tregut mund të konsiderohet si i ulët, kur është midis 1 000 dhe 1 800 mund të konsiderohet mesatarisht i përqendruar, ndërsa nëse është më i madh se 1 800 mund të konsiderohet si i lartë.

24. Nga të dhënat³ e marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ndërmarrja ARMO SHA gjatë vitit 2009 zotëron një pjesë prej 80.58% në tregun përkatës të produktit D2. Referuar Tabelës Nr 2 konstatohet se gjatë vitit 2008 pjesa e tregut përkatës për ndërmarrjen ARMO SHA për produktin D2 ka qenë 28.30%. Kjo ndërmarrja pas vendimit Nr 52 datë 14.01.2009 që ndalonte importin e D2 për makina dhe gjeneratorë, ka rritur pjesën e saj në treg me 52.28% krahasuar⁴ me një vit më parë.

IV.2 Pengesat ligjore dhe ekonomike për të hyrë në tregun e produktit Diesel D2

IV.2.1 Barrierat ligjore

25. Lënda djegëse diesel D2 e importuar vlerësohet si një produkt zëvendësues i plotë i lëndës djegëse diesel D2 të prodhuar në vend nga ana e ndërmarrjes “ARMO” SHA. Vendimi Nr. 52 datë 14.01.2009, i Këshillit të Ministrave vendosi ndalimin e importimit të dieselit D2, me destinacion furnizimin e makinave dhe të gjeneratorëve, me efekt kohor deri në fund të vitit 2009. Për këtë arsye ndërmarrjet e licencuara nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës me leje tregtimi të kategorisë (A), dhe që kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtimin me shumicë mund të realizonin të gjitha blerjet vetëm nga rafineria “ARMO” SHA.
26. Gjatë periudhës objekt hetimi kanë ekzistuar barrierat ligjore vetëm në lidhje me importin e lëndës djegëse diesel D2, pasi ky import u ndalua me VKM Nr. 52 datë 14. 01. 2009, dhe u lejua vetëm tregtimi i lëndës djegëse diesel D2 që prodhohej nga vendburimet e naftës në territorin e Republikës së Shqipërisë.
27. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 52 datë 14.01.2009 u shfuqizua me vendimin Nr. 24, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese. Rafineritë, për të ushtruar aktivitetin e tyre të përpunimit të naftës bruto, pajisen me leje koncesionare nga Këshilli i Ministrave në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr. 8450 datë 24. 02. 1999 dhe VKM Nr. 553 datë 12. 08. 2004. Në këto dy akte nuk shprehet ndonjë kufizim në lidhje me dhënien e lejeve koncesionare. Mjafton që një ndërmarrje të plotësojë kriteret e përmendura në VKM Nr. 553 datë 12. 08. 2004 dhe pajiset me leje koncesionare. Pra, nuk ka pengesa ligjore për të ushtruar veprimtarinë e përpunimit të naftës bruto nga rafineritë.

IV.2.2 Barrierat ekonomike

28. Kostot për hyrjen e një rafinerie të re në tregun e përpunimit dhe tregimit të naftës dhe nënprodukteve të saj janë të larta, për shkak të investimeve që kërkohen për ngritjen e rafinerisë, ngritjen e sistemit të furnizimit me lëndë të parë dhe atë të shpërndarjes, garancitë e nevojshme të likuiditetit për importin dhe pagesën e barrës fiskale në doganë (shpenzime doganore, akcizë, taksë karboni, TVSH etj.) si dhe shpenzimet administrative. Në këtë lloj investimesh kërkohen shpenzime të mëdha për investime fikse karakteristikë specifike kjo e tregjeve në të cilat teknologjia bëhet faktor kryesor për pengesën e konkurrentëve të rinj në treg.

³ Shkresa Nr 15 666/1 Prot datë 02.07.2010. protokolluar pranë AK me Nr 262/1 datë 05.07/2010

⁴ Gjatë vitit 2009 sasia e prodhuar e D2 nga ndërmarrja ARMO SHA ka qenë 6.24% më e ulët se në 2008 ose 4 660 332 litra.

29. Gjithashtu duhet të merren parasysh dhe kostot e daljes nga tregu, te cilat për shkak të investimeve te nevojshme për hyrjen dhe zhvillimin e këtij aktiviteti, konsiderohen të pakthyeshme ose kanë një normë të ulët kthimi në rast të rishitjes.

IV.3 Konkurrenca potenciale

30. Nga analiza e tregut të diesel (D2) gjatë periudhës objekt hetimi, rezulton se ndërmarrja ARMO SHA nuk ka konkurrentë potenciale, sepse kjo ndërmarrje operon në treg në nivel rafinerie. Gjithashtu bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 52 datë 14.01.2009, vetëm ndërmarrjes ARMO SHA i lejohej tregtimi i produktit diesel D2, me destinacion automjetet dhe gjeneratorët.

IV.4 Fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes

31. Ndërmarrja “ARMO” SHA, është një ndërmarrje e rëndësishme jo vetëm në tregun e dieselit D2, por dhe në ekonominë shqiptare. Për të analizuar fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes ARMO SHA kemi marrë në analizë bilancin e ndërmarrjes për vitin 2008. Për vitin 2008 ndërmarrja ARMO ka pasur të ardhura në nivelin xxxxxxxx leke, duke zënë në këtë mënyrë xxx % të GDP të vitit 2008. Në vitin 2009 në të cilin përfshihet edhe periudha hetimore të ardhurat e ndërmarrjes “ARMO” SHA rezultojnë xxxxxx lekë.
32. Të ardhurat e realizuara për produktin lendë djegëse diesel D2, i cili përbën tregun përkatës të ndërmarrjes nën hetim, në vitin 2008 janë xxxxx lekë ndërsa në vitin 2009 të ardhurat nga ky produkt rezultojnë xxxxx leke. Rënia e të ardhurave nga ky produkt në vitin 2009, që përbën edhe zërin kryesor në të ardhurat totale në bilanc për ndërmarrjen ARMO SHA, ka ardhur kryesisht për shkak të rënies të çmimit të diesel D2.
33. Ndërmarrja “ARMO” SHA rezulton me humbje për vitet 2008 dhe 2009. Rezultati financiar për vitin 2009 rezulton (- xxxxx) ndërsa për vitin 2008 rezultati financiar rezulton (- xxxxx lekë)

IV.5 Varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve

34. Në tregun përkatës të produktit lendë djegëse diesel (D2) ekskluzivitetin e tregtimit të këtij produkti e ka pasur vetëm ndërmarrja “ARMO” SHA bazuar në VKM Nr 52. Duke qenë se ndërmarrja ARMO, gjatë periudhës objekt hetimi, ka zotëruar një pozitë thujse monopol, blerësit (në këtë rast shitësit me shumicë dhe ata me pakicë) në këtë treg kane qene shumë të varur ekonomikisht nga ndërmarrja ARMO SHA, si i vetmi burim furnizimi me produktin diesel D2 me destinacion automjetet dhe gjeneratorët.

IV.6 Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes të ndërmarrjes

35. Shoqëria ARMO SHA është krijuar me Vendimin Nr. 756 datë 26.11.1998 “Për ristrukturimin e Albpetrol SHA rafinerive”. Më pas kjo shoqëri regjistrohet pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 21157 datë 08.04.1999 dhe është shoqëria e vetme në Shqipëri që ushtron aktivitetin në fushën e përpunimit dhe tregtimit të naftës dhe të nënprodukteve të

saj. Veprimtaria ekonomike e shoqërisë konsiston në përpunimin e naftës, proces pas të cilit përfitohen produktet e mazutit, solarit, bitumit, koksit, hollues, gazoil, të cilat me pas tregtohen ne Shqipëri si dhe eksportohen në vendet fqinje.

36. Objekti i shoqërisë është përpunimi i naftës bruto ne dy rafineritë Ballsh dhe Fier, shpërndarja dhe marketingu i produkteve dhe nën- produkteve të naftës
37. Produktet e ndërmarrjes ARMO SHA gjatë periudhës janar-shtator 2009 tregtohen nëpërmjet Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës (KPTHN), ne Degët e Shpërndarjes së Karburanteve (DSHK). DSHK-të për periudhën objekt hetimi janë përkatësisht: DSHK Fier, DSHK Durrës, DSHK Shkodër dhe DSHK Vlorë. Sipas pozicionit gjeografik ato mbulojnë zonat përkatëse për furnizimin me karburant.
38. DSHK-të nga ana e tyre i shesin karburante ndërmarrjeve që kanë licencë tregtimit të llojit A (licencë për shitje me shumicë).
39. Gjatë zhvillimit të procedurave hetimore, grupi i punës konstatoi se ndërmarrja “ARMO” SHA gjatë periudhës hetimore ka shitur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në tregun e shitjes me pakice. Rreth 12.2% e shitjeve të dieselit D2 nga ARMO SHA kanë qenë në këtë treg. Ky transaksion është i ndaluar nga Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe me VKM nr 52, i cili përcaktohen se shitja e dieselit D2 nga rafineritë mund të realizohet vetëm në kompanitë që kanë leje tregtimi të kategorisë A.

IV.7 Fuqia kundërvepruese e blerësit

40. Ndërmarrja “ARMO” SHA është e vetmja ndërmarrje që operon në nivel rafinerie në vend dhe për periudhën objekt hetimi ka qenë e vetmja që ka tregtuar produktin diesel D2 për automjete dhe gjeneratorë. Pra, mund të themi se fuqia kundërvepruese e blerësit (shitësit me shumicë të karburanteve) ka qenë shumë e dobët, për shkak të pozitës thuasje monopol në tregun përkatës të produktit.

Tabela Nr.4: Struktura e shitjeve për prodhimin e D2 nga ARMO për periudhën janar-tetor 2009

	Sasi totale	Në %
Shitje te tjerëve	11268280	17,14%
Shitje “Taci Oil international	54471331	82,86%
Shitje totale	65739611	100,00%

Burimi: Të dhënat e paraqitura nga ndërmarrja “ARMO” SHA

IV.8 Lidhja ekonomike me ndërmarrjet e tjera në treg

41. Ndërmarrja “ARMO” SHA është e integruar vertikalisht në tregun e tregtimit me shumicë dhe në tregun e tregtimit me pakicë të karburanteve, pasi njëri prej aksionarëve të saj, zotëron 100% të aksioneve të ndërmarrjes “ANIKA” SHA e

cila zotëron 80% të aksioneve të ndërmarrjes “AMRA” SHA. Pra ky aksioner, i cili zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen e tregtimit me shumicë “TACI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” SHA dhe në ndërmarrjen e tregtimit me pakicë “KUID” sh.p.k, në mënyrë indirekte zotëron 68% të aksioneve në ndërmarrjen “ARMO”SHA. Gjatë periudhës së marrë nën hetim, ndërmarrja “TACI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY” SHA ka blerë nga “ARMO” SHA rreth 82% të gjithë sasisë së naftës së prodhuar nga kjo rafineri.

IV.9 Karakteristika të tjera të tregut përkatës

42. Një karakteristikë tjetër e tregut përkatës për produktin diesel D2 është transparencja e tregut. Gjatë periudhës objekt hetimi ndërmarrja ARMO SHA nuk ka qenë transparente në treg. Ajo nuk ka zbatuar asnjë nga pikat e përcaktuara në VKM Nr 52, datë 14.01.2009, duke mos bërë transparente sasinë e naftës bruto të blerë, sasinë e prodhimit të realizuar nga rafinimi, sasinë e tregtuar të produkteve të rafinimit, çmimet e blerjes dhe të shitjes, sipas kontratave të shitblerjes për këto produkte si dhe kushtet e tjera të tregtimit, gjatë muajit paraardhës.
43. Referuar vlerësimit të bërë sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, rezulton se kjo ndërmarrje ka pozitë dominuese në tregun përkatës të tregtimit të produktit lëndë djegëse diesel D2.

V. SJELLJA E NDËRMARRJES NË TREG

44. Gjatë procesit të hetimit të thelluar për sjelljen e ndërmarrjes “ARMO” SHA në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2, janë administruar një sërë evidencash për të parë sjelljen e ndërmarrjes në treg, në këndvështrim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
45. Gjatë periudhës nën hetim, ndërmarrja “ARMO” SHA ka kryer transaksione të njëjta me kushte të ndryshme tregtare për ndërmarrjet konkurrense duke i vendosur në gjendje të pafavorshme konkurrence. Nga evidencat rezulton se shoqëria ARMO SHA nëpërmjet degës së shitjes Fier (DSHK – Fier) ka zbatuar çmime dhe kushte të ndryshme tregtimi për sasi të krahasueshme në të njëjtën datë, në tregun përkatës të produktit lëndë djegëse diesel D2.
46. Gjatë periudhës se hetimit janë administruar 55 fatura ku ndërmarrja ARMO SHA u shet lëndë djegëse diesel D2 ndërmarrjeve të tjera të shumicës që zotërojnë leje tregtimi të kategorisë A, me një çmim të ndryshëm nga ndërmarrja Taçi Oil SHA. Çmimi që ndërmarrja “ARMO” SHA aplikon tek ndërmarrjet e tjera krahasuar me çmimin që i shet Taçi Oil International SHA varion në një shtesë për çdo faturë nga 2 lekë deri në 10 lekë për litër brenda një dite, gjë që përbën një diferencë prej rreth 2-12 % mbi çmimin mesatar të periudhës nën hetim. Kështu për shembull: në datë 5 janar 2009 nga fatura me nr 310, nr. serial 38743573 ndërmarrja ARMO SHA i shet subjektit Taçi Oil International 36 mijë litra me çmimin 86 lekë për litër. Në të njëjtën datë “ARMO” SHA i shet ndërmarrjes Europetrol SHA të njëjtën sasi prej 36 mijë litrash me një çmim 92 lekë për litër. Gjithashtu në të njëjtën datë, ARMO SHA i shet subjektit Kastrati SHA 12 .270 litra me një çmim 96 lekë për litër, pra 10 lekë më shtrenjtë.

47. Nga tërësia e evidencave të administruara dhe nga analiza e faturave të shitjes të ndërmarrjes “ARMO” SHA ka rezultuar se ndërmarrja objekt hetimi, gjatë periudhës hetimore zbaton çmime diskriminuese ndaj ndërmarrjeve të tjera në raport me ndërmarrjen Taçi Oil international SHA, e cila është e integruar me ndërmarrjen “ARMO” SHA duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence⁵. Si rezultat i këtyre veprimeve tregtare ndërmarrja Taçi Oil SHA ka përfituar 89.91% të pjesëve të tregut të dieselit D2 (80.58% blerje nga ARMO SHA dhe 9.33%⁶ nga importi).
48. Ndërmarrja “ARMO” SHA duke pasur një pozitë dominuese në tregun përkatës, në kuptim të nenit 8 të Ligjit; është e detyruar të zbatojë rregullat e sjelljes për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.
49. Nga analiza e mësipërme konstatohet se ndërmarrja “ARMO” SHA, gjatë periudhës nën hetim duke zbatuar çmime dhe kushte të ndryshme tregtimi për veprime të njëjta tregtare me palët, ka vendosur në kushte të pafavorshme konkurrence ndërmarrjet që operojnë në tregun e tregimit me shumicë të produktit lëndë djegëse diesel D2.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 8, nenin 9, pika 1, dhe pika 2 germa (c), nenin 74, pika 1, germa (a) dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

V E N D O S I:

1. Ndërmarrja “ARMO” SHA ka abuzuar me pozitën dominuese për periudhën 1 janar 2009 - 22 gusht 2009, në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2, duke vendosur kushte të pabarabarta tregtimi ndaj ndërmarrjeve të ndryshme për të njëjtat veprime tregtare;
2. Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, ndërmarrja “ARMO: SHA të gjobitet në shumën 271,880,720 Lekë që përbën 2,6% të xhiros totale vjetore të vitit 2009
3. Mbyllet hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2 për ndërmarrjen “ARMO” SHA, të nisur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 129, datë 19.11.2009;
4. Ngarkohet Drejtoria e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi;

⁵ Në çështjen United Brands (Case 27/76: United Brands Company and United Brands Continental b.v, as applicants, versus Commission of the European Communities, as defendant) si Komisioni ashtu dhe Gjykata e Drejtësisë, me arsyetimin se aplikimi i çmimeve të ndryshme ndaj palëve (blerësve) të ndryshëm krijon një diskriminim, konsiderohet si një abuzim me pozitën dominuese të një ndërmarrjeje në treg. Vetë Gjykata në arsyetimin e vendimit të saj shprehët se aplikimi i çmimeve të ndryshme, e cila e bënte UBC të krijonte kushte jo të ngjashme (të njëjta) ndaj transaksioneve ekuivalente me palët, duke i vendosur ato në disavantazh konkurrues, është një abuzim me pozitën dominuese.

⁶ Të dhënat e paraqitura në Tab Nr 2.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes “ARMO” SHA dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 151, Datë 21.07.2010

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve mbi shoqërinë CapRock Holdings, Inc. nga shoqëria Harris Corporation”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.07.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 100% të aksioneve mbi shoqërinë CapRock Holdings, Inc. nga shoqëria Harris Corporation.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 2, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Transaksioni me anë të se cilit synohet bashkimi i plotë nëpërmjet transferimit të 100% në kapitalin aksionar me të drejtë vote të shoqërisë CapRock Holdings, Inc. nga shoqëria Harris Corporation., realizohet në përputhje me Kontratën e shijes dhe Projektin e bashkimit të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në 21 Maj 2010 në USA dhe është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit.

Përqendrimi i synuar, është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresat Nr. 243 dhe 243/1 përkatësisht të datave 28 Maj dhe 24 Qershor 2010 nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë blerëse Harris Corporation.

Ky transaksioni nëpërmjet të cilit realizohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë përfitimi i kontrollit, sjell ndryshime mbi një bazë të qëndrueshme të kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2, konsiderohet përqendrim.

Transaksioni i njoftuar është objekt kontrolli dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës sepse përmbush në mënyrë kumulative edhe kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12¹ të Ligjit.

II. PALËT NË TRANSAKSION

II.1 Harris Corporation, në cilësinë e **blerësit**, me seli në Melbourne, Florida USA,, nëpërmjet:

II.2 Canyon Merger Corporation, një shoqëri nga Delaëare, USA, e zotëruar 100% nga Harris Corporation.

II.3 CapRock Holding Inc, në cilësinë e **shitësit**, me seli në Delaëare.

III. XHIRO PËR VITIN 2009²

Referuar nenit 12, pika 3, shkronja b të Ligjit, palët pjesëmarrëse në llogaritjen e pragut të xhiros kanë marrë parasysh kërkesat e nenit 16 të Ligjit.

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **xxx miliard lekë xxx milion lekë** nga të cilat:
 - o **Harris Corporation:** xxx miliard USD= xxx miliard e xxx milion lekë.
 - o **CapRock :** xxx milion USD = xxx miliard lekë.
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm:** është **xxx milion Lekë:**
 - o **Harris Corporation:** xxxx USD = xxxx milion Lekë

Palet ne transaksion plotesojne kriteret e xhiros te percaktuara ne nenin 12, pika 1 e Ligjit "Per Mbrojtjen e Konkurrences" dhe si rrjedhohe , ky transaksion është object autorizimi nga Komisioni I Konkurrencës.

IV. ANALIZA E KONKURRENCËS

IV.1 Tregu Përkatës:

Referuar nenit 3, pika 7, te ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences", përcaktimi "treg perkates" , perfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose

¹ a) Xhiroja e te gjitha ndermarrjeve pjesemarrrese se bashku ne tregun nderkombetar eshte me shume se xxx miliarde leke, ose xhiroja e te gjitha ndermarrjeve se bashku, ne tregun e brendshem eshte me shume se xxx milione leke dhe
b) xhiroja e te pakten nje ndermarrjeje pjesemarrrese, ne tregun e brendshem eshte me shume se xxx milione leke

² Sipas Balanceve të shoqërive përkatëse.

klientët e tjerë , për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike më kushe të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila vechet nga zona të tjera kufizuese”. Dy komponentët e tregut përkatës:

- a) tregu përkatës i produktit dhe;
- b) tregu përkatës gjeografik

Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, tregu përkatës do konsiderohet tregu global për shërbime dhe produkte të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit.

IV.1.1 Tregu përkatës i produktit:

Tregu përkatës i produktit në Republikën e Shqipërisë janë produktet e shitura nga Harris në Shqipëri për vitin 2009 lidhen me shitjen e Pajisjeve Radio Taktike për Ministrinë e Mbrojtjes nëpërmjet sistem CECOM si edhe shitjen e disa pajisjeve transmetimi tek Media Vizion Group.(Vizion Plus TV).

CapRock nuk ka shitje në Shqipëri.

IV.1.2 Tregu gjeografik : Territori i Republikës së Shqipërisë

V. NDIKIMI I PËRQENDRIMIT NË TREG

Transaksioni i njoftuar konsiston në blerjen e plotë të veprimtarisë ekonomike CapRock Communication dhe në kuptim të nenit 10 pika 1, shkronja a) të Ligjit, konsiderohet përqendrim, si bashkim i dy ndërmarrjeve të pavarura. Ky transaksion, që nuk shkakton ndryshime të drejtëpëdrejta në strukturën e tregut në Republikën e Shqipërisë, është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës në zbatim të nenit 2 të Ligjit pasi pasojat e veprimtarisë së ndërmarrjeve shtrihen edhe në territorin shqiptar.

Në Shqipëri, Harris Corporation është e pranishme në tregun e produktit me ofrimin e disa shërbimeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Vizion plus, ndërsa CapRock nuk është e pranishme as direkt dhe as indirekt.

Në këtë kontekst përqendrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurrense në tregun shqiptar pasi: (i) veprimtarinë e palëve pjesëmarrëse në transaksion nuk mbivendosen dhe (ii) CapRock nuk është e pranishme në treg.

Si konkluzion transaksioni i njoftuar që konsiston në bashkimin e CapRock me Harris Corporation, nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të produkteve të Harris Corporation në nivelin e tregimit në tregun e brendshëm. Për pasojë nuk kemi kufizim të konkurrencës në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin përqëndrimin të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve mbi shoqërinë CapRock Holdings, Inc. nga shoqëria Harris Corporation.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në përqëndrim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)

(_____)

(_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 152, Datë 21.07.2010

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit - blerjes së 50% të Kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k, nga VERBUND International GbmH tek EVN AG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.07.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit - blerjes së 50% të Kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k, nga VERBUND International GbmH tek EVN AG.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit për përqendrimin e realizuar (përfitim kontrolli të përbashkët) nëpërmjet shit – blerje së 50% të Kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k, nga shoqëria VERBUND International GbmH tek shoqëria EVN AG dhe relacionit të Sekretares së Përgjithshme.

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe Përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k nga shoqëria VERBUND International GbmH tek shoqëria EVN AG, është realizuar nëpërmjet ‘Kontratë Shitje Kuotash’ e datës 20 Prill 2010, e nënshkruar nga palët VERBUND International GbmH dhe EVN AG dhe është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës më datë 27 Prill 2010 brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit.

Shoqëria EVN AG blen me anë të kësaj Kontrate 50% të aksioneve të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k nga shoqëria VERBUND International GbmH dhe përfton kështu kontroll të përbashkët me këtë të fundit nëpërmjet shit-blerjes së kuotave.

Kontrata e datës 20 Prill 2010 i përqendrimin të synuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 7 të Kontratës së lidhur ndërmjet palëve më datë 20 Prill 2010, është miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës më 22 Qershor 2010.

Transaksioni i njoftuar paraqitet si përfitim kontrolli i përbashkët në formën e shoqërisë së përbashkët (jonit-control) nëpërmjet shit-blerjes së kuotave, ku dy shoqëritë VERBUND International GbmH dhe EVN AG do t’ë kontrollojnë (zotërues seicili nga 50% të kuotave me të drejtë vote) shoqërinë (Konçesionare /të projektit) Energji Ashta Sh.p.k.

Transaksioni kryhet në përputhje me ‘Kontratë Shitje Kuotash’ e datës 20 Prill 2010, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 163 datë 22 Tetor 2008 “Për miratimin e marrëveshjes së konçesionit, ndërmjet Ministrise se Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe shoqërisë ‘Osterreichische Elektrizitäts- und Erdgas- Aktiengesellschaft’ (Verbund International GbmH), për ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në Republikën e Shqipërisë”.

Transaksioni njoftuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, është ndryshim i kontrollit të shoqërisë nga kontroll i vetëm në kontroll të përbashkët.

II. Palët në transaksion

- a. Shoqëria VERBUND INTERNATIONAL GBMH (Verbund International), në cilësinë e shitësit, me seli në adresën: Am Hof 6a, A- 1010 Vjenë, Austri.
- b. Shoqëria EVN AG, në cilësinë e blerësit, me seli në adresën EVN Platz, A-2344 Maria Enzersdorf, Austri.
- c. Shoqëria ENERGJI ASHTA SH.P.K, me seli në adresën: Blv ‘Dëshmorët e Kombit’, Kulla Binjake, Kulla 1, Kati v, Tiranë Shqipëri. Shoqëria është shoqëria shënjestër e përqendrimit.

III. Xhiro e ndërmarrjeve

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është xxx miliard Lekë:
 - o Xhiro e Verbund International është xxxxx Euro ose rreth xxx miliard lekë.
 - o Xhiro e EVN AG është xxxxx Euro ose xxx miliard lekë.
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është përafërsisht xxxx miliard Lekë:
 - o Xhiro e EVN AG është xxxx Lekë
 - o Xhiro e Energji Ashta është xxxxx Lekë

Sa më lartë, përqendrimi i njoftuar është objekt kontrolli dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës, sepse përmbush në mënyrë kumulative edhe kusht in e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12¹ të Ligjit.

IV. Analiza e Konkurrencës

IV.1 Tregu Përkatës:

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Per Mbrotjen e Konkurrencës”, përcaktimi “treg perkates”, përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike më kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zona të tjera kufizuese”. Dy komponentët e tregut përkatës:

- a) tregu përkatës i produktit dhe;
- b) tregu përkatës gjeografik

Sektori ekonomik ku vepron shoqëria e përbashkët është sektori elektroenergjetik, i cili organizohet si treg i rregulluar dhe i mbikqyrur nga Enti Rregullator i Energjise Elektrike (ERE).

Veprimtaria e palëve të transaksionit:

1. VERBUND INTERNATIONAL GBMH – objekti i veprimtarisë së shoqërisë është (i) gjenerimi i energjisë elektrike; (ii) tregtimi; (iii) transmetimi dhe (iv) shpërndarja e energjisë elektrike.
2. EVN AG - produktet që shoqëria ofron në sektorin energjetik / utiliteteve, përfshijnë: (i) energji elektrike; (ii) gaz; (iii) ngrohje; (iv) shërbime të lidhura. Në sektorin mjedisor shërbimet e shoqërisë përfshijnë: (i) furnizim me ujë; (ii) trajtim i ujrave; (iii) djegje të mbetjeve urbane etj.
3. ENERGI ASHTA SH.P.K - objekti i shoqërisë është: projektimi, financimi, ndërtimi, funksionimi, aktivitet ndihmës për ndertimin dhe vënien në punë të Hidrocentralit të Ashtës si dhe objekte të tjera të lidhura me to.

IV.1.1 Tregu përkatës i produktit

Në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqendrimet dhe sipas veprimtarisë që kryejnë palët pjesëmarrëse në këtë transaksion treg përkatës produkti do të konsiderojmë:

Gjenerimin e energjisë elektrike nga njësi të lidhura drejtpërdrejt me rrjetin kombëtar të transmetimit të energjisë elektrike, të operuar nga OST Sha. Pra gjenerimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e pavarur të lidhur me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike (PPE).

IV.1.2 Tregu përkatës gjeografik:

Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm/territori i Republikës së Shqipërisë.

¹ a) Xhiroja e të gjitha ndermarrjeve pjesemarrëse se bashku ne tregun nderkombetar eshte me shume se 70 miliardë leke , ose xhiroja e të gjitha ndermarrjeve se bashku , ne tregun e brendshem eshte me shume se 800 milion leke dhe
b) xhiroja e të pakten një ndermarrje pjesemrrese , ne tregun e brendshem eshte me shume se 500 milion leke

V. Ndikimi i përqendrimit ne treg

Qeveria Shqiptare inkurajon investimet private për ndërtimin e centraleve të rinj elektrik për të plotësuar kërkesat e vendit me energji elektrike dhe për të garantuar siguri të lartë furnizimi nëpërmjet diversifikimit të burimeve të gjenerimit.

Tregu i prodhimit të energjisë elektrike është një treg i rregulluar nën mbikqyrjen e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike. Qeveria Shqiptare me VKM Nr. 1363 datë 17.10.2008 ka autorizuar KESH-in që të blejë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar prej tyre, me çmim të miratuar nga ERE.

Prodhimi i energjisë elektrike nga PPE do të arrijë në pjesën prej 25%², duke përfshirë HEC-et ekzistuese dhe HEC që janë pjesë e analizës sonë. Gjithësesi për shkak të peshës së konsiderueshme që zë KESH Gen në tregun e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nuk ka arsye shkakore të krijimit të një pozite dominuese nga prodhuesit e pavarur të energjisë.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët nga shoqëritë VERBUND International GbmH dhe EVN AG nëpërmjet shit-blerjes së 50% të Kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k., dhe nuk krijon pozitë dominuese të shoqërisë pas përqendrimit.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 50% të Kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k, nga shoqëria VERBUND International GbmH tek shoqëria EVN AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në përqendrim. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

² Burimi , sipas perlllogaritjeve te bera nga Grupi I Punes bazuar ne te dhenave ne Kontrata e Konçesionit dhe Raportit Vjetor te ERE- s.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 153, Datë 21.07.2010

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve mbi shoqërinë Astra Albania Sh.a nga shoqëria Eagle Investment Sh.a”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.07.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 100% të aksioneve mbi shoqërinë Astra Albania Sh.a nga shoqëria Eagle Investment Sh.a.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe Përqendrimi

Transaksioni me anë të se cilit synohet përfitim i plotë i kontrollit nëpërmjet transferimit të 100% në kapitalin aksionar me të drejtë vote në shoqërinë Astra Albania Sha nga shoqëria Eagle Investment Sh.a, realizohet në bazë të Marrëveshjes për Blerje Aksionesh

e nënshkruar ndërmjet palëve më në bazë të Kontratës për Blerje dhe Trasferim Aksionesh e nënshkruar ndërmjet palëve më datë 9 Qershor 2010 dhe është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit.

Blerësi së bashku me aksionet (me gjithë të drejtat dhe detyrimet që rredhin nga kalimi i të drejtave mbi aksionet) përfton edhe kontrollin e vetëm në shoqërinë Astra Albania Sh.a. Transaksioni do të realizohet me përmbushjen e kushteve e marra përsipër nga palët siç përcaktuar në Kontratë.

Ky transaksioni nëpërmjet të cilit realizohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë përftimi i kontrollit, sjell ndryshime mbi një bazë të qëndrueshme të kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2, konsiderohet përqendrim.

Transaksioni i njoftuar është objekt kontrolli dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës sepse përmbush në mënyrë kumulative edhe kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12¹ të Ligjit.

II. Palët në transaksion

II.1 Eagle Investment Sha, në cilësinë e blerësit, me seli në adresën: Rruga “Pjetër Bogdani”, Tiranë.

II.2 Vivara Kft, në cilësinë e shitësit, me seli në ligjore në Szekesfeherva dhe me adresë tregtare në Megyahaz ut 9, 8000 në Hungari zotëron 100% shoqërinë Astra Albania SHA, që është dhe shoqëria target e operacionit të përqendrimit

II.3 Astra Albania Sha në cilësinë e shoqërisë target të operacionit është një shoqëri anonime e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në Rrugën “Murat Toptani”, Tirane.

III. Xhiro e ndërmarrjeve

VI. Xhiro për vitin 2009

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është xxxx miliard Lekë:
 - o Novomatic AG : xxxx milion Euro= xxx miliard lekë.
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është përafërsisht xxx miliard Lekë
 - o Eagle Investment Sha : xxxx Lekë
 - o Adriatik Game Sha : xxxx Lekë
 - o Astra Albania Sha : xxxx Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

¹ a) Xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse se bashku në tregun ndërkombëtar është me shumë se xx miliarde leke, ose xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve se bashku, në tregun e brendshëm është me shumë se xxx milione leke dhe b) xhiroja e të paktën një ndërmarrjeve pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm është me shumë se xxx milione leke

IV. Analiza e Konkurrencës

IV.I Tregu Përkatës:

Referuar nenit3, pika 7, te ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 “Per Mbrotjen e Konkurrencës”, përcaktimi “treg perkates”, perfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë , për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike më kushe të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zona të tjera kufizuese”. Dy komponentët e tregut përkatës:

- a) tregu përkatës i produktit dhe;
- b) tregu përkatës gjeografik

IV.1.1 Tregu përkatës i produktit

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në këtë transaksion është;

- Eagle Investment Sha ushtron veprimtarinë e saj në (i) eksport-import si dhe tregtimi i të gjitha tipeve të automateve të lojrave të fatit dhe paisjeve për kazino; (ii) Manaxhimi i automateve të lojrave të fatit, paisjeve për kazino dhe pjesëve të tyre përkatëse; (iii) drejtimi dhe menaxhimi i sallave të lojrave të fatit; (iv) riparimi, prodhimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i të gjithave llojeve të automateve të lojrave të fatit dhe paisjeve për kazino, si dhe pjesëve të tyre përkatëse. Kjo veprimtari në tregun shqiptar realizohet nëpërmjet shoqërisë bijë të saj Adriatik Game Sha për ofrimin e shërbimit të lojrave të fatit për konsumatorët nëpërmjet makinave (automateve) elektrike dhe elektronike.
- Adriatik Game Sha ka si veprimtari të aktivitetit të saj ofrimin e shërbimit në tregun e lojrave të fatit për konsumatorët nëpërmjet makinave (automateve) elektrike dhe elektronike.
- Astra Albania Sha ushtron veprimtarinë e saj në ofrimin e shërbimit në tregun e lojrave të fatit nëpërmjet makinave (automateve) elektrike dhe elektronike.

Në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqendrimet dhe sipas veprimtarisë që kryejnë palët pjesëmarrëse në këtë transaksion treg përkatës produkti do të konsiderojmë (i) veprimtarinë e dhënies me qera të makinave (automateve) të lojrave të fatit dhe (ii) ofrimin e shërbimit në tregun e lojrave të fatit për konsumatorët nëpërmjet makinave (automateve) elektrike dhe elektronike.

IV.1.2 Tregu përkatës gjeografik

Palët në këtë transaksion ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlersimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Ndikimi I përqendrimit në treg

Tregu i ofrimit të shërbimit të lojrave të fatit për konsumatorët është i përbërë nga shumë shoqëri të cilat kanë pjesë të vogla. Tregu i produktit karakterizohet nga ndryshime të shpejta përsa i takon madhësisë totale të tij e cila është në rritje.

Të dyja shoqëritë Adriatik Game Sha dhe Astra Albania Sha veprojnë në të njëjtin nivel tregu të produktit dhe kanë një mardhënie horizontale. Bashkimi i këtyre dy shoqërive do të rrisë fuqinë e shoqërisë pas realizimit të përqendrimit, me një pjesë të kombinuar të tregut prej afërsisht 10.4%. duke qene konkurrenti kryesor i shoqërise Apex që ka një përqindje të ngashme tregu. Në këtë treg veprojnë një numër i madh shoqërish relativisht të vogla të shpërndara në të gjithë territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që pas përqendrimit do të ketë 5 konkurrenente kryesorë në këtë treg, ku asnjëri prej tyre nuk ka pozitë dominuese.

Si konkluzion, përqëndrimi i njoftuar konsiston në përfundimin e kontrollit të vetëm shoqërisë Astra Albania Sha nga shoqëria Eagle Investment Sh.a dhe nuk krijon pozitë dominuese në tregun përkatës pas përqendrimit.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve nga shoqëria Eagle Investment Sh.a tek shoqëria Astra Albania Sha.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në përqendrim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 154, Datë 01.10.2010

“Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, “Noti” sh.p.k dhe “Ultra Motors” sh.p.k. dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes në oferta ndërmjet ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, “Ultra Motors” sh.p.k dhe “Noti” sh.p.k, për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; neni 74 pika 1, shkronja a) dhe neni 75, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;
- Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja të hapur me Vendimin nr. 135, dt. 21.12.2009 të Komisionit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretares së Përgjithshme;
- Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, “Ultra Motors” sh.p.k të paraqitura në seancat dëgjimore përkatëse: të datës 17/06/2010, dhe datës 23/06/2010; si dhe ato me shkrim të dërguara pranë Autoritetit

të Konkurrencës, përkatësisht me shkresat Nr. 116 Prot, datë 05. 06. 2010; Nr. 067 Prot, datë 05. 06. 2010; Nr. 10 Prot, datë 10. 06. 2010. “Noti” sh.p.k nuk paraqiti pretendime me shkrim si dhe nuk mori pjesë në seancë dëgjimore me gjithë ftesën e dërguar nga autoriteti.

V Ë R E N S E:

I. PROCEDURA

1. Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II dhe III të pjesës III të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (këtu e me poshtë “Ligji”) dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.
2. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, germa a) të Ligjit, me nismën e tij, realizoi një monitorim në tregun e prokurimeve publike të automjeteve të reja për të parë, nëse kishte element që kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në këtë treg.
3. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, duke marrë shkas nga gjetjet e konstatuara gjatë monitorimit të realizuar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja, bazuar në nenin 42, të Ligjit, me anë të Vendimit Nr. 246, datë 08.07.2009 “Për hapjen e procedurave të hetimit paraprak në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 260, 21.07.2009 të Sekretarit të Përgjithshëm, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja, për të parë nëse ka apo jo ndërmarrje, që kryejnë veprime apo sjellje me elementë antikonkurrues, të cilat bien ndesh me Ligjin.
4. Në përfundim të hetimit paraprak rezultoi se ekzistojnin evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit për pjesëmarrje në prokurimet publike midis 4 ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Ultra motors” sh.p.k, “Noti” shpk dhe “Hyundai Auto Albania” shpk, , e cila mund të përbënte një marrëveshje të ndaluar në prokurime ndërmjet ndërmarrjeve, që veprojnë në tregun përkatës.
5. Pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me Vendimin nr. 135, datë 21.12.2009 vendosi: “Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, ndaj ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k; “Ultra motors” sh.p.k; “Noti” sh.p.k; dhe “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun e prokurimit të automjeteve të reja.
6. Në zbatim të këtij vendimi të Komisionit, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar.
7. Raporti i hetimit të thelluar iu komunikua ndërmarrjeve objekt hetimi: “Classic” sh.p.k; “Ultra motors” sh.p.k; “Noti” sh.p.k; dhe “Hyundai Auto Albania” sh.p.k me anë të shkresës Nr. 203 prot, datë 07.05.2010 të Autoritetit të Konkurrencës.

8. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit palët nën hetim paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar në seancat dëgjimore, si dhe me shkrim, pretendime që janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

9. Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 135, datë 21.12.2009 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, përfshin periudhën kohore nga 01 Janar 2007 deri në 20 Dhjetor 2009.
10. Ndërmarrjet nën hetim janë përcaktuar në Vendimin Nr. 135, datë 21.12.2009 të Komisionit të Konkurrencës. Ndërmarrjet nën hetim të përcaktuara në vendimin e mësipërm të Komisionit të Konkurrencës janë:
- Ndërmarrja “HYUNDAI AUTO ALBANIA” sh.p.k, me NIPT K62420006T, me seli në: “Rruga e Durrësit”, përballë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” Tiranë;
 - Ndërmarrja “ULTRA MOTORS” sh.p.k, me NIPT K21525002J, me seli në: “Rr. e Kavajës, nr. 116, Tiranë”;
 - Ndërmarrja “CLASSIC” sh.p.k, me NIPT J91909004J, me seli në: “Rr. e Kavajës, Tiranë”;
 - Ndërmarrja “NOTI” sh.p.k, me NIPT K62717605S, me seli në: Gerhot, Gjirokastër, Lagjia “Pllake”, Blloku i Furrave.

III. STRUKTURA E TREGUT

11. Tregu përkatës, në bazë të nenit 3 pikës 7 të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 76, datë 07. 04. 2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:
- a. Tregu i produkteve
 - b. Tregu gjeografik

III.1 Tregu përkatës i produktit

12. Duke u bazuar në parimin e zëvendësueshmërisë, produkte të zëvendësueshme në prokurimet publike për blerje automjete të reja, janë të gjitha llojet e automjeteve të reja që ofrohen nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja. Këto produkte të ofruara duhet të plotësojnë specifikimet teknike që kërkohen në një prokurim publik të organizuar nga ana e një Autoriteti Kontraktor.
13. Specifikimet teknike që paraqesin autoritetet kontraktore në prokurime publike për automjetet janë përcaktuesit kryesorë të dimensioneve të tregut përkatës. Kriteret e përcaktuara nga autoritetet kontraktore, klasifikohen në disa grupe kryesore ku futen: dimensionet, fuqia motorike, transmisioni dhe pajisjet e brendshme, përcaktohet edhe se cilat janë ndërmarrjet. Këto kriteret përcaktojnë se cilat janë ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës të produktit.

14. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg do të konsiderojmë treg përkatës produkti, tregun e automjeteve të reja që ofrohen për prokurim publik.

III.2 Tregu gjeografik

15. Te gjitha palët janë aktive në tregun e produktit, nëpërmjet ofertimit të tyre, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

IV. SJELLJA E NDËRMAREJVE NË TREG

16. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar për sjelljen e ndërmarrjeve nën hetim “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, “Ultra motors” sh.p.k dhe “Noti” sh.p.k në tregun e prokurimit të automjeteve të reja, janë administruar një sërë evidencash për të parë sjelljen e tyre në treg, në këndvështrim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
17. Nga analiza e evidencave të administruara mbi konkurrencën në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja, bazuar edhe në metodologjinë e OECD-së “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike”¹, rezultoi se ka:
- Një numër të vogël ofertuesish që marrin pjesë në tregun përkatës;
 - Rotacion në ofertime;
 - Mundësi dhe shenja të komunikimit midis ofertuesve;
 - Marrëdhënie midis ofertuesve pas shpalljes së ofertës fituese;
 - Shenja të ngjashme në dokumentet e paraqitura nga ofertues të ndryshëm.
18. Ndërmarrjet nën hetim, “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, “Ultra motors” sh.p.k dhe “Noti” sh.p.k, përdorin skemën e nenkontraktimit (furnizimit), duke blerë automjete objekt prokurimi nga njëra-tjetra. Këto automjete blihen nga ofertuesi i suksesshëm pas shpalljes së tij fitues nga një prej ndërmarrjeve nën hetim, e cila mund të jetë: një konkurrent jo i suksesshëm ose një konkurrent jo pjesëmarrës në prokurim. Automjetet blihen dhe shiten me te njëjtin çmim duke ruajtur në këtë mënyrë çmimin e rishitjes². Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve, ndërmarrjet objekt hetimi realizojnë pjesëmarrjen efektive në prokurime si dhe ndarjen e fitimeve të arritura pa të drejtë. Një nga skemat që përdoren për ndarjen e këtyre fitimeve është vërtetuar nëpërmjet marrëveshjes së shkruar midis “Noti” shpk dhe “Classic” shpk, ku përcaktohet ndarja e fitimeve të realizuara nga shitjet, nëpërmjet caktimit të çmimit të rishitjes dhe përcaktimit të fitimit që do marrë “Noti” nga shitjet. Pra, “Classic” sh.p.k bëhet aktiv de fakto në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja, ndërkohë që ka qenë i përjashtuar nga pjesëmarrja në këtë treg. Kështu për shembull:
- Sipas faturës tatimore të shitjes nr. 811, dt. 18.09.2008, me nr. serie 40152263, “Classic” shpk i shet “Noti” shpk 1 (një) automjet model VW Jetta, me nr.

¹ <http://www.oecd.org/dataoecd/27/19/42851044.pdf>

² Sipas Faturave të mara gjatë inspektimit në ndërmarrje si dhe të sjella nga vetë ndërmarrjet në përgjigje të kërkesave për informacion.

shasie: WWV ZZZ 1KZ 8M 196 346 dhe çmim për njësi pa tvsh: xxxxx lekë. Sipas Faturës nr. 45, dt. 19.09.2008, nr. serie 36747896, “Noti” sh.p.k po këtë automjet, ia prokuron autoritetit kontraktor “Njësisë Bashkiake nr. 8”, Tiranë, po me të njëjtin çmim që e ka blerë nga “Classic” sh.p.k, si dhe pas datës së zhvillimit të tenderit (dt. 15.08.2008) dhe pasi është shpallur fitues.

- Sipas faturës nr. 454, dt. 25.06.2009, me nr. serie 41888305, “Classic” shpk i shet “Noti” shpk 1 (një) automjet model VW Passat, me nr. shasie: WWV ZZZ 3CZ 9P 073 372 dhe çmim për njësi pa tvsh: xxxx lekë. Sipas faturës nr. 31, dt. 25.06.2009, me nr. serie 38310946, “Noti” sh.p.k, po këtë automjet ia prokuron autoritetit kontraktor “Gjykatës Kushtetuese”, po në të njëjtën datë dhe me të njëjtin çmim që e ka blerë nga “Classic” sh.p.k, si dhe pas datës së zhvillimit të tenderit (dt. 03.06.2009) dhe pasi është shpallur fitues.
19. Këto skema të nënkontraktimit (furnizimit), janë evidentuar edhe nga ndërmarrjet e tjera objekt hetimi. Shembuj janë si më poshte:
- Me anë të faturave nr. 847, 848, 849, 850, 851, 852, 853 të datës 26.12.2007 Ultra motors sh.p.k ka blerë nga “Classic” sh.p.k automjete Tip. fuoristradë Mitsubishi me vlerë xxx leke (tre prej tyre) dhe xxx leke (katër prej tyre). Nga regjistri i magazinës daljet rezultojnë se me anë të faturave nr. 5,6,7,8,9,10,11, datë 31.12.2007 “Ultra motors” sh.p.k i ka shitur D.P.Tatimeve automjete me vlerë totale xxxx lekë. Sipas shkresës nr. 7/4, dt. 26.01.2010, “Ultra motors” sh.p.k konfirmon se ka paraqitur ofertë në prokurimin e zhvilluar nga D.P. Tatimeve, me 7 automjete Tip. fuoristradë Mitsubishi, me vlerë xxxx lekë secila, që në total bëjnë xxxx lekë, nga rezultojnë se: “Ultra motors” ka blerë automjetet objekt prokurimi nga “Classic” sh.p.k, i cili është ofertuesi jo fitues i këtij prokurimi, dhe i ka lëvruar ato pranë autoritetit kontraktor D.P.Tatimeve me të njëjtin çmim me të cilin i ka blerë duke ruajtur në këtë mënyrë çmimin e rishitjes.
 - Në bazë të faturës nr. 80, dt. 27.08.2007 “Ultra motors” ka blerë nga “Hyundai Auto Albania” një automjet tip. Minibuz 9 vendesh me vlerë xxxx lekë. Në bazë të faturës nr. 4, dt. 08.10.2007 “Ultra motors” i ka shitur Komunës Kashar një automjet me vlerë po xxxx lekë. Sipas shkresës nr. 7/4, dt. 26.01.2010, “Ultra motors” konfirmon se ka paraqitur ofertë në prokurimin e zhvilluar nga Komuna Kashar me një automjet tip. Minibuz me vlerë xxxx lekë. Në këtë mënyrë “Ultra motors” ka blerë automjetet objekt prokurimi nga “Hyundai Auto Albania” sh.p.k dhe i ka lëvruar ato pranë autoritetit kontraktor Komuna Kashar me të njëjtin çmim me të cilin i ka blerë duke ruajtur në këtë mënyrë çmimin e rishitjes.
 - Sipas regjistrimit analitik të blerjeve me artikuj dhe librit të blerjeve, për vitin 2009, rezultojnë që “Ultra motors” të ketë blerë nga “Classic” me anë të faturave nr. 108, 109, 110, dt. 05.02.2009; nr. 138, 139, 140, 141, 142, dt. 16.02.2009, automjete model Mitsubishi Pajero, kodi 004, me vlerë xxxx leke për njësi (pa tvsh); Sipas regjistrimit analitik të shitjeve me artikuj dhe regjistrimit të shitjeve, për vitin 2009, rezultojnë se automjete model Mitsubishi Pajero, kodi 004, i janë shitur Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me anë të faturave nr. 6, 7, 8, dt. 05.02.2009; nr. 9, 10, dt. 23.02.2009 me vlerën xxxx leke për njësi (pa tvsh), pra me të njëjtën vlerë që edhe janë blerë nga “Classic” sh.p.k.
20. Ndërmarrjet nën hetim përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord me përpara se cili do paraqesë ofertën fituese në procesin e prokurimit, ku ata do të jenë

pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët. Vihet re se në rastet kur ofertues janë vetëm Classic, Ultra Motors, Noti dhe Hyundai, ofertat e paraqitura janë shumë afër fondit limit dhe lëvizin shume pak njëra nga tjetra, duke realizuar objektivin e rritjes së ofertës fituese dhe si rezultat dhe shumës që fituesi i ofertës do të marrë. Rritja e ofertës nga ndërmarrjet nën hetim varion nga 95%–99%, afër fondit limit. Ndërsa kur pjesëmarrës janë ofertues të tjerë, (përveç ndërmarrjeve nën hetim), vlerat e ofertave fituese variojnë nga 75% – 89 % të fondit limit, si dhe % e ofertës së ndërmarrjeve nën hetim në raport me fondin limit zvogëlohet. Kështu për shembull:

- Në tenderin e zhvilluar nga ALUIZNI, viti 2007, me fond limit xxx lekë pa tvsh, marrin pjesë Classic dhe Hyundai dhe fiton Classic me 99.6 % të fondit limit (në vlerën xxxx lek pa tvsh) mbështetur nga Hyundai me 99.8% të fondit limit (në vlerën xxxx lek pa tvsh).
- Në tenderin e zhvilluar nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, viti 2007, me fond limit xxxx leke pa t.v.sh marrin pjesë “Ultra motors” dhe “Classic” dhe fiton “Ultra motors” me 100% të fondit limit (në vlerë xxxx lek pa t.v.sh) mbështetur nga “Classic” me 100% të fondit limit (në vlerë xxxx lek pa t.v.sh).
- Në tenderin e zhvilluar nga Porti detar Vlore me fond limit xxxx leke pa t.v.sh, viti 2007, marrin pjesë “Ultra motors” dhe “Classic”, ku fiton “Ultra motors” me 99.9% të fondit limit (në vlerën xxxx leke pa t.v.sh) mbështetur nga “Classic” me 99.9% (në vlerën xxxx leke pa t.v.sh).
- Në tenderin e zhvilluar nga Posta Shqiptare, viti 2007, me fond limit xxxx leke, marrin pjesë “Anas” dhe “Classic” dhe fiton “Anas” me 84% të fondit limit duke marrë pjesë “Classic” me ofertën 89% të fondit limit. Në këtë rast vihet re ulja e ofertës nga ndërmarrja nën hetim.
- Në tenderin e zhvilluar nga Njësia Bashkiake nr. 8 Tirane, me fond limit xxxx leke pa t.v.sh, viti 2008, marrin pjesë “Noti”, “Ultra motors” dhe “Hyundai”, ku fiton “Noti” me 97.6% të fondit limit (në vlerën xxxx leke pa tvsh) mbështetur nga “Ultra motors” me 99.1% (në vlerën xxxx leke pa tvsh) dhe “Hyundai” me 99.7% (në vlerën xxxx leke pa tvsh). Në tenderin e zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese, viti 2008, me fond limit xxxx lekë marrin pjesë “Hyundai Auto Albania” me ofertë xxxx lekë dhe “Noti” me ofertë xxxx dhe fiton “Noti” me 99.6% të fondit limit mbështetur nga “Hyundai Auto Albania” me 99.9% të fondit limit.
- Në tenderin e zhvilluar nga MPPTT, viti 2008, me fond limit xxxx leke marrin pjesë “Noti” dhe “Ultra motors” dhe fiton “Noti” me 99.6% të fondit limit mbështetur nga “Ultra motors” me 99.8% të fondit limit.
- Në tenderin e zhvilluar nga Njësia Prokurimeve pranë Ministrisë së Brendshme, Loti VII, në vitin 2008, me fond limit xxxx leke marrin pjesë “Noti” me 75% të FL, “Ultra motors” me 79 % të FL dhe “Anas” me 85% të FL dhe fiton “Noti” me 75% të fondit limit duke ulur vlerën nga FL. Në rastet e tilla, kur pjesëmarrës në tender janë edhe ndërmarrje të tjera përveç atyre nën hetim, vihet re një ulje e vlerës së ofertës në raport me fondin limit nga ana e ketyre të fundit.
- Në tenderin e zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese, viti 2009, me fond limit xxxx lekë marrin pjesë “Hyundai Auto Albania” me ofertë xxxx lekë dhe “Noti” me

- ofertë xxxx dhe fiton “Noti” me 99.6% te fondit limit mbeshtetur nga “Hyundai Auto Albania” me 99.8% te fondit limit.
- Në tenderin e zhvilluar nga Universiteti Tiranës, viti 2009, me fond limit xxxx leke marrin pjese “Noti” dhe “Hyundai” dhe fiton “Noti” me 99.6% te fondit limit mbeshtetur nga “Hyundai” me 99.8% te fondit limit.
 - Në tenderin e zhvilluar nga Njësia e Prokurimeve pranë Ministrise se Brendshme, Loti IV, viti 2009, me fond limit xxxx leke marrin pjese “Ultra motors” dhe “Hyundai Auto Albania” dhe fiton “Ultra motors” me 98.2% te fondit limit mbeshtetur nga “Hyundai” me 99.6% te fondit limit.
 - Në tenderin e zhvilluar nga Njësia Prokurimeve e Ministrise se Brendshme ne vitin 2009, me fond limit xxxx leke marrin pjese “Porche Albania” me 87%, “Hyundai Auto Albania” me 91% dhe fiton “Porche” me 87% te fondit limit duke ulur vleren nga fondi limit.
21. Ndërmarrjet nen hetim përdorin skemën e ofertës ne rotacion, duke paraqitur ne rrotullim ofertën me te ulet qe te jene fituese, si dhe duke ruajtur dhe rritur pjesën e përbashkët të tregut të këtyre ndërmarrjeve gjate vitit 2008. Gjatë rotacionit % e ofertës fituese është përgjithësisht afër fondit limit, dhe me një ndryshim te vogël ndaj ofertës konkurruese. Kështu për shembull:
- Gjate vitit 2007: “Classic” ka fituar 6 here kundrejt “Ultra motors”, me vlere totale xxx lek – “Ultra motors” ka fituar 2 here kundrejt “Classic” me vlere total xxxx lek.
 - Gjate vitit 2008: “Hyundai” ka fituar 2 herë kundrejt “Noti” me vlere totale xxxx lek – “Noti” ka fituar 6 herë kundrejt “Hyundai” me vlere totale xxxx lek; “Noti” ka fituar 6 herë kundrejt “Ultra motors” me vlere totale xxxx lek – “Ultra motors” ka fituar 2 herë kundrejt “Noti” me vlere totale xxxx lek.
 - Gjate vitit 2009: “Hyundai” ka fituar 4 herë kundrejt “Ultra motors” me vlere totale xxxx lek – “Ultra motors” ka fituar 1 herë kundrejt “Hyundai” me vlere totale xxxx lek.
22. Ekzistenca e shenjave të ngjashme apo të njëjta në dokumentet e dorëzuara në Autoritetet Kontraktore mbi ofertat e “Classik” sh.p.k, “Ultra motors” sh.p.k, “Noti” sh.p.k dhe “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, është një tregues tjetër i marrëveshjes ndërmjet ndërmarrjeve nën hetim. Shenja të tilla të njëjta janë p.sh. gabime drejtshkrimore; vërtetime te lëshuara ne te njëjtën date dhe numra serial te njepasnjeshem nga kompani sigurimi te njëjta; numër protokollit i njëjte, ose i njepasnjeshem; noterizime nga e njëjta notere; përkthime nga persona te njëjte; të njëjtën formulim, formatim, madhësi dhe lloj shkrimi; përfaqësues te njëjte ne prokurime. Kështu për shembull:
- a) Në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor “Njësia Bashkiake Nr.6”, më datë 04.10.2007, me Fond Limit xxx Lek pa t.v.sh, me ofertues: “Hyundai Auto Albania” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; “Ultra motors” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; dhe “Classik” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertuesve rezultuan karakteristika të njëjta, si:
- Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar (për Classic – Ultra motors – Hyundai) ka datë lëshimi të njëjtë për të tre konkurentët – 21.09.2007;

- Vërtetimi i Gjëndjes Gjyqësore (për Classic – Hyundai – Ultra motors) mban të njëjtin Nr. Prot. dhe të njëjtën datë lëshimi - 25.09.2007;
 - Vërtetimi nga Zyra e Përmbartimit (për Classic - Hyundai - Ultra motors) ka datë lëshimi të njëjtë për të tre konkurrentët - 20.09.2007, si dhe Nr. Prot. të njëpasnjëshëm ;
 - Vërtetimi nga Gjykata Tiranës (për Hyundai - Ultra motors – Classic) ka datë lëshimi të njëjtë për të tre konkurrentët - 21.09.2007;
 - Vërtetimi nga Prokuroria (për Hyundai - Ultra motors – Classic) ka datë lëshimi të njëjtë për të tre konkurrentët - 21.09.2007;
 - Vërtetimi nga Tatimet për Shlyerjen e detyrimeve (për Hyundai -Ultra motors) ka datë lëshimi të njëjtë për të dy konkurrentët - 26.09.2007, si dhe Nr. Prot. të njëpasnjëshëm.
- b) Në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor: “Njësia Bashkiake Nr. 8”, Tiranë, më datë 15.08.2008, me fond limit xxxx lekë pa t.v.sh, me ofertues: “Hyundai Auto Albania” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; “Ultra motors” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; dhe “Noti” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertuesve rezultuan karakteristika të njëjta, si:
- Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar (për Noti - Ultra motors –Hyundai) ka datë lëshimi të njëjtë për të tre konkurrentët - 21.03.2008.
 - Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar (për Noti – Ultra motors) data e lëshimit është e njëjtë për të dy këta konkurrentë - 17.06.2008.
 - Formulari i sigurimit të ofertes (për Noti - Hyundai) është lëshuar nga e njëjta Kompani Sigurimi; në të njëjtën datë lëshimi - 15.08.2008; me numër serial të njëpasnjëshëm.
 - Vërtetimi nga Tatimet për Sig Shoq-Shend (për Hyundai -Ultra motors), ka datë lëshimi të njëjtë për të dy konkurrentët - 01.08.2008; si dhe Nr. Prot. të njëpasnjëshëm.
 - Vërtetimi nga Tatimet për Xhiron Vjetore (për Hyundai -Ultra motors) ka datë lëshimi të njëjtë për të dy konkurrentët - 01.08.2008; si dhe Nr. Prot. të njëpasnjëshëm.
 - Vërtetimi nga Tatimet për shlyerjen e detyrimeve (për Hyundai -Ultra motors) ka datë lëshimi të njëjtë për të dy konkurrentët - 01.08.2008; si dhe Nr. Prot. të njëpasnjëshëm.
 - Vërtetim nga Përmbartimi per Hyundai -Ultra motors, data e lëshimit është e njëjta për të dy konkurrentët 16.06.2008 si dhe Nr Prot të njëpasnjëshëm .
- c) Në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor: “Autoriteti Kontraktor – Bashkia Vlorë data 25.05.2009, me fond xxxx Lek pa t.v.sh, me ofertues: “Hyundai Auto Albania” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; “Ultra motors” sh.p.k me vlerë oferte xxxx lek pa t.v.sh; nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertuesve rezultuan karakteristika të njëjta, si:
- Vërtetim nga Zyra e Përmbartimit Hyundai - Ultra motors, data e lëshimit është e njëjta për të dy konkurrentët 21.05.2009 si dhe Nr Prot të njëpasnjëshëm
 - Formulari i cmimit të ofertes, Hyundai – Ultra motors. Tek të dy konkurrentët

- është i njëjti format i tabelës, është plotësuar me të njëjtën formulim të fjalive si dhe ka të njëjtën hapsirë bosh (dy rrjeshta tabelë).
- Formulari i Deklarimit të Ofertës Hyundai -Ultra motors. Tek të dy konkurrentët, është plotësuar me të njëjtin formulim të fjalive, me të njëjtën madhësi dhe tip shkrimi si dhe me të njëjtën hapsirë bosh ndërmjet fjalive me numër rendor .
 - Sasia dhe Grafiku i Levritit Hyundai - Ultra motors. Tek të dy konkurrentët formulari është plotësuar me të njëjtën formulim të fjalive, me të njëjtin format të tabelës dhe me të njëjtin madhësi dhe lloj shkrimi.
 - Deklarata mbi konfliktin e interesit Hyundai - Ultra motors Tek të dy konkurrentët, është plotësuar me të njëjtin formulim të fjalive dhe me të njëjtin madhësi dhe lloj shkrimi.
 - Vërtetim Përkthimit të Marrëveshjes Hyundai. Vërtetimi i përkthimit nga gjuha angleze e marrëveshjes së ndërmarrjes “Hyundai Auto Albania” me shoqërinë “Hyundai Motor Company” është bërë nga punonjesi i cili është drejtor i shitjeve të ndërmarrjes “Classic” sh.p.k.
23. Janë gjetur evidenca direkte, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit midis 4 ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Ultra motors” sh.p.k, “Noti” sh.p.k dhe “Hyundai” sh.p.k. Sipas evidencave të pjesëmarrjes në prokurimet publike si dhe evidencave të marra gjatë inspektimeve, ka shenja të një bashkëpunimi në përgatitjen e ofertave dhe dokumentacionit përkatës për pjesëmarrjen në prokurimet publike midis ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Noti” sh.p.k, “Hyundai” sh.p.k dhe “Ultra motors” sh.p.k. Ky bashkëpunim shfaqet: në formën e shkëmbimit të informacionit të detajuar mbi çmimet dhe specifikimet teknike të automjeteve, gjë që tregon përgatitjen e ofertave nga një punonjës i përbashkët, ose nga një numër punonjësish të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin; në një numër punonjësish të përbashkët të cilët kryesisht, siç ka dalë dhe nga inspektimet, merren me përgatitjen e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike; në dealer të përbashkët me të cilët janë konkurrentë në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja. Këto evidenca direkte tregojnë për ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar në oferta midis ndërmarrjeve nën hetim.
24. Ndërmarrjet “Hyundai” sh.p.k, “Ultra motors” sh.p.k, “Classic” sh.p.k, dhe “Noti” sh.p.k kanë aplikuar skemat e vërtetuara në baze të gjetjeve, sipas metodologjisë së përdorur të OECD, duke shkelur nenin 4, pika 1 të Ligjit, veçanërisht germën a) të kësaj pike.
25. Sa më lart, nga analiza e sjelljes së këtyre ndërmarrjeve në treg, vërtetohet ekzistenca e një marrëveshjeje në oferta³ ndërmjet tyre, e cila në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 4, pika 1, në veçanti germën a), konsiderohet marrëveshjeje e ndaluar, pasi ka për objekt dhe pasojë kufizimin në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në tregun e prokurimit të automjeteve të reja.

³ Marrëveshjet në oferta kanë për objekt dhe pasojë kufizimin e konkurrencës duke koordinuar veprimet e tyre në përgatitjen dhe paraqitjen e ofertave me qëllim pjesëmarrjen efektive në prokurime dhe ritjen e fitimeve.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, nenit 24, shkronja d), nenit 45, pika 1, nenin 74, pika 1, germa “a” dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I :

- I. Mbylljen e hetimit të thelluar për ndërmarrjet “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, “Noti” sh.p.k dhe “Ultra Motors” sh.p.k.
- II. Ndalimin e marrëveshjes në oferta në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja midis ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k; “Ultra motors” sh.p.k; “Noti” sh.p.k; dhe “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, si marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenin 4 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- III. Të gjobisë ndërmarrjen “Classic” sh.p.k, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 25,712,000 (njëzetepesë milionë shtatëqind e dymbëdhjetë mijë) Lekë;
- IV. Të gjobisë ndërmarrjen “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 5,383,000 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë) Lekë;
- V. Të gjobisë ndërmarrjen “Ultra motors” sh.p.k, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 1,517,000 (një milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) Lekë;
- VI. Të gjobisë ndërmarrjen “Noti” sh.p.k, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, në shumën prej 2,994,000 (dys milion e nentëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) Lekë;
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe t’i komunikojë këtë vendim ndërmarrjeve të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

()

()

()

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit te Konkurrencës Nr.154, Datë 01.10.2010 “Për ndalimin e marrëveshjes midis ndermarrjeve “Classic” shpk, “Hyundai Auto Albania” shpk dhe “Ultra Motors” sh.p.k dhe vendosje gjobe ndaj tyre per kufizimin e konkurrencës në tregun e Prokurimeve të Automjeteve të Reja”, kam mbajtur qëndrim kundra, sidomos lidhur me pjesën konstatuese të tij dhe rrjedhimisht edhe me dispozitivin e këtij vendimi. Këtë qëndrimin e mbështes dhe e argumentoj me arsyetimin e mëposhtëm :

A-Përsa i përket qëndrimit ndaj Raportit të Hetimit të Thelluar në Tregun e Prokurimeve të Automjeteve të Reja që në fillim të shqyrtimit nga ana e Komisionit, (sidomos shqyrtimi i Raportit mbi “Hetimin Paraprak ne Tregun e Prokurimeve te Automjeteve te Reja”etj) dhe në vazhdimësi kam shprehur shqetësimin tim mbi:

I) Trajtimin e barabarta ose jo, nga ana e grupit të punës ndaj gjithë firmave nën hetim,

II) Mbi përcaktimin e tregut përkatës

III) Problematikat specifike të tenderimit, përfshi edhe ato të Bid Riging që duhen trajtuar nga APP, apo ne se kemi të bëjmë me kufizimin e konkurrencës që i nënshtrohen akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e konkurrencës se lirë dhe efektive në treg?!

Qendrimin e shoqëruar edhe me voten time kundër po e argumentoj duke u mbështetur në këto tre elemente kryesore:

I-Është e tepert të nenvizoj se konkurrenca dhe sidomos mbrojtja e saj kërkon rregulla të barabarta loje dhe nje Autoritet Konkurrence qe funksionon si arbiter per rregulla te barabarta loje. Por, si është realizuar kjo barazi, si janë realizuar këto rregulla të barabarta loje nga ana e Grupit te Punës që ka realizuar monitorimin dhe hetimin e këtij tregu ?

Mbështetur në dosjet hetimore, rezulton se monitorimi i këtij tregu dhe më pas Hetimi i tij nga ana e Sekretariatit, është nisur nga shenjat e vërejtura gjatë tenderit për blerjen e një autoveture nga ana e Autoritetit të Konkurrencës në vitin 2008, nga ku është konstatuar se “Nga monitorimi i realizuar në Tregun e Prokurimeve të Makinave të Reja nga Sektori Anti-Kartel te Autoritetit të Konkurrencës, si dhe shqyrtimi i dosjes së Autoritetit të Konkurrencës për blerje Autoveture të Re për vitin 2008 rezulton se vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës në të paktën dy procedura prokurimi si vijon:

I. Në tenderin e zhvilluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me objekt “Blerje Autoveture” me fond limit xxxx lekë, datë 02.05.2008 dhe 11.09.2008 kanë marrë pjesë ndërmarrjet “Hyndai Auto Albania” sh.p.k dhe “Ultra motors “ sh.p.k me shkeljet :

- Autorizimi për pjesëmarrje ne tender është në të njëjtën datë me të njëjtat gabime drejtshkrimore ku me date 02.05.2008 ndermarrja Hyndai autorizon Z. D.Gj për të marrë pjesë në tenderin e zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës, ndërsa ndërmarrja “Ultra motors” autorizon Z. A.M. në autorizimin e zhvillimit të tenderit te ri në shtator 2008 përfaqësuesi i Hyundait për tenderin e parë paraqitet për “Ultra motors” dhe përfaqësuesi i “Ultra motors” për tenderin e pare paraqitet per “Hyundai”;
- Data e printimit (e njejte) të ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëria me përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k ” datë 20.03.2008 dhe noterizuar nga i njëjti person, ka të njëjta gjurmë dhe shënja të printimit;

- Raporti i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën Janar-Dhjetor 2007 është bërë nga i njëjti auditues, me të njëjtin lloj shkrimi, editim dhe vërtetuar njësimi me origjinalin nga i njëjti noter;
- Oferta e ofruar është për të dyja në të njëjtën datë me 02.05.08 perdoret i njëjti konceptim i ofertës së ofruar;
- Formulari i përshkrimit të firmave i hartuar me 02.05.08 për të dy firmat, formulari është në të njëjtin përshkrim, editimi është i njëjtë ka ndryshuar vetëm lloji i shkrimit në të dy format nuk ka justikimin data është me nënvijëzime , hapësira është e njëjtë paragrafi i parë nga i dyti;
- Formulari i çmimit të ofertës është i njëjti format, me të njëjtin shkrim, me të njëjtin përmbajtje;
- Çmimi në total të gjithë elementet e tjerë të ofertës janë të njëjta, me të njëjtat gabime ortografike si përdorimi i ‘e’ në vend të ‘ë’, si dhe gjurmët e fotokopjimit dhe prinitimit janë të njëjta;
- Njoftimi i mosvleresimit të mjetit, i bërë nga të dyja ndërmarrjet megjithëse në data të ndryshme, elementet e shkresës janë të njëjta. Arsyetimi i moslëvrimit të mallit është i njëjtë;
- Sasia dhe grafiku i lëvrimit është i njëjtë në konceptimin pothuajse e njëjte në editim me të njëjtat gjurmë printimi me të njëjtat gabime shtypshkrimi, vetem me pak ndryshime boldimi;
- Duke analizuar ofertat me fondin limit rezulton se ofertat janë afër fondit limit dhe të dy ofertat pothuaj në të njëjten përqindje 98.8 dhe 99.4
- Bazuar në Ligjin Nr 9121, date 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës “ dhe në bazë të metodologjisë së OECD” Fighting Cartel in Public Procurement”, elementet e mësipërm japin elementet e një sjellje të koordinuar në tenderat publike në kuptimin e nenit 4 të Ligjit” Për mbrojtjen e konkurrencës”⁴

II. Nga analiza e konkurrencës së tenderave të makinave të reja me prokurime publike për fondin limit xxxx leke, të zhvilluar nga Ministria e Brendshme date 23.10.2008, u konstatuan kufizime të konkurrencës bazuar në :...⁵

Mbi këtë bazë, me nismën e Sekretarit të Përgjithshëm ,filloi procedura për monitorimin e tregut të makinave dhe më 08/07/2009 u vendos: “Fillimin e procedurave të hetimit paraprak në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja” me objekt – hetimi, nëse ka “kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e prokurimeve publike të automjeteve të reja” “ për të parë nëse ka apo jo ndërmarrje, që kryejnë veprime apo sjellje me elemente antikonkurrese, të cilat bien ndesh me Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Pa patur asnjë paragjykim se hetimi mund të fillohet edhe nga një shkas i tillë, posaçërisht në këtë rast merrte dhe merr një rëndësi të posaçme çështja e trajtimit të problematikes së konstatuar në kohë, objektivitet dhe me një qëndrim të barabartë të të gjithë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e marrë nën hetim. Në këtë kuadër lind natyrshëm:

⁴ Shih dosja nr 1 e prokurimeve të makinave të reja dokumenti nr 9

⁵ Po ajo dosje.

a) Çfarë është bërë kur gjatë tenderit për blerjen e makinës së re nga Autoriteti i Konkurrencës si klient, kur nga punonjësit e institucionit është kaluar i gjithë dokumentacioni ku janë mishëruar të gjithë qëndrimet e mësipërme të ofertuesve? Cilat kanë qenë pasojat e veprimeve të mësipërme të ofertuesve, përfshi këtu çmimin e makinës së re të blerë nga ana e Autoritetit të Konkurrencës apo ndikime të tjera? Duke u nisur nga sa me sipër lindi pyetja: a është bashkëpunuar nga ana e Sekretariatit si klient për blerjen e makinës së re me autoritetin përkatës të prokurimeve publike që trajton shkeljet gjatë prokurimeve publike? Nga hulumtimi i dosjeve, rezultoi se nuk ka patur asnjë ankesë ose bashkëpunim me Autoritetin e Prokurimeve Publike, për eliminimin sa më shpejt të praktikave dhe qëndrimeve të mësipërme.

Njoftimi i APP, për qëndrimet e mësipërme të firmave ofertuese, duhej dhe duhet bërë sa më shpejt, pavarësisht nga hetimi dhe rezultatet e hetimit të kësaj çështje nga ana e Autoritetit të Konkurrencës. Edhe une i përmbahem mendimit të shprehur nga koleget komisionerë se “Metodologjia mbi bazën e të cilit është studiuar dhe hetuar është një metodologji e sakte ... Në fakt metodologjia si e kam kuptuar është në ndihmë të punonjësve të prokurimeve publike për të dedektuar bid rigging, sepse pasi shpjegon të gjitha rastet kur mund të ketë bid rigging, thotë perfundimisht mund të ketë shenja dhe këto shenja i duhen oficerëve të prokurimit publik... Në të gjithë prokurimet që unë kam parë që janë ofruar, të gjitha makinat janë marrë nëpërmjet procesit të nënkontraktimit”

b) Krahas mos trajtimit të barabartë në formën e mos hetimit të plotë të procesit të nënkontraktimit të të gjithë firmave në tregun e marrë nën hetim, nuk është vështirë të konstatohet se shenja të konstatimeve të mësipërme si ato të afersisë të vlerës së ofertave fituese me vlerën limit që ka evidentuar grupi i punës për firmat nën hetim dhe gjatë, iu perkasin edhe firmave të tjera.

- Keshtu Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës është vënë para sfidës reale që të zbatojë rregulla të njëjta loje për të gjithë ndërmarrjet në treg duke realizuar në kohë mbrojtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lire dhe efektive në treg, apo të mbajë një trajtim të diferencuar duke u kthyer thjesht në një gjobëvënës, dhe këtu të fundit ta kthejë në qellim në vetvete, pa zbatuar rregulla të njëjta loje gjatë procesit të hetimit pa u interesuar për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive sa më shpejt në këtë ose atë treg ?!

Por cilat janë disa nga elementet e mbajtur nga grupi i punës në këtë proces?

- Se pari. Mbas kalimit në hapjen e hetimit paraprak Grupi i punës përcaktoi me vetedije si metodologji që “Znj. X Y do të mbledhë informacionin lidhur me ofertat dhe fitues për periudhën 2008-Qershor 2009 nga faqja zyrtare e APP(online) deri në një moment me qëllim moskompromentimin e hetimit për marrje informacioni në rrugë të tjera”⁶. Pra ky informacion është mbledhur apriori për t’u trajtuar formalisht thjesht si “mbulës”, pavarësisht në se përmban apo jo prova për shkelje të mundshme të konkurrencës në treg.
- Në dosjen hetimore nr 1 ndodhet file me nr 19 me këto informacion, por ishte pa koke (kur iu kërkua grupit të punës se çfarë përfaqëson ky dokument u bë shënimi : Të dhëna të nxjerra nga faqja e internetit APP www.app.gov.al). Dokumenti është 16 faqesh dhe përmban informacionin për ofertat dhe fituesit për çdo tender nga data 06/08//2008 deri në 16.07.2009, në zbatim të detyrës së lënë në procesverbalin e sipërpërmendur.

⁶ Shih Procesverbal I grupit të punës dt 21.07.09

- Ky dokument me nr 19 ne dosjen nr 1 te hetimit paraprak mbi Ofertat e Publikuara nga APP, nuk eshte trajtuar nga grupi i punës, për të parë nëse praktika të realizuara nga ndërmarrjet e përcaktuara në hetim janë realizuar edhe nga ndërmarrje të tjera. Ky dokument permban informacionin per 65 tendera ne nje kohe kur numuri i tenderave i realizuar gjate tre vjeteve te periudhes në hetim është shumë më i madh. Pra në vend të përdorej edhe ky dokument si bazë për hetim objektiv ai është përdorur në fakt thjesht për “mbulese”.
- Në këtë dokument provohet se shprehja “ Duke analizuar ofertat me fondin limit rezulton se ofertat janë afer fondit limit dhe te dy ofertat pothuaj në të njëjtën përqindje 98.8 dhe 99.4” nuk është një dukuri e izoluar vetëm për ndërmarrjet që do hetoheshin dhe gjobiten, por është një dukuri dhe per tendera të tjerë. Duke studjuar vete tenderat e pare ne dosjen ne fjale dhe duke perjashtuar ndermarrjen nen hetim per te cilat eshte vendosur gjobe rezulton sa me poshte:

Nr	Nr rendor i tenderit ne dokument	Fondi limit	Oferta fituese	Oferta Konkurruese	Oferta fituese e konkurruese ndaj asaj limit
1	3	4 569 973	4 500 000	4 560 000	98.46;99.78
2	4	1 400 000	1 380 000	1 390 000	98.57; 99.28
3	7	1 500 000	1 494 000	1 499 500	99.6;99.96
4	8	1 200 000	1 190 000	1 195 000	99.16;99.58
.....					

.....

Pra kjo dukuri nuk është e izoluar. Por hetimi nuk është shtrirë në këtë drejtim. Pra trajtimi i firmave nën hetim në tregun e prokurimeve të reja është bërë me vetedije nga ana e grupit të punës në mënyrë të pabarbartë.

Duke qënë dakort me atakimin ndaj bid rigging –manipulimit të ofertave në prokurimet publike, nuk mund të jem dakort me praktikën e vetëdijshme të trajtimit selektiv të tyre, kur shenjat flasin se këto praktika janë zbatuar edhe nga firma të tjera. Nderkohe keto shenja te manipulimit te ofertave mund te luftohen ne menyre efektive vetem kur trajtohen rast pas rast pa perjashtur kend.

Në këtë kuadër dhe kolegët Komisionere kanë kërkuar kriteret e përzgjedhjes se firmave nën hetim që mund të kenë manipuluar në tenderat publike dhe unë e kam mbështetur kete kerkese në vazhdimësi duke kerkuar që grupi i punës ti trajtojë te gjitha firmat ne mënyrë të barabartë. Por ndërsa nga grupi i punës në rafshin praktik dhe keshilltari ligjor i Komisionit, edhe në rafshin interpretativ lidhur me çështjen ”Mbi ruajtjen e barazisë ligjore në inspektimet e kryera në kuadër të hetimit paraprak në tregun e Prokutimit të Automjeteve të reja”⁷: mbahet ky qendrim:Lidhur me “...parimin e barazisë para ligjit kuptohet trajtim i njëjtë në situata të njëjta apo të ngjashme dhe trajtim i ndryshëm në situata të ndryshme. Duhet pasur parasysh se trajtimi i papabarabarte ne shkelje te ligjit

⁷ Memo e dates 2009-12-21

nuk gëzon mbrojtje ligjore në sistemin shqiptar, pra askush që ka shkelur ligjin, nuk mund të pretendojë ti shmanget pëgjegjësisë penale apo administrative sepse autoriteti publik nuk ka arritur të gjejë dhe të dënojë shkelës të tjerë të ligjit”.

Në vend të zbatimit të procedurave të njëjta për të gjithë pra një hetimi i plotë ndaj gjithë firmave nën hetim dhe sidomos ndaj atyre që kanë reflektuar shenja të manipulimit të tenderave, parashikohet dhe mbahet me vetedije një hetim dhe procedura selektive. Qëndrimi im është se Autoriteti i Konkurrencës duhet të realizojë rregulla të njëjta loje për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Procedurat selektive të realizuara nga grupi i punës provohen edhe me një argumentin tjetër. Në planin e veprimeve në zbatim të vendimit nr 246 datë 08.07.2009 për hapjen e hetimit paraprak parashikohet midis të tjerash

- Inspektim i formës Down Ride do të fillohet aty ku është fitues më i madh i tenderave dhe ku ka me shumë element paraprak që aty janë formuluar ofertat.
- “Leandro Noti” dhe “Ultra motors” duke qënë se të dy kanë qënë pjesëmarrës në të paktën dy tendera dhe njëherë ka fituar njëri dhe njëherë ka fituar tjetri.
- “Hyundai” duke qene se në disa tendera ka marrë pjesë me “Leandro Noti” me dy oferta si dhe afer fondit limit me 96 % në dy lote njëherë ka fituar njëri dhe njëherë ka fituar tjetri.
- “Anas sh.p.k” dhe “Proche Albania” pasi kanë një rregullshmëri në ofetat e paraqitura.
- Tek “Noshi sh.p.k” pasi nuk ka fituar asnjehere për të parë bashkëpunimin që ka me të tjeret ose arsyen që ai nuk është fitues asnjëherë, Kompania paraqet disa herë oferta por nuk fiton.

Kujtoj se ky përcaktim është që në fillim të hetimit paraprak. Në firmën e fundit ka patur dhe ka vetëm pyetësor, por jo inspektim siç është parashikuar në planin e veprimit (Inspektim i formës Dawn Raids do të fillohet aty ku është fitues më i madh i tenderave). Duhet thënë se kjo është firma që ka patur fituar tenderin me vlerën më të madhe të makinave në prokurimin publik të vitit 2009, në datë 01.09.2009 kur janë shlyrtuar ofertat, që është publikuar në Buletinin Zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Qëndrimi im ka qënë i qartë dhe në mbledhjen e datës 21.12.2009, mbledhje e Komisionit të Konkurrencës për shqyrtimin e “Raport për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të makinave të reja” kam mbajtur këtë qëndrim: I mbetem shqetësimit të ngritur në mbledhje. Në tenderat në Shqipëri ka shkelje të ligjit, por kjo kërkon përcaktim të sakte. Në si Autoritet po futemi në rrugë të gabuar, në vend që të ndihmojmë tregun të mirëfunksionojë po krijojmë probleme të tjera. Nëse ndërhyrja është selektive në vend të ndihmojmë në zgjidhjen e problemit do ta agravojmë atë... në vend të vemë vetulla kemi për të nxjerrë sytë”.

Gjate hulumtimit të dosjeve rezulton se në dosjen e hetimit paraprak nr.1 ndodhet file me nr 26 ku konstatohet se Z.A.P është zotërues i 100 % të aksioneve në “Ultra Motors” sh.p.k dhe në të njëjten kohë edhe tek “Classic” sh.p.k. Në raport nuk kam parë të trajtohet një çështje e tillë, implikimet që ka patur dhe ka kjo në tregun e makinave të reja dhe në tregun e prokurimit të makinave të reja, por sidomos për rivendosjen e konkurrencës së

lire dhe efektive ne tregun e prokurimit te makinave te reja.

Pra sa nga me sipër te krijohet ideja se ky hetim eshte ndermarre nga qejfmbetjet e punonjesve te Autoritetit te Konkurences me ndërmarrjen “Hyundai” sh.p.k nga blerja e makines se institucionit dhe për këtë unë nuk dua të bëhem pjese e kësaj vendimmarrje, i shtyrë nga konflikti i interesit. Une do te behesha pjese e kesaj vendimarrje nese hetimi pavaresisht nga fillesa do siguronte në vazhdimësi, procedure dhe një hetim të barabarte të gjithë ndërmarrjeve në këtë treg, duke evidentuar se nga ky hetim i barabartë dhe i plotë.

Lidhur me sa me sipër grupi i punës duhej të ishte më transparent.

Se dyti. Nuk jam dakort me përcaktimin evaziv të tregut përkatës.

a) Tregu i makinave ne Shqiperi sic dihet përbëhet nga disa lloj tregjesh, tregu i makinave të vjetra, tregu i makinave (automjeteve) të reja, dhe tregu i prokurimit të makinave të reja.

Është i njohur që tregu i makinave të vjetra është një treg i parregulluar dhe i pakontrolluar, ndërkohe dhe është tregu me i madh. Krejt ndryshe ndodh në tregun e makinave te reja, i cili për vetë natyrën e saj është një treg i kontrollueshëm nga organet shtetërore (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti i Konkurrencës etj). Raporti midis këtyre dy tregjeve në numër makinash është rreth raporteve 10:1; 9:1; 8:1; ne favor te tregut te makinave te vjetra. Shoqata të ndryshme që janë të lidhura me këtë treg (të makinave te reja) si Dhoma Gjermane e Tregëtisë, kanë kërkuar ndihmesën e organeve shtetërore për të luftuar Konkurrencën e Pandershme në këtë treg, duke ftuar vazhdimisht në këto takime edhe Autoritetin e Konkurrencës.

Në kushtet kur nuk vihet re asnje angazhim serioz ndaj tregut te makinave te vjetra apo ndaj shqetësimeve në tregun e makinave të reja, hapet me iniciativën e Sekretariatit hetimi në tregun e prokurimeve publike të makinave të reja.

Duhet thënë se tregu i prokurimeve publike në vlerë, ndaj tregut të makinave të reja për periudhën e marrë nën hetim ka qënë respektivisht ndaj xxxx leke ndaj xxxxx lek në vitin 2007 ose 6.82 përqind; xxxx lek dhe xxxxx leke në vitin 2008 ose 5.66 përqind, dhe xxxx lek në vitin 2009 nga xxxx leke ose 11.57 perqind . Pra kur u hap hetimi niveli sasior i ketij tregu ka qënë dukshëm nën 10 perqind të tregut te makinave te reja dhe shumë më i vogël në krahasim me tregun e makinave në Shqipëri.

Ndërkohe midis tregut të makinave të reja dhe tregut të prokurimit publik të makinave te reja ka disa dallime jo te vogla. Nisur nga numri i firmave qe operojne në tregun e makinave të reja rezulton se ky treg i përket struktures se konkurrencës monopoliste. Kjo strukturë tregu ndonëse është pjesë përbërëse e formave te tjera te konkurrences jo të plotë perfaqëson një strukturë tregu të afert me konkurrencën e plotë, por qe ka edhe disa tipare që e dallojnë nga ajo. Kryesorja është diferencimi i produktit, te realizuar si nëpërmjet cilësisë së tij, imazhit, shërbimeve dhe një kontroll i kufizuar i çmimeve. Ky kontroll i kufizuar i çmimeve mbartet dhe në tregun e prokurimit publik të makinave të reja i cili është një treg i rregulluar dhe ndëkohë ku kufizohen dukshëm disa elemente të konkurrimit te lirë karakteristike për këtë produkt sic janë marka, imazhi etj.

U ndala në dallimin midis tregut të prokurimit publik të automjeteve të reja, nga tregu i shitjes së lirë të tyre, se siç del nga ky hetim, problematika e parregullsive në tregun e parë është mjaft më e përhapur se sa në ato që është ndalur grupi i punës.

Në këto rrethana trajtimi i skemave të nënkontraktive të parregulltata vetëm për disa, duke përjashtuar të tjerat nuk i shërben as mbrojtjes dhe rivendosjes së konkurrencës në tregun e prokurimeve publike të makinave të reja, por mund të shërbejë si mjet për daljen e ndërmarrjeve të caktuara nga tregu.

Nderkohe të bie në sy se firma me fuqinë më të madhe në tregun e makinave të reja zë vetëm deri në 15.81 % të tregut, duke krijuar premisa për një konkurrencë të lirë, efektive dhe të ndershme në treg. E rëndësishme është që ky treg të mbrohet nga konkurrenca e pandershme, sic është edhe shqetësimi i aktorëve të tij, nga firma dhe individë fantazëm, pa përjashtuar shkeljet e tjera të konkurrencës së lirë dhe efektive.

b) Në pikën 6.1 përcaktimi i tregut përkatës, në pikën nr. 42 tregu përkatës i produktit përcaktohet “ Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg do të konsiderojmë treg përkatës produkti, tregun e automjeteve të reja që ofrohen për prokurim publik.

Duke iu përmbajtur këtij përkufizimi nuk mund të mos të bjerë në sy se firma me nr.28 në tabelën 4 faqe 26 të raportit e cila kap 49.88 % të tregut të automjeteve të reja që ofrohen për prokurim publik në vitin 2009, dhe që ka fitur tenderin me vlerën më të madhe gjatë periudhës të marrë nën hetim një vlerë në tender prej xxxx lek, me efekt të drejtperdrejte dhe në zgjerimin e sferës në tregun e makinave të reja, nuk i është nënshtruar inspektiveve dhe hetimit të plotë (qofte në fazën e hetimit paraprak) përveç intervistimit në formë pyetësi.

Ndërkohe lidhur me këtë treg grupi i punës përjashton hulumtimin e tij në tregues fizik edhe kur kërkohet kjo analize që është realizuar gjatë hetimeve të tjera të realizuara nga Autoriteti i Konkurrencës.

Përcaktimi i tregut përkatës nuk është qëllim në vetvete, por i nevojshëm për të gjykuar fuqinë e tregut dhe nga kjo për të hetuar sjelljen e firmave në treg. Krejt ndryshe është vepruar nga grupi i punës kur u konstatua rritja e fuqisë së tregut nga ndërmarrja e sipërpermendur, që nuk i është nënshtruar hetimit.

Ndërkohë në trajtimin e tregut përkatës në raport evidentohet në pika 6.1.1 pikën nr.41 se “Duke u bazuar në kriterin e zëvendësueshmërisë, si kriteri kryesor në përcaktimin e tregut përkatës, produkte të zëvendësueshme që mund të marrin pjesë në prokurimet publike për blerje automjete të reja, janë të gjitha llojet e automjeteve të reja që ofrohen nga shoqëritë koncesionare të automjeteve të cilat plotësojnë specifikimet teknike që kërkohen në një prokurim publik të organizuar nga ana e një autoriteti kontraktual”.

Natyrisht ky element është shumë i rëndësishëm, thelbësor në tregun e prokurimeve publike të makinave të reja. Pjesëmarrja në këtë ose atë tender përcaktohet nga këto specifikime. Por pavarësisht se jepet ky përkufizim tregjet përkatës me këto ose ato specifikime teknike, lista e tyre nuk jepet, dhe në raport nuk i nënshtrohet analizës dhe hetimit të sjelljes së firmave në secilin nga këta tregje përkatës, për të gjykuar se si kjo ose ajo sjellje e firmave në tregun dhe tregjet përkatës të prokurimit publik të makinave të reja është keqpërdorur për të rritur pjesën e tregut në tregun e makinave të reja apo për të rritur padrejtesisht cmimet dhe fitimin.

Kështu përcaktimi i tregut përkatës në të dy rastet mbetet qëllim në vetvete dhe jo zanafille e hulumtimit dhe hetimit.

Pra nuk ka dalë përkufizimi i tij në se është ai i pokurimeve të makinave të reja apo për cdo tender. Nga ana tjetër e kam shprehur edhe proces-verbalin e mbledhjes vendimmarrëse se problemet specifike të një tenderi kur numri i automjeteve është 1 janë jashtë sferës së fushe-veprimit të ligjit dhe institucionit të Autoritetit të Konkurrencës.

III-Manipulimi i ofertave nga ndermarrjet pjesëmarrëse në tendera, ose tenderat “collusion” nuk është qëllim në vetvete, por ndryshe nga pritja për të konkurruar, komplotohet fshehurazi për të rritur tregun, çmimin ose për të ulur cilësinë e mallrave dhe shërbimeve nëpërmjet manipulimit të procesit të tenderimit. Kjo është artikuluar mjaft qartë edhe në udhëzimin për luftën kundër manipulimit të ofertave në prokurimet publike, për të cilin pretendohet se është zbatuar nga grupi i punës gjatë këtij hetimi .

Dallimi midis marrëveshjeve në tender në se janë në trajtën e manipulimit në tender për përfitime të caktuara të padrejta (si rritja e peshës që ze ndermarrja në tregun e lirë, çmim më të lartë, etj), proceseve të nënkontraktimit që parashikohet në ligjin e prokurimeve publike (ligji i prokurimit parashikon nënkontraktimin, por brenda disa rregullave që duhet të zbatohen si ajo e deklarimit në autoritetin kontraktor dhe nuk duhet të kalojë 40 % e mallit që prokurohet) apo thjesht për pjesëmarrje për të plotësuar numrin e nevojshëm të pjesëmarrësve në tender, sidomos në rastet kur numri i makinave në tender është vetëm 1 përbënte një nga sfidat e këtij hetimi. Edhe në rastin e fundit kemi një marrëveshje në ofertë, madje edhe e “fshehtë”, por kjo nuk presupozon për mendimin tim se këtu duhet të kufizohet dhe të përfundojë analiza dhe hetimi paraprak apo i thelluar në tregun e prokurimit publik të makinave të reja. Analiza e faktit se sa kjo apo ajo marrëveshje në ofertë përben shkelje të ligjit të prokurimeve publike apo të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, do të ishte e plote se sigurohet njohja e fitimit të paligjshëm të ndermarrjeve nën hetim. Kjo ka rëndësi të posaçme për vendosjen dhe sigurimin e konkurrencës si në tregun e prokurimeve publike po ashtu dhe në atë të makinave të reja..

Në këtë këndvështrim, duke patur parasysh tre ndermarrjet kryesore, të cilat i janë nënshtruar hetimit të thelluar kanë patur këtë ecuri në tregun e makinave të reja (një nderndikimet e marrëveshjeve në oferta midis tyre) :

- dy firma kanë patur stanjacion me një rënie të vogël gati të paperfillshme nga viti 2007 në vitin 2008 dhe 2009 dhe për një firmë stanjacion në vitin pasardhës me një rritje jo më shumë se 1.6 % në vitin 2009, në tregun e makinave të reja

- se niveli i çmimeve në tregun e prokurimit publik të ndermarrjeve nën hetim është i njëjtë ose më i ulët se sa në tregun e lirë të makinave të reja

- se firma katërt ka shërbyer si “dealer” i njërit nga tre firmat e marra nën hetim por dhe

- ndërkohë nga grupi i punës nuk jepet asnjë informacion se sa është numri i makinave të shitura për secilën nga këto firma në tregun e prokurimeve publike, apo për analizen në terma fizike të tregut përkatës, mbështetur në gjithë trajtesën e mesipërme kam dalë në konkluzionin se:

Përsa i përket këtij raporti, si dhe paraqitjes skematike që ju bë atij nga grupi i punës në mbledhjen e radhës së Komisionit, u evidentua se grupi i punës, përmes raportit nuk ka qenë në gjendje t’i japë përgjigje shqetësimit të Komisionit të Konkurrencës dhe kryesisht shqetësimit tim në lidhje me problematikën e këtij tregu dhe sidomos formave se si duhet të arrihet rregullimi i këtij tregu, ndaj nga kjo pikepamje fakti që grupi i punës nuk ka

sjelle propozim për këto probleme me shtyn që të tregohem i rezervuar në konkluzionet përfundimtare të grupit të punës, elemente këto që janë anashkaluar dhe nuk janë marrë në konsideratë nga anëtarët e tjerë të komisionit.

Propozimi im në këtë pikë ka qenë që të shihej mundësia, përpara vendimmarrjes për një mbledhje, ose tryezë të rrumbullakët me autoritetet përkatëse, aq më tepër kur në këtë drejtim nuk ka pasur asnjë hollësi nga grupi i punës se kush janë institucionet e linjës me (me pretekstin se ka pasur ndryshime në radhët e tyre) dhe me të cilat paraprakisht duhej të ishte marrë kontakt dhe më pas mundësisht mendim i zyrtarizuar prej tyre, konkretisht nga Avokati i Prokurimeve. Lidhur me konstatimet kam kërkuar që raporti i grupit të punës të ishte më transparent në evidentimin e gjërave dhe me gjithë insistimet e mia këto nuk janë marrë në konsideratë dhe raporti ka dalë i mangët

Sa më sipër duke mos qenë pothuaj tërësisht dakord me vlerësimin e fakteve të bëra në argumentet e pjesës konstatuese të vendimit, hartuar nga shumica, nuk mund të jem dakord dhe të miratoj dhe dispozitivin e këtij vendimi i cili është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e atyre konstatimeve.

Prandaj çmoj që për përmbajtjen e vendimit të jap votën kundër.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Koço BROKA

Anëtar



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 155, Datë 28.10.2010

“Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”

Komisioni i Konkurrencës:

Pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit i Përgjithshëm dhe të raportit “Monitorimi i tregut të importit të sheqerit dhe orizit për periudhën janar 2009-gusht 2010” të kryer në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar

V Ë R E N S E:

Nevojat konsumatoreve për oriz sigurohen vetëm nëpërmjet importit të këtij produkti nga vendet e tjera. Konsumi vjetor i orizit është rritur rreth 23% gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin 2008.

Tregu i importit të orizit sipas tre nënprodukteve (kokërrgjatë, kokërrmesëm dhe kokërrumbullaket) është shumë i përqendruar dhe dominohet nga tre ndërmarrje importuese dhe të tregtimit me shumicë.

Ndërmarrjet që operojnë në këto treg janë të orantuara në importin e një nënprodukti orizi.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 Tetor 2010.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 15 janar 2011

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 156, Datë 28.10.2010

“Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”

Komisioni i Konkurrencës:

Pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe të raportit “Monitorimi i tregut të importit të vajit ushqimor, janar 2009-gusht 2010” të kryer në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar

V Ë R E N S E:

Kërkesat për vaj në tregun shqiptar sigurohen nga tregu vendas dhe ai i importit. Vaji i importuar mbulon rreth 70% të kërkesës në treg.

Nga të dhënat e importit të vajrave rezulton se importohen rreth 11,6 milion litra vaj i papërpunuar i cili zë 43.8% të totalit të vajrave të importuara për vitin 2010. Importi i vajit të papërpunuar shërben si lende e parë për industrinë e përpunimit të vajit.

Nga analiza e tregut të importit të vajit vegjetal rezultoi se tregu i vaji vegjetal është shumë i përqendruar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 42, pika 1 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 Tetor 2010.
3. Ngarkohet sekretari i përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 15 janar 2011.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 157, Datë 28.10.2010

“Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”

Komisioni i Konkurrencës:

Pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit i Përgjithshëm dhe të raportit “Monitorimi i tregut të importit të sheqerit dhe orizit për periudhën janar 2009-gusht 2010” të kryer në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar

V Ë R E N S E:

Kërkesat konsumatore për produktin sheqer mbulohen vetëm nga importi. Gjate vitit 2009 vihet re një rënie me rreth 49% e sasisë së importuar në krahasim me vitin 2008 .

Tregu i importit të sheqerit përbëhet nga dy ndërmarrje kryesore që zënë pjesën më të madhe të tregut, rreth 87% që reflekton një Indeks të Përqendrimit shumë të lartë.

HHI-ja gjatë vitit 2009 dhe periudhës janar-gusht 2010 është shumë e lartë, përkatësisht 4075 dhe 3747 duke na treguar për një treg me përqendrim shumë të lartë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 42, pika 1 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 Tetor 2010.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 15 janar 2011.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 158, Datë 12.11.2010

“Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve ne oferta ne Prokurimet Publike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.11.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënia e rekomandimeve për kuadrin ligjor te prokurimeve publike, me qëllim parandalimin e Marrëveshjeve në Oferta

Baza ligjore: Neni 24, germa d) e f), neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimeve automjeteve të reja”; Raportit mbi “Disa rekomandime për zbulimin dhe luftimin e marrëveshjeve ne oferta në Prokurimet Publike” dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm; si dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Agjencinë e Prokurimit Publik dhe Planit të Veprimit në luftën ndaj marrëveshjeve të ndaluara në oferta dhe korrupsionit.

V Ë R E N S E:

Marrëveshjet e ndaluara në oferta ndodhin kur ndërmarrjet (operatorët ekonomikë), te cilët pritet të konkurrojnë, në mënyrë të fshehtë bien dakord për rritjen e çmimeve ose uljen e cilësisë së mallrave apo shërbimeve për blerësit, të cilët dëshirojnë të sigurojnë produktet dhe shërbimet nëpërmjet një procesi prokurimi.

Një proces konkurrues mund të sigurojë çmime të ulëta, cilësi më të mirë dhe risi, vetëm

nëse ndërmarrjet (operatorët ekonomikë) konkurrojnë me të vërtetë, duke i vendosur kushtet dhe kriteret e tyre me ndershmëri dhe në mënyrë të pavarur.

Marrëveshjet e ndaluara në oferta mund të bëhen në veçanti të dëmshme, nëse ato prekin prokurimet publike. Këto marrëveshje sjellin pasoja për blerësit dhe taksapaguesit, ulin besimin publik në një proces konkurrues dhe zvogëlojnë përfitimet nga një treg konkurrues.

Marrëveshjet e ndaluara në oferta janë praktika të ndaluara në të gjitha vendet pjesëmarrëse të OECD-së, si të tilla hetohen dhe sanksionohen sipas ligjit dhe rregullave të konkurrencës.

Bazuar në nenin 4 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” marrëveshjet në oferta janë marrëveshje të ndaluara, pasi ato kufizojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Procedurat e prokurimeve publike rregullohen nga Ligji nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Bazuar në nenin 13, pika 3, të këtij ligji, APP përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për rastet e përcaktuara në këtë pikë, për vetë rëndësinë e shkeljes së tyre.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm midis APP dhe AK është i domosdoshëm me qëllim rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit të prokurimeve publike; parandalimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike; ndërgjegjësimin e bizneseve dhe publikut për luftimin e marrëveshjeve në oferta; ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve në tenderë për pasojat e marrëveshjeve në oferta; zbulimin dhe raportimin e shkeljeve të rasteve të mundshme në procedurat e prokurimit;

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. Ti rekomandoje Agjencisë së Prokurimit Publik, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë, për:
 1. Amendimin e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 13, pika 3, sipas se cilës APP përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit për një periudhë 1-3 vjet për rastet e propozuara sipas germave a, b, c, ç të kësaj pike, ku të shtohet, germa d, me përmbajtje si vijon:
 - “d) Për rastet kur me Vendim të Komisionit të Konkurrencës është zbuluar ekzistenca e një marrëveshjeje në oferta midis operatoreve ekonomike pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve” .
 2. Në kuadrin ligjor të fushës së Prokurimeve Publike, të parashikohen procedurat që mbulojnë raste kur Autoriteteve Kontraktore u lind përgjegjësia për të njoftuar Autoritetin e Konkurrencës, në rastet kur gjatë projektimit dhe/ose zhvillimit të procedurave të prokurimit vihen re shenja të marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike.

Në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës të formulohet një kre i veçantë në VKM nr. 1 “Për rregullat e prokurimit publik” (ose në çfarëdo lloj akti tjetër ligjor që konsiderohet i përshtatshëm) në të cilin të përcaktohen rastet e mësipërme.

- II. Ti rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik:
3. Përfshirjen në dokumentet standarde të tenderit të çertifikatës për oferte të pavarur.
 4. Hartimi i një Udhëzuesi të përbashkët për luftimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike.
 5. Hartimi i Guidës “Mbi zbulimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike dhe për të reduktuar marrëveshjet në oferta në prokurimet publike”, si dhe Flet-Palosjes “Për sinjalet e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike”.
 6. Bashkëpunimin për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit mbi rëndësinë e zbulimit dhe parandalimit të marrëveshjeve në oferta, mënyrat dhe mjetet e luftimit të këtyre marrëveshjeve me pasoja mjaft të rënda për konkurrencën, taksapaguesit dhe vetë buxhetin e shtetit.
- III. Ngarkohet Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës për dërgimin e tyre pranë institucioneve përkatëse.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)

(_____)

(_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 159, Datë 19.11.2010

“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d), neni 28 dhe neni 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të, “Raportit të grupit të punës për monitorimin e tregut të energjisë elektrike” dhe “Raportit shtesë për monitorimin e tregut të energjisë elektrike” të paraqitur nga Sekretariati, si edhe pas zhvillimit të seancës konsultative me përfaqësues të Entit Rregullator të Energjisë;

V Ë R E N S E:

Mirëfunksionimi i tregut të energjisë elektrike duke siguruar që të ketë një furnizim të sigurt të energjisë elektrike me çmime sa më konkurruese është një faktor kyç për të siguruar rritjen e ekonomike dhe mirëqenien e konsumatorëve.

Struktura tradicionale e sistemeve elektrike është një njësi e integruar vertikalisht, e cila shpesh është monopol natyror. Konkurrenca krijohet nëpërmjet copëtimit të kësaj strukture në pjesët e saj përbërëse, duke treguar kujdes që të identifikohen ato pjesë të cilat mund të përfshihen në mënyrë aktive në konkurrencë dhe ato veprimtari të cilat duhet të mbeten të rregulluara.

Megjithëse është bërë një progres i dukshëm në këtë drejtim përsëri marrja e masave të mëtejshme për liberalizim e plotë të këtij tregu përbën një prioritet të punës së Autoritetit të Konkurrencës, i cili është shprehur nëpërmjet disa vendime me qëllimin e nxitjes konkurrencës, nga njëra anë dhe të Entit Rregullator të Energjisë nga ana tjetër.

I. Karakteristika e tregut të energjisë elektrike

Nga vlerësimi i akteve të mësipërme konstatoam karakteristika të përgjithshme të tregut si vijon:

1. Tregu i energjisë elektrike karakterizohet nga integrimi vertikal, prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja, të cilat realizohen nga ndërmarrjet KESH sh.a, OST sh.a dhe CEZ-Shpërndarje sh.a(OSSH). KESH sh.a përbëhet nga dy segmente të integruara vertikalisht të organizuara në KESH-Gen dhe Furnizuesi Publik me Shumicë, të cilat operojnë si një njësi ekonomike. Gjithashtu, CEZ-Shpërndarje përbëhet nga dy segmente të integruar vertikalisht, Shpërndarja dhe Furnizuesi Publik me Pakicë, të cilat operojnë si një njësi ekonomike.
2. Në praktikë nuk është zbatuar kërkesa e modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.03.2008, sipas të cilit, Furnizuesi publik me shumicë dhe KESH-Gen duhet të jenë të ndarë financiarisht dhe funksionalisht, por në fakt ato operojnë si njësi të vetme ekonomike. Ndarja funksionale dhe financiare e furnizuesit publik me shumicë nga KESH-Gen, do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar).
3. Gjithashtu, sipas Modelit të tregut të energjisë elektrike, e rëndësishme është edhe ndarja funksionale dhe financiare e furnizuesit publik me pakicë nga operatori i sistemit të shpërndarjes. Kjo ndarje do të sigurojë konkurrencën efektive, mundësi zgjedhje nga konsumatorët dhe eliminimin e ndër-subvencionimit në këto segmente tregu. Gjithashtu, ekziston mundësia që OSSH të mund të përdorë treguesit teknik dhe vonesat e ndryshme procedurale për të diskriminuar konkurrentët në tregun e furnizimit me pakicë.
4. Duke garantuar konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun e energjisë elektrike në radhë të parë synohet që të garantohen të drejtat e konsumatorit final për një shërbim sa më cilësor dhe me kosto sa më të ulët. Në këtë drejtim, ofruesit e shërbimit, veçanërisht kur ka një pozitë dominuese, kanë detyrime të veçanta ndaj konsumatorëve. Në këtë mënyrë pala ofruese e shërbimit duhet të garantojë furnizimin me energji elektrike në përputhje me kushtet teknike dhe cilësinë e kontraktuar. Nga ana tjetër klientët duhet të kryejnë pagesën për energjinë e kontraktuar. Por gjithashtu klientëve duhet ti njihet me kontratë, e drejta e dëmshpërblimit në rastin kur ofrimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike nuk është në përputhje me kushtet teknike.

I.1 Segmenti i rregulluar i tregut

5. Liberalizimit të plotë të tregut të energjisë elektrike kërkon hapjen ndaj konkurrencës duke krijuar mundësi për zgjedhje (nga ana e konsumatorit) në sa më shumë pjesë të zinxhirit, pra nga prodhimi deri tek konsumi përfundimtar i energjisë elektrike.

Megjithëse janë bërë përpjekje për liberalizimin e tregut, ky nivel liberalizimi nuk lejon apo krijon hapësirat e nevojshme për të hyrë operatorë të rinj në tregun e furnizimit me pakicë apo që klienti të ketë mundësi zgjedhjeje për t'u furnizuar me energji elektrike.

6. Për këtë arsye është krijuar Furnizuesi Publik me Pakicë, i cili duhet t'i krijojë konsumatorit përfundimtar mundësi zgjedhjeje, se cilin operatorë ti ofroje shërbimin e kërkuar. Por OSSH-ja dhe FPP janë dy segmente tregu brenda një entiteti. Ligjërisht ato duhet të jenë të ndara funksionalisht dhe financiarisht por në praktikë kjo ndarje nuk është realizuar ende. Sipas Entit Rregullator të energjisë ekziston mundësia që të realizohet ndarja e llogarive financiare të OSSH nga FPP, ndërsa ndarja funksionale nuk mund të kryhet para vitit 2014.
7. Për sa më sipër, mund të themi se tregu i energjisë elektrike është shumë i përqendruar duke qenë se në secilën nga segmentet e këtij tregu operon vetëm një operator. Tregu i energjisë elektrike është i integruar vertikalisht në dy nivele të ndryshme.

I.2 Segmenti i de-rregulluar i tregut

8. Në tregun e eksportit KESH sh.a, kryen shitje të energjisë elektrike për përfitime ekonomike, sipas rregullores së miratuar nga ERE. Ky treg është një treg i hapur dhe konkurrues, pasi KESH sh.a në bazë të neneve 4, 5 dhe 6 të Rregullores për Rregullat dhe Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike nëpërmjet procedurës së ankandit është i lirë të përzgjedhë kompaninë ku do ta shesë produktin energji elektrike, duke synuar përfitimin ekonomik të vetë kompanisë.
9. Tregu i blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve (de fakto është vetëm importi) është një treg i hapur për konkurrencë, duke qenë se numri i operatorëve në këtë treg nuk është i kufizuar dhe pjesën e tregut për rreth 11 operatorë që janë shpallur fitues në procedurat tenderuese që sigurojnë importin variojnë nga 32 për qind në 1%.
10. KESH Sh.a nuk ka marrë pjesë në tenderat e operatorit të sistemit të shpërndarjes për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve që nga momenti që operatori i sistemit të shpërndarjes ka ndryshuar pronësinë e 76 % të aksioneve.
11. Përgjithësisht çmimet mesatare të ponderuara (me sasi) të eksportit të energjisë elektrike të prodhuar nga KESH Gen janë më të larta se çmimet mesatare të ponderuara të importit të operatori i sistemit të shpërndarjes për mbulimin e humbjeve. Sipas të dhënave të disponuara nga KESH Sh.a dhe operatori i sistemit të shpërndarjes vetëm në muajin Mars 2010 çmimi i eksportit është më i ulët se çmimi i importit.
12. Gjatë këtij monitorimit të kryer nga Autoriteti i Konkurrencës, nuk janë vënë re shenja të kufizimit të konkurrencës në pjesën e tregut të parregulluar të energjisë elektrike.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 28 dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" i ndryshuar me propozim të Sekretariatit:

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike:
 - 1.1 Ndarjen funksionale dhe financiare reale të “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH-Gen, e cila do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar) për të kryer transaksione konkurruese dhe është në zbatim të modelit të tregut.
 - 1.2 Ndarjen financiare reale të “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” dhe “Furnizuesit Publik me Pakicë” në mënyrë që të operojnë si njësi të ndara financiarisht pasi këto segmente tregu janë të liberalizuara dhe është një instrument që ndikon në rritjen e konkurrencës në këtë segment të tregut.
 - 1.3 Përsheptimin e procesit të rishikimit të Kontratës me Klientët tariforë duke përcaktuar detyrimet e Furnizuesit Publik me Pakicë për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet respektimit të treguesve të cilësisë së shërbimit (furnizimi vs mungesës së energjisë dhe saktësisë së faturimit).
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

()

()

()

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

Mendimi i pakicës

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 159, Datë 19.11.2010 ” Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e Energjisë Elektrike”, kam mbajtur qëndrim kundër përsa i përket pjesës arsyetuese të tij, si më poshtë :

- I- Së pari nuk e miratoj në tërësi Raportin e Grupit të Punës “Mbi Monitorimin e Tregut të Energjisë Elektrike” dhe “Raportin Shtesë për Monitorimin e Tregut të Energjisë Elektrike”, me përjashtim të pjesëve që kanë të bëjnë me trajtesat që lidhen me rekomandimet e sipërpërmendura.
- II- Monitorimi i tregut të energjisë elektrike nuk është i plotë. Përsa i përket sythit 2-Kuadri Ligjor, të Raportit për monitorimin e Tregut të Energjisë Elektrike (raporti Shtesë) vlerësimi i legjislacionit të listuar, mbetet thjesht brenda kuadrit të listimit të akteve ligjore e nënligjore (gjithsej 20 akte të listuar) dhe nuk ka një analizë për një vlerësim të plote të këtyre akteve dhe aq më tepër monitorim i efekteve të tyre në praktike.
- III- Përsa i përket sythit 6. Zbatimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, e konsideroj të padrejtë, të njëanshme, të gabuar, të mosperfshirjes në analizë të të gjitha pikave të dispozitivit të Vendimit Nr.90 , Datë 07.10.2008. Përjashtimi nga analiza nga ana e Grupit të Punës, sidomos e pikës 2.2 me përmbajtje “T”i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike: 2.2 Të respektojë zbatimin e Nenin 69 të Ligjit Nr 9121 ”Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, për të marrë në kohë dhe para miratimit të akteve vlerësimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës për mundësinë e kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës nga aktet ligjore dhe nënligjore , duke rritur transparencën në procesin e privatizimit dhe liberalizimit të mëtejshëm të Sektorit të Energjisë Elektrike”. është i pajustificuar dhe i dënueshëm. Ai shtrembëron me vetëdije pamundësinë e vlerësimit objektiv dhe tërësor të akteve që mund të kenë çuar në shtrembërimin e konkurrencës ose jo , nga ana e Komisionit të Konkurrencës. Disa nga këto akte sidomos anekset mbi kontratën e privatizimit nuk janë vënë në dispozicion të Komisionit të Konkurrencës. Për më tepër ato nuk vihen në dispozicion as pas kërkesës eksplicite të këtij Komisioni.

IV- Nuk jam dakord me vlerësimin apriori të Raportit por dhe të këtij Vendimi se:

“Në tregun e eksportit KESH sh.a, kryen shitje të energjisë elektrike për përfitime ekonomike, sipas rregullores së miratuar nga ERE. Ky treg është një treg i hapur dhe konkurrues” .

“Tregu i blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve (de facto është vetëm importi) është një treg i hapur për konkurrencë”

13. “Gjatë këtij monitorimit të kryer nga Autoriteti i Konkurrencës, nuk janë vënë re shenja të kufizimit të konkurrencës në pjesën e tregut të parregulluar të energjisë elektrike.”

Mbështetur : a) në mungesën e vlerësimit të të gjithë akteve që janë nxjerrë në tregun e energjisë elektrike, b) shpërdorimin e ujit të hidrocentraleve duke i hapur vetëm gjatë vitit 2010 pese here portat e Hidrocentralit të Vaut të Dejës në kaskadën e Drinit, c) në kushtet

e importimit të energjisë elektrike nga OSSH, CEZ edhe në kushtet e përmbytjes të zonës së Shkodrës nga hapja e portave të Hidrocentraleve, duke qenë dakort me dispozitivin e këtij vendimi, jam kundër pjesëve konstatuese të tij, të permendura dhe me siper duke i mbetur kërkesës për hapjen e një hetimi në tregun e energjisë elektrike nga ana e Autoritetit të Konkurrencës lidhur me një shtrembërim të mundshëm të konkurrencës nga ana e KESH Gen dhe OSSH. Kryesorja mbetet kryerja e një hetimi të plote dhe objektiv.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Koço BROKA

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 160, Datë 23.11.2010

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Interalbanian Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.11.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Interalbanian Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12 dhe neni 59, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Vienna Insurance Group AG –Interalbanian sha dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së 75%+1 aksioneve të shoqërisë Interalbanian sh.a, nga shoqëria Vienna Insurance Group AG, është realizuar nëpërmjet ‘Kontratës për shitje

aksionesh' të datës 21 Tetor 2010, e nënshkruar nga palët Vienna Insurance Group AG dhe Interlbanian sh.a.

Shoqëria Vienna Insurance Group AG blen me anë të kësaj kontrate 75%+1 të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Interlbanian sh.a dhe përfton kështu kontrollin e vetëm në këtë të fundit nëpërmjet shit-blerjes së aksioneve.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit është ndryshim kontrolli në formën e ndryshimit të pronësisë dhe hyrjes së një aksioneri të ri kontrollues. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove(neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar(neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- Vienna Insurance Group AG, një shoqëri aksionare, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin e Republikës së Austrisë, me seli në Schottenring 30, 1010 Vienë , Austri, në cilësinë e blerësit të pjesës prej 75% +1 të kapitalit aksionar të shoqërisë Interlbanian sh.a. Në Shqipëri shoqëria është prezent që prej një viti me anë të shoqërisë Sigma Vienna Insurance Group sh.a, ku ajo zotëron 87% +1 aksion në kapitalit themeltar me të drejtë vote. Aksionet e shoqërisë janë të listuar ne bursën e Vienës.
- Interlbanian sh.a, është një shoqëri aksionare pa ofertë publike themeluar në cilësinë e shitësit të pjesës prej 75% +1 të kapitalit aksionar të shoqërisë me të drejtë vote. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimit dhe ri-sigurimit të jo-jetës, gjithashtu ajo mund te kryejë çdo veprimtari ndihmëse ose të ushtrojë çdo aktivitet tjetër, i cili konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Shoqërisë mund të ushtrojë veprimtari si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj.

3. Përshkrimi i transaksionit.

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve është realizuar në bazë të “Kontratës shitje aksionesh” të datës 21 Tetor 2010, me qëllim transferimin e pjesës prej 75% +1 aksione të kapitalit aksionar të shoqërisë Interlbanian tek shoqëria Vienna Insurance Group AG.

Transaksioni konsiston në përfundimin e kontrollit të vetëm nëpërmjet blerjes së 75% +1 të aksioneve me te drejtë vote nga blerësi tek shitësi. Blerësi do jetë aksioneri maxhoritar në shoqërinë Inetralbanian sh.a me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kalimi i të drejtave mbi aksionet. Transaksioni do të përfundojë me përbushjen e kushteve e marra përsipër në lidhje me garancitë e bëra nga palët¹.

Vlera e transaksionit është xxxx milion euro dhe do të shlyhet nga blerësi me burimet e veta financiare në përputhje me nenin 2 te kontratës për blerje aksionesh dhe me deklaratën mbi vendimin e Bordit Drejtues të blerësit për të blerë shumicën e pjesëmarrjes në aksione të Interlbanian sh.a².

¹ Neni 3 pika 3.2.1.2 e Kontrates Per Shitje Aksionesh, date 21.10.2010, përcakton kushtet per mbylljen dhe transferimin aksioneve ku përfshihen autorizimet dhe miratimet nga organet përkatëse shtetërore Autoriteti i Konkurrencës dhe Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

² Deklaratën mbi Vendimin e Bordit Drejtues për të blerë shumicën e pjesëmarrjes në aksione të Inetralbanian Sh.a, Vjenë , datë 07.10.2010

4. Xhiro për vitin 2009

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është xxxx miliard lekë:
 - o Vienna Insurance Group³: xxxx euro = xxxx lekë
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është xxxx miliard lekë:
 - o InterAlbanian Sha: xxxx lekë
 - o Sigma Sha: xxxx lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

5. ANALIZA E KONKURRENCËS

5.1. Tregu Përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

5.1.a Tregu i produktit:

Referuar Ligjit të gjitha shërbimet e ofruara apo përfuara nga konsumatorët në tregun përkatës, nga palët në këtë transaksion janë konsideruar produkte (kryerja e sigurimit të dëmeve në përputhje me lejen për ushtrim aktiviteti), sipas përcaktimit të licencave të lëshuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve):

- a. Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit;
- b. Sigurimet motorike
- c. Sigurimi i avionëve, anijeve, marinës dhe transportit
- d. Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë
- e. Sigurimi i përgjegjësive
- f. Sigurimi i kreditit dhe garancive

5.1.b. Tregu gjeografik: Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit.

Por, duke qenë se pasojat e veprimtarisë së palëve do të ndihen direkt në tregun e brendshëm, në vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik në këtë këndvështrim, (për nga qëllimi), është konsideruar tregu kombëtar.

5.2. Struktura e tregut para përqendrimit.

Përfituesi i kontrollit në shoqërinë InterAlbanian sh.a, Viena Insurance Group është aktualisht prezente në tregun shqiptar të sigurimeve, pasi zotëron paketën kontrolluese të

³ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2009, 1 euro=137.96 lek. Burimi:Raporti Statistikor Kursi

aksioneve të shoqërisë Sigma sh.a. Sipas të dhënave zyrtare rezulton se në tre nëntregjet ku shoqëria Interalbanian është aktive në treg, indeksi i përqendrimit është si vijon: (i) tregu i sigurimeve motorike është mesatarisht i përqendruar ndërkohë që dy nën-tregjet e tjera, (ii) sigurimit të pasurisë dhe (iii) sigurimit të shëndetit janë shumë të përqendruar.

Në tregun e sigurimeve motorike për vitin 2009, Interalbanian zë pjesën prej 11,7% ndërkohë që Sigma me 17,6 % të tregut. Në këtë treg konkurrenti kryesor është Sigal me 24.5 për qind të tregut.

Në tregun e sigurimit të pasurisë, për vitin 2009, Interalbanian ka 10,17 % të tregut, Sigma me 9.27 %, ndërkohë që konkurrenti kryesor është Sigal me një pjesë tregu prej 42.09 %.

Në tregun e sigurimit të shëndetit për vitin 2009, Interalbanian ka 14.23 %, Sigma me 11.40%, ndërkohë që konkurrenti kryesor është Sigal që zë vendin e parë me një pjesë tregu prej 33,94 %.

5.3. Struktura e tregut pas përqendrimit

Përqëndrimi i realizuar VIG-Interalbanian ka tregje të prekura pasi aktualisht VIG zotëron 87 % +1 aksion të ndërmarrjes konkurrenente SIGMA Vienna Insurance Group sh.a, e cila aktualisht është konkurrenente e Interalbanian

Tregu i prekur i përqendrimit është tregu shqiptar i sigurimeve të jo-jetës ku të dy ndërmarrjet janë prezente para përqendrimit. Për këtë arsye kemi parë me kujdes pjesët e kombinuara të tregut dhe shkallën e përqendrimit sipas tregjeve përkatëse për shkak se përfituesi i kontrollit pas përqendrimit do të zotërojë kontrollin në dy ndërmarrje që ofrojnë shërbimin në tregun e sigurimeve të jo-jetës.

Aktualisht nga ky përqendrim preken vetëm nën-tregjet e sigurimeve motorike, sigurimit të pasurisë dhe sigurimit të shëndetit, pasi kompania Interalbanian sh.a. nuk ushtron veprimtari në nën-tregjet e tjera (Sigurimi i përgjegjësive, Sigurimi i kreditit dhe garancive, Sigurimi i avionëve, anijeve, marinës dhe transportit).

Në tre nën-tregjet e prekura ku ndërmarrjet Sigma sh.a dhe Interalbanian sh.a pjesët e përbashkëta të tregut janë respektivisht 26.369 % për sigurimet motorike, 27.87 % për sigurimin e pasurisë dhe 24.28 % për sigurimin e shëndetit.

Në tregun e sigurimeve motorike Sigal është konkurrenti kryesor me pjesën më të madhe të tregut. Pjesa e kombinuar e ndërmarrjes objekt i transaksionit dhe Sigma sh.a është e krahasueshme me pjesën e tregut të Sigal, duke krijuar një treg me dy konkurrentë kryesorë (Sigal dhe VIG) dhe 5 konkurrentë të tjerë më të vegjël.

Në dy nën-tregjet e tjera (Sigurimi i pasurisë dhe sigurimi i shëndetit) pavarësisht se rritet pjesa e kombinuar e Sigma dhe Interalbanian, shoqëria Sigal sh.a mbetet me pozitë dominuese në treg dhe përqendrimi i realizuar pritet të rrisë konkurrencën e dy ndërmarrjeve që kontrollohen nga VIG me Sigal.

6. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

1. Tregu i sigurimeve është një treg i rregulluar me dinamikë të lartë zhvillimi që karakterizohet nga ndryshime të shpeshta në paketën kontrolluese të ndërmarrjeve prezente, kryesisht nga shoqëri sigurimesh nga vendet europiane.

2. Përqendrimi i njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës mes Viena Insurance Group dhe Interalbanian ka tregje të prekura pasi Viena Insurance Group zotëron paketën kontrolluese të aksioneve në shoqërinë Sigma sh.a. Për vlerësimin e efekteve të përqendrimit janë analizuar tregjet e prekura në tregun shqiptar të sigurimeve kryesisht në tre nën-tregje të sigurimeve të jo-jetës si tregu i sigurimeve motorike, tregu i sigurimit të pasurisë dhe tregu i sigurimit të shëndetit.
3. Në tre nën-tregjet e prekura ku ndërmarrjet Sigma sh.a dhe Interalbanian sh.a pjesët e përbashkëta të tregut janë respektivisht 26.369 % për sigurimet motorike, 27.87 % për sigurimin e pasurisë dhe 24.28 % për sigurimin e shëndetit.
4. Në analizën e strukturës së tregjeve përkatëse sipas indeksit të përqendrimit rezultojnë se:
 - a. Tregu i sigurimeve motorike para përqendrimit është mesatarisht i përqëndruar (HHI=1496) ndërkohë që pas përqendrimit për shkak se ka tregje të prekura ndryshon struktura e tregut në treg shumë të përqëndruar (HHI=1839 me një ndryshim (delta) me + 343)
 - b. Tregu i sigurimit të pasurisë para përqendrimit është shumë i përqëndruar (HHI=2564) dhe pas përqendrimit megjithëse rritet indeksi i përqendrimit (HHI=2901 me një ndryshim(delta) me + 337) nuk ndryshon struktura e tregut, e cila vazhdon të mbetet shumë e përqëndruar.
 - c. Tregu i sigurimit të shëndetit para përqendrimit është shumë i përqëndruar(HHI=2346) dhe pas përqendrimit megjithëse rritet indeksi i përqendrimit (HHI= 2640 me një ndryshim(delta) me + 294) nuk ndryshon struktura e tregut, e cila vazhdon të mbetet shumë e përqëndruar.
5. Në rastin e përqendrimit VIG-Interalbanian sh.a pjesët e kombinuara të tregut janë më pak se 40 % dhe konkurrenti kryesor në treg edhe pas realizimit të këtij përqendrimi mbetet Sigal sh.a , i cili si konkurrenti kryesor i dy ndërmarrjeve të kontrolluara nga VIG ka më shumë se 40 % në dy nën-tregje(sigurimi i pasurisë dhe sigurimi i shëndetit) dhe ka pjesë të përafërta tregu me pjesën e kombinuar Sigma-Interalbanian në nën-tregun e sigurimit të shëndetit.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk sjell krijimin apo fuqizimin e pozitës dominuese dhe nga analiza e tregjeve të prekura rezultojnë se grupi Vienna Insurance do të zotërojë kontrollin në dy shoqëri konkurruese në nivel horizontal të tregut, Interalbanian sh.a dhe Sigma sh.a, por nuk shfaqen shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Interalbanian sh.a, nga shoqëria Vienna Insurance Group AG.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 161, Datë 02.12.2010

“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë “3G””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.12.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë “3G”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar), nenet, 2 pika c), 24 pika d), 69 dhe 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës mbi procedurën e dhënies së licensës së parë në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë “3G”,

V Ë R E N S E:

I. Hyrje

1. Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28/a të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), ka monitoruar procesin e dhënies së licensës së parë për shërbimin e teknologjisë me bazë të gjerë “3G”. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr 10317, datë 16.09.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin 9121 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’ në fushën e zbatimit të ligjit janë shtuar (neni 2) edhe ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet, të cilave u janë dhëna nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta.

2. Autoritetit të Konkurrencës ka administruar informacionin e ardhur me shkresën nr. 365/1, datë 01.10.2010 nga AKEP lidhur me informacionin dhe dokumentacionin përkatës mbi procedurat e ndjekura për dhënien e të drejtës së përdorimit të brezit UMTS si dhe propozimin që AKEP i ka bërë Ministrisë të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit lidhur me kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit në brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz.
3. Delegacioni i Bashkimit Europian, me anë të shkresës Nr 448, datë 12.11.2010 ka kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës lidhur me procedurën e tenderit të 3G për përzgjedhjen e vetëm një license nga këndvështrimi i konkurrencës. Sipas Komisionit Europian, ka një risk që procesi i lëshimit të një license për një periudhë kohe mund të rezultojë në krijimin e një monopoli të përkohshëm në tregun e telefonisë celulare “broadband” të cilat shkojnë kundër parimeve të konkurrencës efektive në fazat e para për të gjeneruar investime dhe si pasojë, për të siguruar zgjedhje më të mira për konsumatorët.

II. Baza ligjore dhe vlerësimi ligjor

4. Ligji Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë“(Ligji). Qëllimi i ligjit është të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efikase nëpërmjet parimit të neutralitetit të teknologjisë së komunikimeve elektronike dhe të sigurojë shërbimet e duhura në territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. VKM Nr. 322, datë 05.05.2010 “Për miratimin e dokumentit të politikave për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” përcakton strategjinë afatmesme të Qeverisë për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.
6. VKM Nr.479, datë 6.5.2009 “Për miratimin e Planit Kombëtar të frekuencave” si dhe VKM-së Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”
7. Në bazë të nenit 5 pika 10) e Ligjit, është kompetencë e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (Ministri) të miratojë kufizimet e mundshme për dhënien e frekuencave dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre, bazuar në propozimet e AKEP-it. E drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmëria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre(Neni 65 i Ligjit).

III. Procedura e ndjekur për dhënien e licencës

8. AKEP ka kërkuar konsultim publik për dokumentin ‘Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë’. Duke marrë në konsideratë komentet e bëra nga palët e interesuara në këshillimin publik si dhe detyrimin që AKEP ka bazuar në pikën 10 të nenit 5, nenit 68 dhe 69 të Ligjit ‘Për komunikimet elektronike, AKEP i ka propozuar Ministrisë të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit që:

- a) Kohëzgjatja e përdorimit të autorizimit individual për të drejtën e përdorimit të brezit UMTS të jetë 15 vjet
 - b) Numri i të drejtave të përdorimit të brezit UMTS mund të jetë nga 1 deri në 4 licenca duke marrë në konsideratë ruajtjen e interesit të palëve për të marrë pjesë në tender si dhe garantimin e normalitetit në treg dhe ecjen e tij drejt në rrugën e një zhvillimi sa më të shpejt dhe në interes të konsumatorëve.
 - c) Procedura e tenderit të jetë e hapur
 - d) AKEP propozon që çmimi për brezin e çiftuar të jetë 0.08 Euro/MHZ/banor dhe për brezin e pa çiftuar të jetë 0.016 Euro/MHZ/banor. Bazuar në këto çmime AKEP ka propozuar që vlera e një autorizimi të jetë 9.424.000 Euro.
 - e) Koha e fillimit të shërbimit të jetë jo më vonë se 2 muaj nga data e dhënies së autorizimit individual.
9. AKEP ka marrë në konsideratë komentet e bëra nga palët e interesuara në këshillim publik i ka propozuar Ministrin ndër të tjera që numri i të drejtave të përdorimit të brezit UMTS mund të jetë nga 1 deri në 4 licenca duke marrë në konsideratë ruajtjen e interesit të palëve për të marrë pjesë në tender si dhe garantimin e normalitetit në treg dhe ecjen e tij drejt në rrugën e një zhvillimi sa më të shpejt dhe në interes të konsumatorëve.
10. Ministri ka miratuar kufizimet dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e Autorizimit Individual: për 1 (një) Autorizim Individual me çmim fillestar prej 12.5 milion Euro; me një kohëzgjatje 15 vjeçare; koha e fillimit të shërbimit jo më vonë se 2 muaj nga data e dhënies së Autorizimit Individual dhe së fundi procedura e tenderit publik për dhënien e së Drejtës së Përdorimit të frekuencave do të jetë në përputhje dhe në zbatim të VKM-së Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”.
11. AKEP ka marrë Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 1367, datë 25.08.2010 “Për miratimin e publikimit të përfundimeve të këshillimit publik mbi dhënien e të drejtave të përdorimit brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjerë (UMTS). Gjithashtu ka publikuar Njoftimin “për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit të frekuencave dhe njoftimin për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit të frekuencave ” (sipas dhe në përputhje me nenin 68 pika 5 e Ligjit).
12. AKEP ka nisur procedurën e tenderit me njoftimin për zhvillimin e tenderit publik me objekt “Dhënia e 1 (një) të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1920- 1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë” (sipas dhe në përputhje me nenin 69 të Ligjit).
13. Gjithashtu nga konsultimi i vazhdueshëm me Ministrinë për Inovacion dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit jemi informuar se Shqipëria është akoma mbrapa në dhënien e Autorizimit Individual dhe nëse ne do të shikojmë përvojën e vendeve të tjera të Bashkimit Evropian dhe të rajonit, do të vërejmë se Autorizimi Individual (AI), i frekuencave UMTS (3G), shpesh është dhënë një nga një dhe JO të gjitha së bashku.

14. Nga vëzhgimi i kryer për raste të ngjashme të dhënies së licensave “3G” rezulton se eksperiencia e vendeve të ndryshme ka treguar që licencat për teknologjinë 3G janë dhënë në të njëjtën kohë¹ por ka pasur modele të ndryshme ku në disa vende licenca ka qenë identike (si psh. Italia) dhe në disa vende të tjera licencat kane qenë të përmasave të ndryshme. (si psh Mbretëria e Bashkuar)².
15. AKEP në datë 8.11.2010 realizoi tenderin për dhënien e 1 të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar Ref. 1-2x15+5-2010.
Pas shqyrtimit të ofertave të paraqitura nga ofertuesit, klasifikimi i ofertave të vlefshme sipas AKEP është 100 pikë për Vodafone Albania për ofertën 31.4 milionë euro dhe 46.11 pikë me ofertë 12.597.500 euro të Eagle Mobile.
16. AKEP me anë të Nr. 1448, datë 18.11.2010 për “Njoftimin e fituesit të tenderit publik me procedure të hapur me objekt: “Dhënia e 1 (një) të drejte përdorimi të brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë” ka shpallur fitues të kësaj procedure Vodafone Albania. AKEP në këtë vendim shprehet se nuk ka pasur asnjë ankimim lidhur me procedurën e tenderimit.

IV. Analiza e tregut përkatës

17. Tregu i telefonisë celulare ka patur dinamikë të lartë ndryshimesh si në pjesët e tregut ashtu dhe numrin e përdoruesve. Nëse shohim ecurinë e tregut në vite sipas AKEP, ritmet vjetore të rritjes së tregut për periudhën 2001-2004 kanë ardhur duke u zvogëluar, nga 1200 për qind në 2001, në vitin 2002 107%, 40 për qind në vitin 2003 dhe 15 për qind në vitin 2004. Gjate viteve 2005 dhe 2006 është vënë re përsëri një rritje e këtyre normave: me 21 përqind në vitin 2005 dhe 25 përqind në vitin 2006. Në vitin 2007 pati një rënie të normës së rritjes në 21%, ndërsa në vitin 2008 norma e rritjes arriti në 27%.
18. Sipas AKEP, numri i përdoruesve celularë për 100% banorë ka ardhur në rritje nga viti në vit dhe në fund vitin 2008 kjo normë (niveli i penetrimit) është afërsisht 92%. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre përdoruesve vlerësohet të kenë më shumë se një kartë SIM, që do të thotë se numri i banorëve që përdorin telefonin celular është më i vogël se 92%.
19. Tregu përkatës i produktit i përcaktuar në licencën 3G është e drejta e përdorimit në brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër, i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë.
20. Në tregun e telefonisë celulare e ofrojnë shërbimin 4 kompani AMC Sh.A, Vodafone Albania Sh.A, “Eagle Mobile” dhe “PLUS”. Në garën për licensën e parë morrën pjesë vetëm 2 kompani, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile ku fitues për ofertën më të mirë u shpall Vodafone Albania.
21. Sipas analizës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, numri maksimal i mundshëm i frekuencave është katër dhe nuk ka ende një afat kohor për

¹ Shih http://news.bbc.co.uk/2/hi/in_depth/business/2001/3g/default.stm

² Shih <http://www.cramton.umd.edu/papers2000-2004/01nao-cramton-report-on-uk-3g-auction.pdf>

dhënien e licensave të tjera. Sipas MITIK, Autorizimi Individual për 3G e parë do të jetë i vetmi në funksionim për një kohë të shkurtër.

22. Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kujdeset për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke ndaluar çdo sjellje që përbën abuzim me pozitën dominuese.
23. Dhënia e një licence të vetme qoftë edhe për një periudhë të shkurtër kohe përbën një kufizim të konkurrencës mes operatorëve për ofrimin e shërbimit në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” me propozim të Sekretariatit:

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit liberalizimin e tregut të shërbimit të 3G, duke dhënë licencat e tjera për këtë shërbim, sa më parë që të jetë e mundur. Këto licence të jepen në të njëjtën kohë në mënyrë që të rritet konkurrenca e lirë dhe efektive në këtë treg për shërbimin “3G”. Kushtet e dhënies së këtyre licensave duhet të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në licencën e parë të akorduar.
2. T’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare rregullimin e tregut të shërbimit të teknologjisë me brez të gjerë mbi baza të metodologjive transparente dhe të rregullojë tarifat e shërbimit të orientuara drejt kostos.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 162, Datë 14.12.2010

“Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA” për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e abuzimit me pozitën dominuese të shoqërive “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, pika 2, germa (d) dhe neni 24, gërma (d), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”;

Ligji Nr. 8485 datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”,

Pala në hetim: 1) Ndërmarrja “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, me NIPT K71906007R dhe adresë:, ish Fabrika e Sodës, Vlorë;
 2) Ndërmarrja “ROMANO PORT” SHA, me NIPT K51625501O dhe adresë: Durrës, Porto Romano ;
 3) Ndërmarrja “INTERGAZ” SHA, me NIPT K21916802B dhe adresë: Durrës, Porto Romano.

Periudha e hetimit: Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 147 datë 23.06.2010, është 01.06.2009 deri në 31.05.2010.

Pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës për hetimin e thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm, të hapur me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 147, datë 23.06.2010; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm; dhe
- Pretendimeve të ndërmarrjeve “ROMANO PORT” SHA dhe “INTERGAZ” SHA, si dhe “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SH.A, të paraqitura në seancat dëgjimore, përkatësisht në datat 01.09.2010 dhe 13.10.2010 dhe ato të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr.Prot 343/2 datë 1.09.2010 dhe Nr.Prot 313/7, datë 30.09.2010

V Ë R E N S E:

I. PROCEDURA

1. Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II të Pjesës II dhe në Kreun II dhe III të Pjesës së III të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (këtu e mëposhtë Ligji) dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Nisur nga ankesat e shoqërive importuese “Global Gaz” Sh.a, “Mare Oil” Sha dhe “Burimi” SRL, dhe të kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, germa a) të Ligjit ka monitoruar tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës (GLN), për të parë nëse kishte elementë që kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në këtë treg.
3. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, duke marrë shkas nga gjetjet e konstatuara gjatë monitorimit të realizuar, bazuar në nenin 42, të Ligjit me anë të Vendimit Nr. 1, datë 17.02.2010 të Sekretarit të Përgjithshëm, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm për të parë nëse ka elementë që kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në këtë treg.
4. Pas vlerësimit të materialeve të administruara gjatë inspektimeve, grupi i punës hartoi raportin “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”, duke i propozuar Komisionit të Konkurrencës marrjen e masave të përkohshme.
5. Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të grupit të punës dhe dëgjimit të ndërmarrjes “PIA” SHA në seancën dëgjimore të organizuar në datë 10.03.2010, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 44 të Ligjit u shpreh me anë të vendimit Nr. 140, datë 10.03.2010. Me anë të këtij vendimi Komisioni i Konkurrencës për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, duke parë dhe mundësinë e shkëljes së nenit 9, pika 2 të Ligjit, u shpreh për marrjen e masave të përkohshme për një periudhë kohore deri në përfundim të hetimeve.
6. Komisioni i Konkurrencës organizoi seanca dëgjimore me ndërmarrjet e importit GLN-së në datën 02.06.2010.

7. Bazuar në raportin e hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN u vlerësua se ndërmarrjet PIA sha, “Romano Port” Sh.a dhe “Inter Gaz” Sh.a mund të kishin abuzuar me pozitën dominuese në tregjet përkatëse bazuar në nenin 9, pika 2, të Ligjit me anë të kushteve të vendosura për ofrimin e shërbimit për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit, si dhe të nenit 12 dhe nenit 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me Vendimin nr. 147, datë 23.06.2010 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm” vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve: “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA; “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA, me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës.
8. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 26, nenin 43, pika 2 të Ligjit si dhe në mbështetje të Vendimit Nr 147, datë 23.06.2010, me anë të Vendimit Nr. 148, datë 24.06.2010 “Për përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm të naftës”, përcaktoi fazat e kryerjes së hetimit të thelluar, duke përcaktuar si afat të fundit për kryerjen e këtij hetimi datën 01.07.2010
9. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur raportin e hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe të depozitimit të gazit të lëngshëm, pranë Komisionit të Konkurrencës i cili iu vu në dispozicion dhe ndërmarrjeve nën hetim “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA.
10. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, ndërmarrjet “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar në seancat dëgjimore të datave: 01.09.2010 dhe datë 13.10.2010.
11. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Komisioni i Konkurrencës ftoi në tryezë konsultative përfaqësues të Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA) dt 2.09.2010

II. TREGU PËRKATËS

11. Tregu përkatës përcaktohet në dy dimensione:
 - a) Tregu përkatës i produktit
 - b) Tregu përkatës gjeografik

II.1. Tregu përkatës i produktit (shërbimit)

12. Tregu përkatës i produktit është tregu i ngarkim-shkarkimit dhe i depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare, i cili ndahet në:
 1. Tregu i ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare që realizohet në dy pika: në zonën e ish Uzinës së Sodës PVC në Gjirin e Vlorës nga “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA (PIA) dhe në zonën e Porto Romanos, Durrës, nga ndërmarrja “Romano Port” SHA. Këto dy ndërmarrje janë ndërtuar dhe funksionojnë

mbi bazën e marrëveshjeve të koncesionit dhe janë të vetmet pika hyrëse që mund të ofrojnë këtë shërbim në rrugë detare gjatë periudhës objekt hetimi.

2. Tregu i depozitimit në terminale bregdetare të gazit të lëngshëm mund të ofrohet nga ndërmarrje të cilat kanë ndërtuar depozita në këto zona. Gjatë periudhës objekt hetimi shërbimin e depozitimit e ofrojnë PIA sha dhe “Inter Gaz” sha.

Të dy segmentet e tregut janë në funksion të njëri-tjetrit dhe nuk mund të funksionojnë të veçuara.

II.2 Tregu përkatës gjeografik

13. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse ndërmarrjet që kërkojnë shërbimin e ngarkim shkarkimit dhe depozitimit të GLN në rrugë detare operojnë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si treg gjeografik përcaktohet tregu i Republikës së Shqipërisë.

III.3 Zëvendësueshmëria

14. Midis shërbimit të ngarkimit-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare dhe atij në rrugë hekurrudhore apo/ose rrugë tokësore, nuk ka zëvendësueshmëri për shkak të kostove të mëdha dhe kufizimeve të tjera esenciale që paraqesin këto shërbime . Gjatë periudhës objekt hetimi, Qershor 2009 – Maj 2010, importi në rrugë tokësore dhe hekurudhore zë 4.9% të totalit të importit të GLN-së.
15. Shërbimi i ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN të ofruara në terminalin bregdetar të Vlorës nga “PIA” sha, dhe në terminalin bregdetar të Durrësit nga “Romano Port” sha dhe “Intergaz” sha janë zëvendësues të përafërt. Pra një importues i GLN-së potencialisht mund të marrë shërbimin e ngarkim-shkarkimit dhe të depozitimit në të dy terminalët bregdetare, por modelet e biznesit dhe kostot e transaksioneve të ofrimit të shërbimit në të dy terminalët bregdetare janë të ndryshëm.”PIA” sha ofron ngarkim-shkarkimin dhe depozitimin kundrejt një kontrate afatgjatë 3-5 vjecare të lidhur të paktën 12 muaj para ofrimit të shërbimit, një tarife bazë mujore deri në një kapacitet të përcaktuar në kontratë, apo me një tarifë për njësi për çdo njësi përtej sasisë së parapërcaktuar nënkontrate, si dhe kundrejt një garancie financiare. Ndërsa shërbimi i ofruar në terminalin bregdetar në Porto Romano realizohet nëpërmjet dy kontratave: a) të lidhur me “Romano Port” sha për shërbimin e ngarkim-shkarkimit të GLN-së kundrejt tarifave të përcaktuara për njësi të shërbimit, dhe b) të lidhur me ndërmarrjet që ofrojnë me qera kapacitete depozitimi kundrejt kontratave dypalëshe që lidhen midis operatorve. Gjatë periudhës objekt hetimi e vetmja ndërmarrje që posedonte depozita bregdetare dhe që i ofronte ato me qera ishte “Inter Gas” sha.

III. ZHVILLIMET NE TREGUN E NGARKIM SHKARKIMIT DHE DEPOZITIMIT NË RRUGË DETARE TE GLN-së

16. Mënyra e funksionimit të tregut të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së në rrugë detare ka pësuar ndryshime esenciale në lidhje me infrastrukturën portuale të ofrimit të këtij shërbimi. Në bazë të VKM nr 486 datë 25.07.2007 “Për ndërprerjen e veprimtarisë së anijeve që transportojnë naftë, gaz dhe nënproduktet

e tyre në portet e Durrësit dhe të Shëngjinit”, ndërmarrjeve importuese të GLN-së nuk u mundësohet ngarkim-shkarkimi i drejtpërdrejtë nga anijet në autobotë.

17. Ndërkohë sipas VKM Nr. 251, datë 20.04.2001 “Për miratimin e studimit “Përcaktimi i hapësirave të përshtatshme për ndërtimin e depozitave bregdetare të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre” ishin përcaktuar hapësirat ku do të ndërtohen instalimet bregdetare, përkatësisht në zonën e Porto Romanos dhe në zonën e ish Uzinës së Sodës PVC në gjirin e Vlorës.
18. Me anë të Ligjit nr. 9231, datë 13.05.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit të formës “BOO” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës”, si dhe për ratifikimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës”, ndërmarrja PIA sha ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit në Gjirin e Vlorës.
19. Me anë të Ligjin nr. 9298, datë 11.07.2004,(i ndryshuar në 2006) “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës ” ndërmarrja “Romano Port” sha ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në zonën e Porto Romanos

III.1 Pjesët e tregut dhe ndryshimi i pjesëve të tregut

20. Në tregun e shërbimeve treguesi i matjes së pjesëve të tregut përkatës varet nga niveli i kërkesës së klientëve për këtë shërbim. Për rrjedhojë treguesi i matjes së pjesëve të tregut përkatës së shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit në rrugë bregdetare që zotërohet nga ndërmarrjet që ofrojnë këtë shërbim është i përafërt dhe varet nga niveli i aktivitetit të importit të GLN-së në rrugë detare dhe shprehjet nëpërmjet sasive fizike të GLN-së së importuar. Pra, pjesët e tregut sipas terminaleve bregdetare varen nga veprimtaria e ndërmarrjeve importuese të GLN-së të realizuara nëpërmjet këtyre dy terminaleve bregdetare.
21. Në bazë të të dhënve të Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave mbi volumin e GLN-së të importuar gjatë periudhës objekt hetimi (Qershor 2009- Maj 2010), rezulton se 55.2 % e sasisë së GLN-së së importuar në rrugë detare është përpunuar (apo terminuar) nëpërmjet terminalit bregdetar të Vlorës, pra është realizuar nëpërmjet “PIA” sha dhe 44.8% është importuar nëpërmjet terminalit bregdetar të Durrësit, pra është realizuar nëpërmjet “Romano Port” sha.
22. Përcaktimi i pjesëve të tregut përkatës së shërbimit të këtyre ndërmarrjeve varet nga veprimtaria e ndërmarrjeve importuese të GLN-së të realizuara nëpërmjet këtyre dy terminaleve bregdetare. Për sa i përket volumit të GLN-së të importuar gjatë periudhës Qershor 2009- Maj 2010, duke iu referuar edhe të dhënave të tabelës së mëposhtme rezulton se ndërmarrja PIA që prej fillimit të aktivitetit të saj në Portin Vlora 1 ka importuar 55.2% e sasisë së GLN në vend. Pjesa tjetër prej 44.8% është importuar nëpërmjet portit “Romano Port”.

Tabela Nr.1: Sasia ne litra e gazit sipas doganave per periudhën Qershor 2009-Maj 2010.

Dogana	Sasia/L	Pjesa e tregut
Durresi	60 666 038	44.8%
Vlora	74 660 815	55.2%
Totali	135 326 855	100%

Burimi: Të dhënat e Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganës

III.2 Pengesat ligjore dhe ekonomike

III.2.1 Barrierat ligjore

23. Shërbimi i ngarkim-shkarkimit dhe depozimit në rrugë detare realizohet në dy segmente që nuk mund të funksionojnë të veçuara. Në bazë të marrëveshjeve koncesionare të lidhura nga ana e shtetit shqiptar me këto dy ndërmarrje, u është dhënë e drejta e ekskluzivitetit për ofrimin e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së (ku PIA sha ka ekskluzivitetin për ngarkim-shkarkimin dhe depozitimin, ndërsa Romano Port ka ekskluzivitetin për ngarkim-shkarkimin e GLN-së, këto të drejta ekskluzive në kuptim të Ligjit përbëjnë një pengesë në hyrje në tregun përkatës.

III.2.2 Barrierat ekonomike

24. Kostot për përfitimin e shërbimit në të dy pikat e ofrimit të tij janë të konsiderueshme, pasi në terminalin e Porto Romanos shoqëritë importuese të GLN-së duhet të investojnë në ndërtimin e depozitave (apo ti marrin ato me qera), ndërsa në terminalin bregdetar të PIA-s duhet të ofrojnë garanci financiare të krahasueshme me kostot e ndërtimit të depozitave. Këto kosto financiare përbëjnë një pengesë të rëndësishme hyrje në këtë treg.
25. Bazuar në vlerësimet e mësipërme në kuptim të Ligjit ndërmarrjet : “PIA” sh.a, “Romano Port” sh.a dhe “Inter Gaz” sh.a gjatë periudhës objekt hetimi kanë pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe të depozitimit të GLN-së në rrugë detare.

IV. SJELLJA E NDRMARRJEVE NË TREG

26. Ndërmarrja “ROMANO PORT” SHA, ka filluar veprimtarinë e saj të ngarkim shkarkimit në prill të 2009. Importuesit e GLN me rrugë detare përfitojnë nga koncesionari vetëm shërbimin e ngarkim shkarkimit, i cili nuk mund të ofrohet i veçur nga depozitimi. Kështu, importuesit duhet të investojnë duke ndërtuar depozita pranë këtij porti, ose duke marrë me qera depozita të ndërtuara nga subjekte të tjera importuese të GLN.
27. Nga inspektimi i kryer në Porto Romano rezulton se janë ndërtuar 5 depozita për GLN me kapacitet 10 000 m³ në pronësi të ndërmarrjes “INTER GAZ” SHA, njëri prej aksionarëve të së cilës është njëkohësisht edhe aksionar i ndërmarrjes “Romano Port” sha.

28. Ndërmarrja “ROMANO PORT” SHA, tarifat e shërbimeve që ofron i ka të miratuara nga OSHA, gjithashtu kjo ndërmarrje ju ofron shërbim të gjithë operatorëve importues të GLN të cilët kanë mundësi depozitimi pranë këtij porti
29. Ndërmarrja “INTERGAZ” SHA me objekt të aktivitetit të saj importin dhe tregtimin e GLN-së është gjatë periudhës objekt hetimi ndërmarrja e vetme që ka në pronësi të saj depozita në zonën e Porto Romanos me një kapacitet prej 10 000 m³. Nga të dhënat e depozituara nga ana e ndërmarrjes INTERGAZ sha rezulton se janë lidhur disa kontrata qeraje me ndërmarrjet e tjera që operojnë në tregun e tregtimit të GLN-së, për një pjesë të kapacitetit depozitues që kjo ndërmarrje zotëron në pronësi.
30. Të gjitha kontratat e lidhura midis ndërmarrjes Intergaz SHA dhe ndërmarrjeve të tjera që operojnë në tregun e importit dhe tregtimit të GLN-së nuk lejojnë dhënien me nënqera nga këto të fundit.
31. Ndërmarrja “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA ka nisur aktivitetin e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së në Qershor të vitit 2009. Në bazë të të dhënave të grumbulluara gjatë inspektimit dhe informacioneve të sjella nga vetë ndërmarrja, në këtë terminal janë ndërtuar dhe janë në funksionim dy depozita të GLN-së me kapacitet 2450m³ secila, por secila përdoret deri në 2000 m³ për arsye sigurie
32. Dy depozitat sferike ekzistuese në pronësi të PIA i janë ofruar për dhënie me qera ndërmarrjeve të ndryshme importuese të gazit të lëngshëm. Mbi bazën e evidencave të mbledhura gjatë periudhës hetimore rezulton se ofertat e para të paraqitura nga PIA në adresë të ndërmarrjeve improtuese të GLN-së i përkasin viteve 2004- 2005 duke pretenduar ofrimin e shërbimit kundrejt një tarife mujore 160.000-112.000 EUR për kapacitetin depozitues 4000 m² dhe kapacitetin vjetor deri në 30.000 mton si dhe garanci financiare që janë sa tre fishi i tarifës mujore.
33. Aktualisht të dyja këto depozita i janë dhënë me qera ndërmarrjes “KALAJA” SHA (ndërmarrje që ushtron veprimtari importi dhe tregtimi të GNL-së) me anë të kontratës “Për shërbimin e depozitimit dhe trajtimit të produkteve të lëngshme”, të lidhur midis ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA dhe ndërmarrjes “KALAJA” SHA, si dhe Shtojca nr.1, datë 23.06.2009 dhe Lidhja “A”, datë 29.08.2008, bashkëngjitur asaj. Sipas evidencave rezulton se ndërmarrja “PIA” SHA, ka vënë në dispozicion të ndërmarrjes “KALAJA” SHA të gjithë kapacitetin e saj depozitues për GLN, si dhe impiantin e ngarkim shkarkimit të këtij produkti për një periudhë 5 vjecare. Gjithashtu, në pikën C.2 të Lidhjes “A”, përcaktohet pagesa prej 12.75 euro/mt, për çdo sasi shtesë të produktit mbi sasinë vjetore prej 38 000 mt, të përfshirë më sipër. Tarifat e përcaktuara më sipër janë të vlefshme për vitin 2009, ndërsa për vitet në vazhdim tarifat do të rriten çdo vit sipas një formule të përcaktuar në pikën D të lidhjes “A”. Në pikën G të marrëveshjes parashikohet garancia bankare që do të garantojë përmbushjen e marrëveshjes. Klienti që nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshje duhet ti sigurojë operatorit një garanci bankare në shumën e 1 100 000 euro, që do të jetë e vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes.
34. Nëpërmjet kësaj marrëveshje, ndërmarrja “KALAJA” SHA është e vetmja ndërmarrje, e cila ka të drejtën të shkarkojë dhe të depozitojë produktet e saj në depozitat në pronësi të “PIA” SHA. Ndërmarrja “PIA” SHA, nuk ka aktualisht në dispozicion kapacitete të tjera të lira për ngarkim-shkarkimin dhe depozitimin

e GLN-së, pasi të gjithë kapacitetin depozitues të GLN që ka ndërtuar në portin “VLORA-1”, i janë dhënë në përdorim ndërmarrjes “KALAJA” SHA.

35. Ndërmarrjet e tjera importuese, të cilat kërkojnë të shkarkojnë GLN nëpërmjet këtij terminali, mund ta realizojnë këtë proces nëse arrijnë një marrëveshje me ndërmarrjen “KALAJA” SHA ose të lidhin kontrata afatgjata me njoftim 12 muaj në avancë.
36. Nga analiza e të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, rezulton se në këtë Port, për periudhën 01.07.2009 - 31.05.2010, janë shkarkuar edhe 2 (dy) anije me GLN për operatorë të tjerë në treg, përkatësisht MARE OIL” SHA dhe “GLOBAL GAZ” SHA. Shkarkimi i këtyre 2 (dy) anijeve është bërë vetëm me lejen e dhënë nga ndërmarrja “KALAJA” SHA, e vërtetuar kjo edhe nga deklaratimet e Zv. Drejtorit të terminalit të ndërmarrjes “PIA” SHA dhe nga gjetja gjatë inspektimit në këtë ndërmarrje të një shkresë të ndërmarrjes “KALAJA” SHA drejtuar ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, ku i kërkohej kësaj të fundit lejimi i shkarkimit të një anijeje me gaz për llogari të shoqërisë “GLOBAL GAZ” SHA dhe të gjitha detyrimet kontraktuale do të jenë në ngarkim të ndërmarrjes “KALAJA” SHA.

- Kushtet e PIA paraqitur në ofertat e shërbimit për ndërmarrjet e tjera.

37. Për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit PIA ka zhvilluar negociata me operatorët importues me rrugë detare të GLN duke paraqitur ofertat si më poshtë:

Oferta Nr. 1

Në datën 17.07.2009 PIA u ka paraqitur ndërmarrjeve Global Gaz sha, DUA GAZ sha, Burimi Srl, një ofertë për shkarkimin dhe depozitimin e GLN. Në këtë ofertë të paraqitur, klientët duhet t'i vënë në dispozicion operatorit (PIA) një kontribut në investim prej 1 500 000 euro që në momentin e nënshkrimit të kontratës. Në këtë ofertë të paraqitur nga ana e PIA për klientët gjithashtu parashikohet që të lihet edhe një garanci e klientit. Sipas PIA kjo garanci në vlerën 1 500 000 euro kërkohet për përmbushjen e përpiktë dhe të plotë të çdo detyrimi që i ngarkohet klientit. Kostot e garancisë referuar kësaj oferte janë ekskluzivisht në ngarkim të klientit. Tarifat e magazinimit sipas kësaj oferte janë 26 250 euro në muaj për një kapacitet 4 800 m³. Për shkarkimin e gazit, në këtë ofertë është përcaktuar një tarifë 19.50 euro/ton për një sasi deri në 30 000 ton/vit (lëvizje minimale vjetore e garantuar)¹ dhe 13.00 euro/ ton për një sasi më të madhe se 30 000 ton/vit. Në shkresën e dërguar ndërmarrja PIA bën të ditur se ofertat ndaj operatorëve mund të jenë të vlefshme për kapacitete minimale prej 30 000 ton/vit.

Oferta Nr. 2

Në datën 23.07.2009 PIA u ka paraqitur ndërmarrjeve Global Gaz sha, DUA GAZ sha, Burimi Srl një ofertë për shkarkimin dhe depozitimin e GLN. Në këtë ofertë të paraqitur nga ana e PIA për klientët parashikohet që të lihet edhe një garanci e klientit në favor të ndërmarrjes “PIA” SHA në vlerën 4 000 000 euro për përmbushjen e përpiktë dhe të

¹ Për sasinë 30 000 ton në vit, Klienti duhet të paguajë një shumë të garantuar prej 30 000 x 19.50 Euro. Kjo shumë duhet të paguhet pavarësisht nëse realizohet apo jo ky qarkullim. Pagesat janë fikse dhe të barabarta sipas muajve të vitit.

plotë të çdo detyrimi që i ngarkohet klientit me afat deri në përfundim të kontratës. Në përfundim të çdo viti do të zbriten 625 000 euro, për 4 vitet e para. Pas 4 vitesh, 1 500 000 euro të mbetura mbeten garanci përfundimtare. Kostot e garancisë referuar kësaj oferte janë ekskluzivisht në ngarkim të klientit. Tarifat e magazinimit sipas kësaj oferte janë 46 250 euro/muaj për një kapacitet 4 800 mc. Për shkarkimin e gazit në këtë ofertë është përcaktuar një tarifë 19.50 euro/ton për një sasi deri në 30 000 ton/vit (lëvizje minimale vjetore e garantuar) dhe 13.00 euro/ton, për më shumë se 30 000 ton/vit. Në shkresën e dërguar ndërmarrja PIA bën të ditur se ofertat ndaj operatorëve mund të jenë të vlefshme për kapacitete minimale prej 30 000 ton/vit.

Oferta Nr. 3

Në datën 31.08.2009 PIA u ka paraqitur ndërmarrjeve Global Gaz sha, DUA GAZ sha, Burimi Srl një ofertë për shkarkimin dhe depozitimin e GLN. Në këtë ofertë të paraqitur nga ana e PIA për klientët parashikohet që të lihet edhe një garanci e klientit në favor të ndërmarrjes “PIA” SHA në vlerën 3 000 000 euro për përmbushjen e përpiktë dhe të plotë të çdo detyrimi që i ngarkohet klientit me afat deri në përfundim të kontratës. Në përfundim të çdo viti do të zbriten 500 000 euro, për 4 vitet e para. Pas 4 vitesh, 1 000 000 euro të mbetura, mbeten garanci përfundimtare. Kostot e garancisë referuar kësaj oferte janë ekskluzivisht në ngarkim të klientit. Tarifat e magazinimit sipas kësaj oferte janë 42 500 euro/muaj për një kapacitet 4 800 m³. Për shkarkimin e gazit në këtë ofertë është përcaktuar një tarifë 17.00 euro/ton për një sasi deri në 30 000 ton/vit (lëvizje minimale vjetore e garantuar) dhe 12.50 euro/ton, për më shumë se 30 000 ton/vit. Në shkresën e dërguar ndërmarrja PIA bën të ditur se ofertat ndaj operatorëve mund të jenë të vlefshme për kapacitete minimale prej 30 000 ton/vit.

Oferta Nr. 4

Në datën 20.01.2010 PIA, i ka paraqitur ndërmarrjes “PRIMA GAS” SHA një ofertë për shkarkimin dhe depozitimin e GLN. Në këtë ofertë të paraqitur nga ana e PIA për klientin parashikohet që të lihet një garanci e klientit në favor të ndërmarrjes “PIA” SHA në vlerën 3 000 000 euro për përmbushjen e përpiktë dhe të plotë të çdo detyrimi që i ngarkohet klientit me afat deri në përfundim të kontratës. Në përfundim të çdo viti do të zbriten nga 500 000 euro, për 4 vitet e para. Pas 4 vitesh, 1 000 000 euro të mbetura, mbeten garanci përfundimtare. Kostot e garancisë referuar kësaj oferte janë ekskluzivisht në ngarkim të klientit. Tarifat e magazinimit sipas kësaj oferte janë 42 500 euro/muaj për një kapacitet 4 800 m³. Për shkarkimin e gazit në këtë ofertë është përcaktuar një tarifë 17.00 euro/ton, për një sasi deri në 30 000 ton/vit (lëvizje minimale vjetore e garantuar) dhe 12.50 euro/ton, për më shumë se 30 000 ton/vit. Në shkresën e dërguar ndërmarrja PIA bën të ditur se ofertat ndaj operatorëve mund të jenë të vlefshme për kapacitete minimale prej 30 000 ton/vit.

38. Referuar ofertave të mësipërme që ndërmarrja “PIA” SHA u ka ofruar ndërmarrjeve të importit të GLN, konstatojmë se pavarësisht pjesës që zënë këto ndërmarrje në tregun e importit të GLN, pagesa vjetore për ndërmarrjen “PIA” është e njëjtë, pasi kjo ndërmarrje cakton si qarkullimin minimal vjetor sasinë prej 30 000 t/GLN në vit. Në këto kushte, sasia prej 30 000 t GLN në vit kthehet në një nivel dysheme për të cilën të gjitha ndërmarrjet e tjera duhet të paguajnë pavarësisht nëse e realizojnë apo jo këtë qarkullim të këtij produkti. Në këtë mënyrë operatorët me pjese nën 22.9% të tregut të importit të GLN-së do të duhet të përballojnë kosto më të larta.

39. Ndërmarrjet importuese të GLN-së si palë përfituese të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në rrugë detare përbëjnë pjesën e poshtme të tregut të importit dhe të shitjes me shumicë të GLN-së, dhe aktiviteti i tyre ndikohet ndjeshëm nga mënyra dhe kushtet e ofrimit të këtij shërbimi. Gjatë periudhës objekt hetimi është konstatuar rritje e ndjeshme e shkallës së përqëndrimit. Në pjesën e tregut të importit të GLN-së nga 4 ndërmarrje që në vitin 2009 zinin 76.9 % të tregut, janë vetëm 2 ndërmarrje që gjatë 5 muajve të parë të vitit 2010 zënë 77.2% të tregut. Këto ndërmarrje janë ato të cilat kanë akses në терминалет bregdetare në të cilat ofrohet shërbimi i ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së.
40. Nga seancat dëgjimore të orgnaizuara u deklarua (nga përfaqësuesit e ndërmarrjes “Global Gaz” sha), se garancia financiare prej 4 000 000 euro është e papranueshme dhe jo realiste pasi sipas pretendimit të tyre më mirë është të ndërtohet vetë në Durrës dhe të kesh në gjendje ‘cash’ për të ushtruar veprimtarinë. Ndërtimi i dy sferave në Porto Romano sipas tyre kushton rreth 2 500 000 euro përfshi edhe blerjen e tokës.
41. Gjithashtu, gjatë trajtimit të çështjes Komisioni i Konkurrencës konstatoi se këta operatorë nuk kanë qënë proaktiv gjatë procesit të ndryshimit strukturor të ndodhur nga zbatimi i VKM-së Nr 486 datë 25.07.2007 “Për ndërprerjen e veprimtarisë së anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre në portet e Durësit dhe të Shëngjinit” si dhe gjatë procesit të negociimit të ofertave me ndërmarrjen “PIA” SHA. Pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk është depozituar ndonjë ankesë formale apo informale për pretendimin e vendosjes së kushteve të renduara financiare për ofrimin e shërbimit që në fazën negociuese midis palëve.
42. Si konkluzion, ndryshimet strukturore në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëshëm të naftës në rrugë detare kanë shkaktuar një vend të ngushtë (bottleneck) dhe rrjedhimisht kanë shkaktuar edhe ndryshime strukturore në rritjen e shkallës së përqëndrimit në tregun e importit të GLN-së. Palët si në ofrimin e shërbimit nëpërmjet terminaleve bregdetare ashtu edhe në realizimin e kërkesës nuk kanë bashkëpunuar për të realizuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe me kosto të arsyeshme ekonomike.
43. Ndërmarrjet “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTERGAZ”SHA nuk kanë abuzuar me pozitën dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 8, nenin 9, pika 1, germa (c), nenin 74, pika 1, germa (a) dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëshëm të naftës në rrugë detare.
2. Mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “ROMANO PORT” SHA për

abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare.

3. Mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes“ “INTER GAZ” SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare.
4. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem për zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 163, Datë 14.12.2010

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë ‘Premium’ ndaj Digitalb sh.a ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë ‘Premium’ ndaj Digitalb sh.a

Baza ligjore: -Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d dhe neni 26.

-Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”

-Rregullorja “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës, pasi shqyrtoi raportin e grupit të punës “Mbi hetimin paraprak në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë ‘Premium’ ndaj Digitalb sh.a”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionin përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm,

KONSTATOI:

I. PROCEDURA E NDJEKUR:

Në adresën elektronike të Autoritetit të Konkurrencës ka ardhur një ankesë e një qytetari e protokolluar me nr. 369 prot, datë 23.09.2010. Sipas ankimuesit kohët e fundit ndërmarrja “Digitalb” ka ndryshuar praktikë dhe ka përfshirë në abonimin për ndeshjet me pagesë të

quajtur “Premium 1” (një vjeçar) edhe kushtin për ta blerë së bashku me ofertën sportive dhe ofertën e filmave me pagesë.

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur në Autoritetin e Konkurrencës, Sekretari i Përgjithshëm, me anë të vendimit Nr 11, datë 28.09.2010, vendosi hapjen e hetimit paraprak ndaj shoqërisë “Digitalb” sh.a në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë ‘Premium’. Në këtë kuadër, Sekretari i Përgjithshëm me anë të Urdhrit të Brendshëm Nr.70, datë 28.09.2010 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj shoqërisë Digitalb sh.a në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë Premium” urdhëroi ngritjen e grupit të punës.

Në vijim të procedurës hetimore Sekretariati, për mbledhjen e të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me anë të shkresës Nr. 376, datë 28.09.2010, ka kërkuar gjithë informacionin e nevojshëm nga ndërmarrja nën hetim. Gjithashtu Sekretariati ka realizuar një takim¹ me Drejtorin e Përgjithshëm të ndërmarrjes Digitalb, takim ky i kërkuar nga pala për tu sqaruar rreth informacionit të kërkuar nga grupi i punës. Grupi i punës ka realizuar marrjen e informacionit të nevojshëm për paketën televizive që ofrohet nga ndërmarrjet në tregun shqiptar.

Në përgjigje të kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës me anë të shkresës Nr.376/1 dhe 376/2, datë 18.10.2010², ndërmarrja DigitAlb Sh.a ka paraqitur informacionin e kërkuar.

II. VLERESIMI I KONKURRENCËS NE TREG

II.1 Përcaktimi i tregut përkatës

II.1.1 Tregu i produktit

Tregu i produktit është ofrimi me pagesë i veprimtarive sportive në të cilat përfshihen Superliga Italiane, ndeshjet e Kupës së Kampioneve dhe Kupës së Kupave si dhe veprimtari të tjera sportive të cilat blihen rast pas rasti. Paketa ‘Premium’ përfshin një paketë të përbashkët abonimi, që mundëson shikimin e njëhershëm të të gjithë kanaleve të DigitAlb dhe ata të SuperSport për një vit të tërë ose 6 muaj.

II.1.2 Tregu gjeografik

Eshtë i gjithë territori i Shqipërisë duke qenë se ky produkt tregtohet në të gjithë territorin me të njëjtat kushte.

II.2 SJELLJA E NDËRMARRJES NE TREG

Ndërmarrja Digitalb sh.a operon në tregun e ndërtimit, tregtimit të sistemeve të telekomunikacioneve si dhe prodhimit të shërbimeve audio dhe video. Kjo ndërmarrje tregon paketa të ndryshme të transmetimeve televizive si p.sh paketa e filmave 1, 3 dhe 12 mujore si dhe paketa ‘Premium’³ dhe 12 mujore.

¹ Procesverbal i datës 08.10.2010

² Numrat e protokollit të shkresave i përkasin protokollit të Autoritetit të Konkurrencës

Në tregun e komunikimeve elektronike në territorin e Shqipërisë operojnë dy operatorë të licencuar për tregtimin e paketave televizive, Digitalb dhe Tring Digital. Këto dy ndërmarrje tregtojnë paketat e filmave dhe paketa televizive të eventeve sportive. Duhet theksuar se këto ndërmarrje nuk tregtojnë të njëjtat evente sportive, Digitalb tregon kampionatin Italian dhe ndeshjet e Kupës së Kampioneve dhe Kupën e Kupave si dhe evente të tjera që blihen rast pas rasti nga ndërmarrja Digitalb, ndërsa Tring Digital tregon Kampionatin Anglez, Kampionatin Grek dhe Kampionatin Rus dhe disa ndeshje të tjera, të cilat blihen nga ndërmarrja rast pas rasti.

Pra për sa më sipër mund të themi se ndërmarrja Digitalb zotëron 100 % të tregut përkatës lidhur me tregtimin e eventeve sportive përkatëse të paketës ‘Supersport’.

Duke qenë se ndërmarrja Digitalb zotëron 100% të tregut përkatës lidhur me tregtimin e eventeve sportive që përfshihen në paketën Premium, mund të themi që kjo ndërmarrje zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës, për sa i përket eventeve sportive specifike, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me shërbime specifike që i ofrojnë kontratat e ekskluzivitetit. Kjo pozitë dominuese referuar Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sigurohet nga kontratat ekskluzive që shoqërojnë blerjen e këtyre eventeve dhe që asnjë operator tjetër i licencuar nuk ka të drejtë të ofrojë të njëjtat evente sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ndërmarrja konkurrenente me Digitalb në tregun e shërbimit televiziv me pagesë të filmave dhe dokumentarëve, Tring Tv ka të njëjtën formë për sa i përket paketës së saj që ofron për klientët. Paketa e filmave dhe ajo e eventeve sportive ofrohen bashkë.

Pra, në të dyja këto ndërmarrje i tregtojnë eventet sportive së bashku me paketën bazë. Në asnjë rast konsumatori nuk mund të blejë vetëm paketën e veprimtarive sportive, ndërsa paketën bazë mund ta blejë më vete.

Edhe nga vlerësimi i tregjeve europiane të paketave numerike konstatohet se aplikimi i paketave bazë në transmetimet televizive të shoqëruara me shërbime shtesë janë të hasura gjerësisht si psh. paketa televizive Sky, e cila është më e njohura në Europë për sa i përket eventeve sportive që ofron, ndjek një praktikë të ngjashme.

Gjatë inspektimeve rezulton se ndërmarrja u tregua shumë bashkëpunuese me Autoritetin e Konkurrencës, për evidentimin e konkurrencës në treg, gjë e cila u pasqyrua edhe në sjelljen e tyre pas inspektimeve të Autoriteti të Konkurrencës, duke u angazhuar për të vepruar në mënyrë sa më korrekte në treg.

III. Konkluzione

Ndërmarrja Digitalb ka pozitë dominuese në tregun e ofrimit të eventeve sportive të cilat janë të grupuara në paketën Premium. Ky pozicion që kjo ndërmarrje ka në treg vjen si pasojë e kontratave ekskluzive që kjo ndërmarrje ka lidhur me mbajtësit e këtyre të drejtave televizive në botë, kontrata këto të njohura gjerësisht në këtë fushë.

Ankesa e ardhur është trajtuar në kuptim të nenit 9, pika 2 të Ligjit mbi abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese për zbatimin e praktikave përjashtuese për konkurrentët si “vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë”.

Në analizën e rasteve të ngjashme abuzimi me pozitën dominuese ndodh në ato raste kur kushtet shtesë nuk lidhje me subjektin e kontratave të tilla ndërkohë që në rastin konkret pasja e paketës bazë të shërbimit të kanaleve të Digitalb me pagesë shërben dhe si akses për paketën e shërbimeve të kanaleve me pagesë të “Supersport”. Praktikë të njëjtë me platformën Digitalb ndjek edhe ndërmarrja konkurrencte në tregun shqiptar Tring TV, e cila tregon paketën e saj të sportit bashkë me paketën bazë si dhe kompani me shërbime të ngjashme në tregun europian.

Si konkluzion, nga hetimi paraprak rezulton se ndërmarrja nuk ka shkelur nenin 9, pika 2, germa ç e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” duke mos abuzuar me pozitën dominuese. Në këtë mënyrë bëhet e panevojshme vazhdimi i këtij hetimi dhe aq më tepër kalimi në fazën tjetër të procedurës së hetimit të thelluar në këtë rast.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe pikës 5, të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” ,

V E N D O S I:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë ‘Premium’ ndaj Digitalb sh.a.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palës.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 164, Datë 14.12.2010

Për një ndryshim në Rregulloren “Për Marrëveshjet me Rëndësi të Vogël”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 12. 2010, dhe në mbështetje të nenit 24 germa dh) të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e një ndryshimi në rregulloren “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” në zbatim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar).

Baza ligjore: Neni 24, germa dh) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” miratuar me vendimin Nr. 121, datë 10.09.2009 të Komisionit të Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të propozimeve për ndryshime në Rregulloren “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”;

VENDOSI:

Në Rregulloren “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”, miratuar me vendimin nr 121, datë 10.09.2009 të Komisionit të Konkurrencës miratohet ndryshimi i Nenit 1, “Qëllimi”, si vijon:

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përjashtimi i atyre marrëveshjeve nga ndalimi, të cilat nuk sjellin pasoja mbi konkurrencën në treg, në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar)”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 165, Datë 14.12.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ZBATIMIN E
PROCEDURAVE TË PËRQENDRIMIT TË NDËRRMARRJEVE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2010, në mbështetje të nenit 24, të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

Në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërrmarrjeve”, miratuar me VKK Nr. 80 datë 05.06.2008., të bëhen disa ndryshime sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRQENDRIMIT TË
NDËRMARRJEVE”**

Neni 1

Neni 2 bëhet si më poshtë vijon:

“Kjo rregullore zbatohet për të gjitha përqendrimit në formën e bashkimeve juridike dhe faktike të dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura nga njëra tjetra, përfhtimit të kontrollit nga një ose më shumë persona fizik, ose juridikë mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose pjesëve të tyre, dhe krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët, të përcaktuara në nenin 10 dhe që plotësojnë kushtet e nenit 12, pika 1 të Ligjit.”.

Neni 2

Në nenin 5, pika “2”, ndryshohet si më poshtë:

“2. Komisioni, në përputhje me nenin 56 të Ligjit, autorizon përqendrimin që nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg, ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese”.

Neni 3

Në nenin 8, pika “2” ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rastin e bashkimit apo përfhtimit të kontrollit, njoftimi kryhet nga blerësi, përfhtuesi i kontrollit, në rastin e krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët ndërmarrjet që përfhtojnë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët dhe në rastin e publikimit të ofertës publike, nga ofertuesi”.

Neni 4

Në nenin 11, pika “6” ndryshon si më poshtë:

“6. Informacioni i pasaktë, i paplotë ose i rremë konsiderohet si informacion jo i plotë në bazë të nenit 33 i Ligjit dhe përbën shkak për vendosje gjobe sipas nenit 73 të Ligjit”.

Neni 5

Në nenin 25, pikat “2” dhe “3” të ndryshohen si më poshtë:

“2. Kur Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti si

rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, ai e autorizon atë në zbatim të nenit 56, pika 1 në kuptim të fjalisë së parë të Ligjit.

“ 3. Kur Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese e, në zbatim të nenit 56, pika 1 të Ligjit, në kuptim të fjalisë së dytë, vendos fillimin e procedurave të thelluar të kontrollit të përqendrimit ose autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 166, Datë 21.12.2010

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aktivitetit të shoqërisë Global Connectivity Services nga shoqëria Harris Corporation”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.12.2010, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aktivitetit të shoqërisë Global Connectivity Services nga shoqëria Harris Corporation.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 2, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe Përqendrimi

Transaksioni i njoftuar është realizuar me anë të Marrëveshjes për shitjen e aksioneve dhe aktivitetit (në lidhje me aktivitetin e shërbimeve të ndërlidhjes globale të grupit Schlumberger), të nënshkruar ndërmjet palëve Harris Corporation dhe Schlumberger B.V, me objekt përfitim të kontrollit në shoqërinë Global Connectivity Services, me anë të blerjes së entiteteve dhe aktiviteteve të shoqërisë Global Connectivity Services nga HARRIS Corporation, më datën 6 Nëntor 2010.

Njoftimi është depozituar në Autoritetin e Konkurrencës nga përfaqësuesi i autorizuar me prokurë i shoqërisë Harris Corporation, me shkresën Nr. 494 Prot. të datës 6 Dhjetor 2010. Njoftimi i përqendrimit është bërë ne përputhje me afatin ligjor të parashikuar në nenin 12 pika 2 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Ky transaksioni nëpërmjet të cilit realizohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë përfundimi i kontrollit, sjell ndryshime mbi një bazë të qëndrueshme të kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2, konsiderohet përqendrim.

Transaksioni i njoftuar është objekt kontrolli dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës sepse përmbush në mënyrë kumulative edhe kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12¹ të Ligjit.

II. Palët në transaksion

II.1 Harris Corporation, në cilësinë e **blerësit**, me seli në Melbourne, Florida USA, nëpërmjet:

II.2 Global Connectivity Services, në cilësinë e shoqërisë **target** të transaksionit, është një shoëri e krijuar në Antilet Hollandeze.

II.3 Schlumberger B.V në cilësinë e **shitësit** është një shoëri globale e shërbimeve për shoqëritë naftëbajtëse.

III. Xhiro për vitin 2009²

Referuar nenit 12, pika 3, shkronja b të Ligjit, palët pjesëmarrëse në llogaritjen e pragut të xhiros kanë marrë parasysh kërkesat e nenit 16 të Ligjit.

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është xxx miliard Lek;
 - Harris Corporation : xxx milion USD³ = xxx miliard Lek
 - Schlumberger : xxxx milion USD = xxx miliard Lek.
- Xhiro totale në tregun e brendshëm është xxx milion Lek;
 - Harris Corporation : xxxx USD = xxx milion Lek.

Sa më lart, xhirot e ndërmarrjeve në përqendrim plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 12 të Ligjit, shkronja a) dhe b).

IV. Analiza e Konkurrencës

IV.1 Tregu Përkatës:

Referuar Udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës, Nr.76, datë 07.04.2008 , “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu për produkte dhe shërbime të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit për vendndodhjet e largëta.

¹ a) Xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse se bashku në tregun ndërkombëtar është me shumë se xxx miliardë leke, ose xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve se bashku, në tregun e brendshëm është me shumë se xxx milionë leke dhe
b) xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm është me shumë se xxx milionë leke

² Bazuar në të dhënat e bilanceve përkatës.

³ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2009, 1 USD = 93 lek. Burimi : Raporti Statistikor

Tregu përkatës i produktit:

Harris Corporation (nëpërmjet filialeve CapRock dhe MCS), dhe Global Connectivity Services (GCS) ofrojnë shërbime fundore të ndërlidhjes për klientë të cilët duan të komunikojnë me dhe nga vendndodhje të largëta, të cilat nuk mbulohen nga shërbimet konvencionale të komunikimit të përdorura nga publiku në përgjithësi. Këto shërbime ndërlidhjeje përdoren nga klientët për të transportuar zë, të dhëna dhe aplikacione video duke përfshirë akses internet.

GCS është gjithashtu një prej disa shoqërive në botë të cilat prodhojnë sisteme të stabilizuara antenash, marka e antenave të cilës njihet me emrin SpaceTrack. Këto sisteme antenash mundësojnë komunikimin me satelitë. GCS i instalon antenat SpaceTrack në funksion të shërbimeve të ofruara prej tij si dhe shet antena për disa klientë të cilat blejnë shërbime nga GCS dhe dëshirojnë të kenë pronësinë mbi pajisjet e vendosura në vendndodhjet e tyre të largëta.

Shërbimet fundore të komunikimit për vendndodhje të largëta në përgjithësi ofrohen nëpërmjet një lidhjeje marrëse dhe dhënëse satelitore. Kjo përfshin një antenë të instaluar në një njësi biznesi ose anije ose vendndodhje të largët e cila transmeton tek një satelit në orbit (i cili mund të jetë në pronësi të Schlumberger, GCS, Harris apo CapRock) dhe më tej ky satelit transmeton të dhëna në tokë të cilat priten në një teleportë apo stacion tokësor dhe i transmetohen marrësit fundor nëpërmjet një fibre optike ose teknologji tjetër. Më tej, teknologjia GCM/ celulare, fibrat optike, transmetimet në mikrovalë dhe frekuencat radio dixhitale përdoren gjithashtu për të ofruar shërbime ndërlidhjeje nga dhe për një vendndodhje të largët.

Klientët i blejnë këto shërbime duke lëshuar kërkesa për propozime dhe duke marrë oferta të ndryshme nga ofruesit e shërbimeve. Cilado qoftë përzgjedhja e kombinuar e teknologjisë, ofruesit e shërbimeve të ndërlidhjes në përgjithësi i sigurojnë komponentët e ndryshëm të shërbimit me anë të kontratave me palë të treta si p.sh. kohën ajrore satelitore dhe aksesin në fibër optike.

Shërbimet e ndërlidhjes për vendndodhje të largëta përdoren nga një numër i madh industrish, duke përfshirë klientët në sektorin e ushtrisë dhe qeverisë, minierave, rekuperimit në rastet e fatkeqësive, inxhinieri dhe ndërtim, sektorin detar duke përfshirë anijet naftë dhe gaz mbajtëse të çdo lloji, platforma prodhimi, anije tregtare si edhe anije për argëtim.

Në Shqipëri:

Aktiviteti i Harris Corporation në Shqipëri për vitin 2009 është tregtimi i pajisjeve radio taktike si edhe i disa pajisjeve transmetimi.

GCS nuk ka aktivitet në Shqipëri.

Tregu gjeografik: Territori i Republikës së Shqipërisë

V. Ndikimi i përqendrimit në treg

Transaksioni i njoftuar konsiston në blerjen e aseteve të Global Connectivity Services (GCS), pjesë e aktivitetit të Schlumberger Limited, asete të cilat përfshijnë teleporta, inventar, pronësi intelektuale emër të mirë, kontrata dhe asete të tjera të lidhura me ofrimin e shërbimeve të ndërlidhjes, asnjëri prej të cilëve nuk ndodhet në Shqipëri.

Ky transaksion, që nuk shkakton asnjë ndikim në tregun shqiptar, është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës në zbatim të nenit 12, shkronja a) dhe b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Në Shqipëri, Harris Corporation nuk është e pranishme në tregun e produktit, ndërsa GCS nuk është e pranishme as direkt dhe as indirekt.

Në këtë kontekst përqëndrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurruese në tregun shqiptar pasi: (i) veprimtaritë e palëve pjesëmarrëse në transaksion nuk mbivendosen; (ii) GCS nuk është e pranishme në treg; (iii) Veprimtaria e Harris Corporation është e kufizuar dhe kap shumën xxx rreth milion lekë.

Transaksioni i njoftuar që konsiston në blerjen e të gjitha entiteteve dhe aktiveve të GCS nga Harris Corporation, nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të produkteve të Harris Corporation në nivelin e tregimit në tregun e brendshëm. Për pasojë nuk kemi kufizim të konkurrencës në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aktivitetit të shoqërisë Global Connectivity Services nga shoqëria Harris Corporation.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në përqëndrim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 167, Datë 21.12.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR CAKTIMIN
E SHPENZIMEVE DHE NDJEKJEN E PROÇEDURAVE PRANË
AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2010, në mbështetje të nenit 24, germa “c”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

Në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me VKK Nr. 10 datë 29.06.2004, paragrafi i parë i nenit 2 ndryshohet si vijon:

“Njoftimi nga ndërmarrjet për përjashtimin e marrëveshjeve, sipas përcaktimeve në nenin 5, 6 dhe 7 të Ligjit, bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15.000 lekë.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 168, Datë 21.12.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PER FUNKSIONIMIN E
 AUTORITETIT TË KONKURENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2010, në mbështetje të nenit 24, germa “c”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

Në Rregulloren “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, pika “1” e nenit 21, të saj ndryshohet si vijon:

1. Sekretariati, pas marrjes së një ankese nga një palë e interesuar, ose kur vetë kryesisht dyshon se në treg ka kufizime, shtrembërime, apo pengime të konkurrencës, informon menjëherë Komisionin, duke i kërkuar miratimin për fillimin e hetimit paraprak. Sekretariati është i detyruar të fillojë menjëherë hetimin paraprak, kur Komisioni vendos për hapjen e tij”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
 (_____)

Anëtar

Koço Broka
 (_____)

Anëtar

Rezana Konomi
 (_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E

